AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në:**

**"Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"**

**Universiteti i Tiranës**


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1.Prof. Dr. Bizena Bijo

2. Prof. Asoc. Dr. Nertil Xhaferaj


Shtator 2025

**Tabela e përgjithshme për programin e studimit , Master i Shkencave në:**

**"Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Kimisë Industriale |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM. Nr.1246, datë 10.9.2008 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdher Nr.166, datë 13.06.2023 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | |
| 8 | Cikli i studimit: | Niveli i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë e plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera. |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | N/A |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | N/A |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 2021 – 2022: PAE/PAK : 12/3<br>2022 – 2023 : PAE/PAK : 12/3<br>2023 – 2024 : PAE/PAK : 13/3 |
| 18 | Numri i studentëve: | 2021 – 2022: 32 Studentë<br>2022 – 2023 : 39 Studentë<br>2023 – 2024 : 38 Studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | |

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)**

GVJ mbasi morri në dorëzim raportin e vlerësimit të brendshëm, së bashku me 255 dokumentat bashkëngjitur, u angazhua në realizimin e vizitës dy ditore( 13 dhe 14 maj 2025) të dakortësuar me kordinatorin institucional dhe pasi kontaktoi fizikisht drejtuesit e njësisë kryesore dhe departamentit, stafin akademik, studentët, personat e ngarkuar me detyra institucionaletë Zyrës së Personelit, të Sekretarisë mësimore, të Zyrës së Karierës, Alumni dhe Biblotekes si dhe vizitoi të gjitha mjediset e zhvillimit të mësimit si dhe ato mbështetëse mendon se në lidhje me fushat:

**1.OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT.** Ky program studimi në të gjithë komponentët përbërës të tij i përmbush standartet, mbasi ai ofrohet nga një institucion me një traditë shumë të mirë akademike, që operon plotësisht brenda fushës profesionale akademike dhe shkencore që mbulon FSHN. Programi është hartuar dhe zhvillohet nga një staf shumë i kualifikuar të paisur me tituj shkencore dhe gradë akademike. Në implementimin e programit stafi bashkëpunon me departamente brenda FSHN , me institucione shtetërore dhe biznese private, për të mundësuar aftësimin praktik të studentëve. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit, mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas, **por ne konstatojmë që nuk ka dokumentacion mbështetës për këtë argumentim.**

2. **ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT.** GVJ vlerëson që programi i studimit në SHTU i përmbush në tërësi standartet e kësaj fushe. Ai është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare dhe aktet e brendshme rregullatore. Ai ju ofrohet studentëve si program informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me objektivat formuese, i orientuar në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, me një eksperience ndërkombëtarizimi dhe me nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. **GVJ sugjeron domosdoshmërinë e pasqyrimit korrekt në kurrikul dhe planin mësimor të praktikës profesionale me orë dhe kredite të përcaktuara meqënëse praktika profesionale është një nga veprimtaritë e rëndësishme formuese të programit.**

**3. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT.** GVJ vlerëson se DKI garanton seriozitet dhe impenjim në procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor duke përdorur metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin dhe bën përpjekje për monitorimin e përvitshëm dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. DKI siguron një vlerësim të drejtë dhe transparent për cdo student, në drejtim të përfitimit të dijeve, bazuar në meritën e çdo studenti, duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Ai garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët përmes angazhimit të tyre në punët në laborator, në tematika shkencore, në përfshirjen në praktika të industrise, ku synohet zhvillimi i kompetencave profesionale e shkencore si dhe zbaton procedura të qarta për detyrimet përmbyllëse të studentit

dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.Kësisoj edhe kjo fushë I përmbahet tërësisht standarteve të cilësisë.

## 4. BURIMET NJERËZORE, INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA

Programi i studimit disponon një trupë akademike të kualifikuar dhe të qëndrueshme, e përbërë nga pedagogë me tituj dhe grada shkencore, të cilët përmbushin kërkesat ligjore dhe profesionale për mbulimin e lëndëve. Ngarkesa mësimore planifikohet dhe miratohet në mënyrë të rregullt, ndërsa për çdo vit akademik dokumentohen të dhënat mbi stafin akademik dhe ndihmës. Përveç stafit bazë, angazhohen edhe pedagogë nga departamente të tjera për mbulimin e moduleve të specializuara. Gjithashtu, stafi ndihmës akademik është i mjaftueshëm dhe luan rol aktiv në zhvillimin e praktikave laboratorike dhe në mirëmbajtjen e mjediseve didaktike. Fakulteti ofron infrastrukturë të përshtatshme për mësimdhënie, laboratorë të pajisur me aparatura moderne dhe mjedise të përshtatura me nevojat e programit. Zhvillimi i praktikave profesionale sigurohet përmes bashkëpunimeve me institucione dhe kompani të profilit ushqimor, të formalizuara me marrëveshje bashkëpunimi. Kjo strukturë mbështetëse garanton realizimin cilësor të objektivave të programit.

## 5. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA AKADEMIKE

Studentët përfitojnë nga një proces i mirëorganizuar informimi dhe orientimi që prej momentit të regjistrimit dhe gjatë gjithë ciklit të studimeve. Ata kanë akses të plotë në informacion për programin e studimit, rregulloret institucionale, planin mësimor, detyrimet përmbyllëse dhe mundësitë për ankimim. Vlerësimi i njohurive dhe kompetencave realizohet me transparencë dhe përfshin metoda të ndryshme, të përcaktuara në syllabus-in e çdo lënde. Institucioni siguron mekanizma për trajtimin e ankesave dhe kërkesave për rishqyrtim të notave. Studentëve u ofrohet asistencë akademike, këshillim për zgjedhjen e temave të diplomës, dhe mbështetje gjatë përgatitjes së punimeve përmbyllëse. Praktikat profesionale monitorohen dhe vlerësohen në bashkëpunim me institucionet pritëse. E gjithë kjo strukturë garanton që studentët të zhvillojnë kompetencat e nevojshme profesionale dhe kërkimore në përputhje me objektivat e programit.

## 6. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË

Institucioni dhe njësia bazë e programit zbatojnë politika dhe procedura të mirëpërcaktuara për sigurimin e cilësisë në të gjitha aspektet e programit të studimit. Strukturat përgjegjëse për cilësinë, si Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionet përkatëse në nivel departamenti, kryejnë vlerësime periodike të mësimdhënies dhe organizimit akademik. Studentët janë të përfshirë në këtë proces përmes plotësimit të pyetësorëve të rregullt për vlerësimin e lëndëve dhe pedagogëve. Të dhënat e mbledhura analizohen dhe përdoren për përmirësime konkrete në kurrikulë, metodologji mësimore dhe organizim të përgjithshëm. Ekziston një bashkëpunim i qëndrueshëm me aktorët e jashtëm – përfshirë alumni, tregun e punës dhe partnerët institucionalë – që kontribuon në përshtatjen e programit me nevojat reale të sektorit ushqimor. Këto mekanizma e vendosin cilësinë si një proces të vazhdueshëm dhe të integruar në funksionimin e programit.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

**Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)**

GVJ mbasi morri në dorëzim RVB, së bashku me 255 dokumentat bashkëngjitur dhe u angazhua në realizimin e vizitës dy ditore( 13 dhe 14 maj 2025) të dakortëzuar me kordinatorin institucional dhe kordinatorin ASCAL. RVB është përgatitur nga katër pedagogë dhe një student dhe ka vlerësuar cilësinë e programit MSH në "SHTU", për periudhen 2021-2024.
RVJ u hartua duke marrë në konsideratë RVB, shqyrtimin e dokumentacionit me 255 dokumenta, takimet me drejtuesint e njësisë kryesore dhe departamentit, takimin me grupin e VB, stafin akademik, studentët, takimin me përfaqsuesin e Sekretarisë Mësimore, takimin me Zv dekanin për Procesin Mësimor, takimin me Zv dekanin për Kërkimin dhe Projektet, takimin me specialistët e Zyrës së Këshillimit dhe Karierës, Alumini, takimin me përfaqsuesin e Degës së Burimeve Njerzore dhe punonjësen e Bibloktekës. Më tej vizita vazhdoi në mjediset e zhvillimit të mësimit( auditore të leksioneve dhe laboratorëve) si dhe Bibliotekës.

GVJ në hartimin e raportit të tij ka konstatuar këto gjetje:

- Programi i studimit të ciklit të dytë MSH në "SHTU", ofrohet nga DKI, pranë FSHN të, UT. Programi është ideuar si përgjigje e nevojës që ka tregu shqiptar por jo vetëm, për specialistë në fushën e ushqimit. Ai është zbatuar për herë të parë në vitin 2008, në kuadër të Procesit të Bolonjës.Programi i studimit ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, me një total prej 120 kreditesh dhe është i shtrirë në dy vite akademike, ku tre gsemestra zhvillohen në auditor, sipas kurrikulës së programit, ndërsa semestri i katërt është i organizuar me prezencë në laborator apo në praktikë në industritë ushqimore si dhe studim individual, për përgatitjen e temës së diplomës. Në kurrikulën e programit ka 16 lëndë, nga të cilat 13 janë të detyrueshme dhe 3 lëndë me zgjedhje. Ky program ka në total 1260 orë, nga të cilat 960 janë në auditor dhe 300 orë i dedikohen praktikës profesionale dhe temës së diplomës. Për studimin individual janë përcaktuar 1740 orë. Programi përmbyllet me një temë diplome, e cila mbrohet publikisht. Plani mësimor i këtij programi studimi ka një ndërthurje të lëksioneve me orët e laboratoreve dhe seminareve, ku raporti i orëve midis formimit teorik dhe aftësimit praktik është në raport të baraspeshuar. DKI punon për përmirësimin e cilësisë së programit përmes formave të ndryshme sikurse janë, aftësimi i stafit me kualifikime të vazhdueshme, pasurimi i laboratorëve me mjete didaktike dhe instumentale, koordinimi i mirë i punës me departamentet e tjera, përdorimi i bibliotekës
- Në këtë program në vitin akademik 2023-2024 janë angazhuar si PAE (3) Prof. Dr, (3) Prof. Asoc. Dr. (6) Dr. (1) Dr.proc. (-) MSc., ndersa si PAK jane angazhuar (1) Prof. Dr. (2) Dr. ( evidence 1.16)
- Ky program mbështetet nga një numër mjedisesh laboratorike, si: Laboratori i Kimisë dhe Teknologjisë Ushqimore, Laboratori i Mikrobiologjisë Ushqimore, 2 Laboratorë të Inxhinerisë Kimike dhe Teknologjisë Ushqimore si dhe mjediset laboratorike te Departamentit të Bioteknologjisë.

- Programi i studimit "Master i Shkencave në Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" mbështetet në një trupë akademike të kualifikuar dhe të qëndrueshme, e cila garanton zhvillimin cilësor të procesit mësimor dhe kërkimor. Ngarkesa mësimore planifikohet në përputhje me profilin e stafit, ndërsa stafi ndihmës kontribuon në mënyrë efektive në praktikat laboratorike dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës. Fakulteti ofron mjedise bashkëkohore dhe bashkëpunime të formalizuara me institucione publike dhe private për realizimin e praktikave profesionale.
- Studentët janë të informuar dhe të përfshirë në procesin mësimor dhe vlerësimin e cilësisë, me procedura transparente dhe mekanizma të qartë ankimi. Udhëzimi akademik dhe mbështetja gjatë studimeve janë të garantuara, sidomos në fazat përmbyllëse të programit. Sigurimi i brendshëm i cilësisë mbështetet në struktura funksionale dhe dokumente strategjike. Vlerësimet e studentëve për mësimdhënien analizohen dhe përdoren për përmirësime konkrete, ndërsa bashkëpunimi me alumni dhe tregun e punës ndihmon në përshtatjen e programit me zhvillimet e fushës.

MEMO

**Përgjigje e GVJ në lidhje me shkresën e dërguar nga FSHN për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin në proçes akreditimi, Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore', ofruar nga Departamenti i Kimisë Industriale.**

Grupi i Vlërsimit të Jashtëm, pasi u njoh nga Koordinatorja e ASCAL, me shkresën e Fakultetit të Shkencave të Natyrës me Nr. 12/22, dt 16.07.2025, me lëndë "Kthim përgjigje për dërgimin e Draft –Raportit të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", pasi vlerësoi me kujdes pikat për të cilat GVB i ka dhënë përgjigje gjetjeve tona në lidhje me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm jep këto argumentime:

1. Në lidhje me Standartin 1.1, kriteri 4 "**Programi i studimit hartohet dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkates vendas dhe atë ndërkombetar**. GVJ rivlerëson pozicionin e parashtruar në draft raport, mbasi evidencat nr. 19, 20 dhe 21 që ju i referoheni nuk kanë korelacion me strategjitë kombëtare dhe zhvillimet ndërkombëtare, që kërkon ky kriter. Vetë ju e keni konfirmuar këtë konstatim, madje i jeni referuar strategjive të institucioneve si Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe gabimisht Ministrisë së Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, që në fakt është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Në lidhje me Stadartin 1.2, kriteri 3 "**Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje", GVJ** rivlerëson gjetjen e tij, mbasi shpjegimi që ju jepni nuk qëndron mbasi programet e studimit që ofron Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit (Master Shkencor në Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit ) në UBT, në kohën që ju keni filluar shkrimin e raportit, madje dhe deri aktualisht nuk kanë ndryshuar. Ndryshimi do të fillojë në vitin e ardhshëm akademik.

3. Në lidhje me standartin 1.2, Kriteri 5. **Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit "** ju nuk keni bërë asnjë koment konkret, gjë që na jep të drejtën të gjykojmë se bini dakort me gjetjen tonë.

4. Në lidhje me standartin 1.3, kriteri 1" **Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda**

**institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre**", GVJ gjykon se raportet vjetore të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të FSHN, burojnë nga shumatorja e raporteve përkatëse të njësive bazë të fakultetit. Nëse në raportet e departamenteve përkatëse mungojnë këto informacione është logjike që ato nuk do të jenë pjesë e raportit përmbledhës të FSHN. **Gjithsesi argumenti që ka dhënë GVB, e gjykojmë si të drejtë.**

5. Në lidhje me standartin 1.3, kriteri 3 "**Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve**"' GVJ e mbështet argumentin e dhënë nga anëtarët e GVB

6. Në lidhje me standartin 2.1, kriteri 1 "**. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).**" GVJ mendon se argumenti që jepet për të justifikuar numrin e krediteve në lëndën "***Mikrorganizmat industrial dhe***.....",, lëndë me 60 orë dhe me 5 kredite, pasi në këtë lëndë janë shtuar orë deri 20% më pas , nuk qëndron sepse duhej që DKI menjëherë të bënte ndryshime edhe në sasinë e krediteve. Ndërsa praktika profesionale si veprimtari formuese nuk pasqyrohet në kurrikul me orë dhe kredite, është konsideruar si një problem i njohur nga DKI por që do te jetë në rrugën e zgjidhjes në të ardhmen.

7. Në lidhje me standartin 2.1, kriteri 3 "**Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse**". GVJ, referuar evidencave të paraqitura konstaton që ka një pedagog përgjegjës për lidhjet me institucionet ku ata kryejnë praktikën profesionale, por nuk gjetëm asnjë evidencë ku të ketë referencë me emra konkretë pedagogësh të ngarkuar gjithashtu për të mbikqyrur praktikën e studentëve. Gjykojmë se duhet të kishte një evidencë me afate dhe emra konkretë të pedagogëve të departamentit. **Gjithsesi, nëse departamenti e kryen këtë veprimtari me disa pedagogë, e konsiderojmë të mirëqënë komentin e departamentit.**

8. Në lidhje me me standartin 2.2, kriteri 3 "**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.**" GVJ mbetet dakort me komentin e bërë nga DKI.

9. Në lidhje me standartin 2.3, kriteri 2 "**Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën**

**mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit**". Konstatojmë se ka dakordësi në komentin e DKI ndaj gjetjeve në draft raportin e GVJ,

10. Në lidhje me standartin 2.4, kriteri 3 "**Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Shkencor", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional**. GVJ, navigoi në linkun e referuar https://corsi.unibo.it/cyclce/Food ScicnceTechnology, por linku nuk ishte aktiv. **Gjithsesi ne e konsiderojmë korrekt komentin e GVB.**

11. Në lidhje me standartin 2.4, kriteri 7, "**Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës". GVJ** e ka sugjeruar komentin në vijim: në raport mund të kishte një reference bibliografike nga dokumentacion kombëtar dhe i BE-së ku sanksionohen objektivat për sigurinë dhe cilësinë ushqimore. **Gjithsesi ne mbështesim komentin e GVB.**

12. Në lidhje me standartin 2.7, kriteri 2" **Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave." GVJ,** gjykon komenti i bërë nga DKI justifikon përmbushjen e këtij kriteri

13. Në lidhje me standartin 3.1, kriteri 2 "**Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies." GVJ** mbetet dakort me komentin e bërë nga GVB.

14. Në lidhje me standartin 3.1, kriteret 3 dhe 5, **GVJ** mbështet komentin e bërë nga GVB.

15. Në lidhje me standartin 3.4, kriteri 5 "**Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit"**, GVB nuk ka bërë asnjë koment specifik

16. Në lidhje me standartin 4.1 kriteri 4, Komenti i GVJ: "**Rekomandohet që rekrutimi i stafit akademik dhe ndihmës akademik duhet të jetë më i qartë përsa i përket pikëve që mbulohen nga dosja e aplikimit dhe intervista. Kjo ndarje duhet të publikohet gjatë publikimi të kritereve në APP"**, GVJ mbetet dakort me komentin e bërë nga GVB.

17. Në lidhje me standartin 4.4 kriteri 4, Komenti I GVJ: "**Raportet e vlerësimit të brendshëm për cilësinë dhe ndikimi i tyre në përmirësimin konkret të kurrikulës dhe përvojave mësimore kërkojnë pjesmarrjen e një numëri më të madh të studentëve**

**gjatë plotësimit të pyetësorëve.",** GVB ka rënë parimisht dakort me gjetjen e bërë nga GVJ dhe ka dhënë disa rekomandime për zgjidhje në të ardhmen

Në përfundim të konstatimeve tona në lidhje me komentet përkatëse të bëra nga GVB, shprehim konsideratën tonë për mirëkutimin e treguar nga kolegët e DKI, gjë që do të ndikojë në përmirësimin e mëtejshëm të punës serioze dhe me shumë përkushtim që ata bëjnë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm

Prof. Dr. Bizena Bijo

Prof.Asoc. Dr. Nertil Xhaferaj

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë ,Master i Shkencave në: "Shkencat dhe Teknologiite Ushqimore"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Departamenti i Kimisë Industriale në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", me të drejtën që i jep Ligji i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor nr 80/2015, neni 1 pika ç dhe d[1], VKM e Hapjes së programit të Studimit nr 1246, 10.9.2008[2]. Statuti UT[3]. Ky program implementohet në perputhje me objektivat dhe misionin e UT të shprehura në Strategjine e Zhvillimit të UT 2023-2028[4] dhe ka objektiv formimin e studenteve me informacion bashkëkohor dhe të përzgjedhur në fushën e ushqimit, por edhe ruajtjen, konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombetare, të artikuluara në Statutin e UT. Po ashtu përmes këtij programi studimi FSHN, me Dep përkatës dhe në zbatim edhe të Strategjisë së UT 2023-2028 ka objektiva specifike ambicioze që citohen në pikën 2.1 të strategjisë së Universitetit. Sanksionimi i vlerave akademike dhe kulturore të këtij programi studimi janë cituar edhe në Rregulloren e Dep të Kimisë Industriale, neni 4 i saj[5] . |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Universiteti i Tiranës si universiteti më i madh i vendit ofron programe në tre ciklet e studimit, Bachelor, Master dhe Doktoraturë, tashmë të konsoliduara si në aspektin akademik edhe në atë shkencor.Fushat e studimit që mbulon ky universitet përputhen mire me misionin dhe vizionin e institucionit (Statuti i UT) , nenet 4 dhe 5.Statuti i UT-se, thekson se UT "Në përputhje me misionin e vet të mësimdhenies e të kërkimit shkencor, harton |

1 /Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf https://unitir.edu.al/eng/up-content/uploads/2019/08

2 VKM e Hapjes së programit të Studimit nr 1246, 10.9.2008 https://qbz.gov.al/eli/fz/2008/147

3 Evidenca 1.2 Statuti i Universitetit te Tiranes, Neni 5, fq. 3
https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti_i_Ri_i_UT
5916d9f405.pdf

4 Evidenca1.3 Strategjia e Zhvillimit te Universitetit te Tiranes 2023-2028, Objektival 1.1, fq. 6

5 Evidenca 1.6 Rregullore e Departamentit te Kimise Industriale, Neni 4, fq. 2 Tiranes, Neni 8, Pika 6, fq.5 https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 59 16d9f405.pdf

| | |
|---|---|
| | programe e projekte te vecanta, sipas nevojave të fushave të ndryshme. UT konkurron me projekte në planin kombëtar dhe ndërkombetar përmes kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor". Programi i Studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" në FSHN përmbush mirë Misionin e UT, referuar Statutit të UT-se si dhe Rregullores së brendshme të Dep. të Kimisë Industriale ku citohet misioni dhe objektivat e Dep. përmes pergatitjes, formimit profesional dhe diplomimit të studentëve në këte fushë. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Programi studimit Master i shkencave në "Shkencat dhe Teknologiitë Ushqimore" në Departamentin e Kimisë Industriale, është hartuar konform zbatimit të Strategjisë për zhvillim 2023-2028 të UT. Po ashtu ky program është në mbështetje të vizionit dhe misionit të UT-se sanksionuar në Statutin e UT-së si dhe Rregullores[5] së UT-së ku përcaktohet detyrimi akademik i programit si dhe Planit strategjik të DKI[6]. Me këtë program synohet: rritja e standardeve të cilesisë, formimi i specialisteve të rinj në përputhje me nevojat e tregut të punës, përmes aftesimit praktik dhe teorik drejt zhvillimeve të reja të edukimit dhe kërkimit shkencor bashkëkohor.. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Departamenti i Kimise Industriale, ka hartuar dhe ofrouar një program studimi i cili është në zbatim të akteve akdemike dhe legjislative si Ligji i Arsimit 80/2015 në institucionet e arsimit të Lartë [1], Strategjia për zhvillim të institucionit të UT[4], Statuti I UT, dhe Rregulloren e Dep të Kimisë Industriale[5]. **Mendojme se në raportin e vlerësimit të brendshëm duhet të ishte bërë kujdes të adresohej ndonje dokument i rëndësishëm strategjik kombëtar si psh“”Plani kombëtar për integrimin evropian 2022 – 2024[7]”, (kapitulli 11 dhe 12)** ku jepen synimet kryesore të Shqipërisë drejt prirjeve të integrimit europian, ku padyshim marrin rol Institucionet e Arsimit të Lartë që ofrojnë programe studimi sa më bashkëkohore. **Po ashtu mungon një dokument referencë me dokumentacion nga plane strategjike në nivel europian, meqënëse pretendimi I programit është që të diplomuarit mund ti ofrohen edhe tregut të jashtëm.** |
| **Konkluzione** | *GVJ shpreh opinionin qe ky standart është I përmbushur kryesisht, mbasi konstatuam që ka mangësi në zbatimin e kriterit të katërt, ku* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *mund të kishte një argumentim më të detajuar të kërkesave të programit në fjalë me strategji apo plane ndërkombëtare.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Fakulteti i Shkencave te Natyres[7], është një ndër fakultetet më të vjetra (1957) të UT, me një histori mbresëlënëse brezash studentore që ka përgatitur kuadro të kualifikuar në fushat e shkencave natyrore dhe mësimdhënies, duke krijuar, zhvilluar dhe transmetuar njohuritë nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Përvoja e gjatë, dhe zhvillimi i nevojave kombëtare ka bërë që në këtë fakultet të ofrohen alternativa interesante specialistesh si psh. Teknolog kimist ushqimor, me synim një përshtatje sa më të denjë me tregun e punës. UT dhe fakultetet e tij zhvillojne aktivitetet e tyre akademike, ne nje siperfaqe totale prone trualli prej 190.597 $m^2$, me një numër të madh mjedisesh akademike por jo vetem prej 19.835 $m^2$ dhe siperfaqe te shfrytezueshme 4888$m^2$ (Tabelat permblcdhesc ANEKS RVB ASCAL. Tabela 16)[8] Fakulteti i Shkencave te Natyres si njësi kryesore në mbështetje të Ligjit të Arsimit të Lartë[9], synon të përmirësojë infrastrukturen e mesimdhenies, mesimnxenies dhe kerkimit shkencor. FSHN me njësitë bazë të tij kanë një infrastrukture të përshtatshme për të garantuar plotësimin e objektivave temelore dhe specifike te tij( [10 dhe 11]). Në organogramën e FSHN numërohen 8 departamente dhe nje qender kerkimore ( [12, 13]). Njësite bazë të FSHN janë:<br>1. Departamenti i Biologjisë |

7 Evidenca I.21 Historiku i Universiteti i Tiranes https://unitir.edu.al/historiku

8 Evidenca I.16 Tabelat permblcdhese ANEKS RVB ASCAL. Tabela 16

9 Ligji Nr. 80/2015 "Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor ne IAL ne Republiken e Shqiperise" Neni 23, Pika I http:/larsimi.guv.al/up-content uploads/2018/08/aktet nenligjore.pdf

10 Evidenca I.22 Infrastruktura e Fakultetil te Shkencave te Natyres

11 Evidenca I.16 Tabelat Permbledhese Aneks RVB ASCAL, Tabela 6

12 Evidenca II.23 Organigrama e Fakultetit te Shkencave te Natyres https://fshn.edu.al/info/online!!rama

13 https://fshn.edu.al/departaments/departameti-i-biologjise, https:/ /fshn.edu.al/department<departamenti-i-bioteknologjise,https://fshn.edu.al/departaments/departamenti-i-fizikes.https://fshn.edu.al/departaments/departamenti i-informatikes,https://fshn.edu.al/departments/departanmenti-kimise,https://fshn.edu.al/departaments/departamenti-i-kimise-industriale,https://fshn.edu.al/demutments/departamenti-i-matematikes, https://fshn.edu.al/departaments/departamenti-i-matematikes- aplikuar, https:l/fshn.edu.al/departaments/qendra-kerkimore-e-flores-dhe-faunes

2. Departamenti i Bioteknologjisë
3. Departamenti i Fizikës
4. Departamenti i Informatikës
5. Departamenti i Kimise
6. Departamenti i Kimisë Industriale
7. Departamenti i Matematikës
8. Departamenti i Matematikës së Aplikuar
9. Qëndra Kërkimore e Florës dhe Faunës

Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" ofrohet nga një staf i kualifikuar ([14]), të cilët kanë eksperiencën e duhur për të përmbushur detyrimet akademike të programit të studimit por edhe ato shkencore. Me kohë të plotë në vitin akademik 2023-2024 janë të angazhuar 17 pedagoge me këtë përbërje: 4 (kater) me titullin akademik "Profesor"; 3 (tre) me titullin akademik"Prof Asoc"; 9 (nente) me gradën shkencore"Doktor i Shkencave"; 1 (nje) asistente lektore. Me kontratë janë të angazhuar 2 (dy) Prof Asoc; 3( tre) Dr; dhe 3(tre) Master i Shkencave, Si ndihmës akademikë janë angazhuar 5 punonjës. Referuar dy viteve të mparshme akademike përbërja ka qënë përkatësisht:në vitin 2021-2022 janë angazhuar: 19 PAE (3) Prof. Dr; (4) Prof. Asoc; (10) Dr; (2) MSc; dhe 12 PAK (2) Prof. Dr; (2) Prof. Asoc; (3) Dr; (-) Dr.proc. (5) MSc.. Ne vitin akademik 2022-2023 janë angazhuar: 19 PAE (3) Prof. Dr; (4) Prof. Asoc; (10) Dr; (2) Dr.proc;.dhe 12 PAK(2) Prof. Dr. (2) Prof. Asoc; (3) Dr. (-) Dr.proc. (6) MSc.

Procesi mësimor në Departament ofrohet në një sipërfaqe prej $630m^2$ nga te cilat mjedise laboratorike janë 349 $m^2$ Për realizimin e Masterit të Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite ushqimore"shfrytëzohen edhe laboratorë të tjerë si ai: Kimise dbe Teknologjise Ushqimore, Mikrobiologjise dhe 2 Laboratore te Inxhinierisë Kimike. Për nevojat e mësimit në këtë program përdoren mjediset laboratorike te Departamentit të Bioteknologjisë. Sallat për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve janë të shperndara në gjithe ndërtesat e FSHN. Në përbërje të stafit të departamentit ka edhe një përsonel ndihmës akademik([15]), që zotëron gjithashtu kualifikimin e nevojshëm për të mbuluar nevojat akademike dhe ato shkencore në department. DKI ka në përbërje të vet edhe një numër pedagogësh të ftuar që mbulojnë nevojat për zhvillimin e mësimit (

14 Evidenca I.24 CV e stafit akademik efektiv (PAE) te Departamenti te Kimise Industriale

15 Evidenca I.26 CV e personelit ndihmes-akademik

| | |
|---|---|
| | [16]). Midis tyre ka Profesore dhe lektore te aftë ([17]. Informacioni I ofruar më sipër mbështet opinionin që DKI ka të gjithë kopetencat e nevojshme për nje oferte akademike shume te mire per kete program studimi. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Dokumentacioni i ofruar për këtë program na bind që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyres[18], cili në tërësinë e tij ka në fokus fushën e Shkencave Natyrore. Rezulton se fusha akademike por edhe kerkimore- shkencore e stafit akademik mësimdhenës në këtë program studimi[19] ka konformitet me disiplinat e lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"[20] .Programi është i organizuar në mënyrë harmonike.Të gjithë komponentët përbërës të tij janë në përshtatje me legjislacionin ne fuqi [21] sa i takon strukturës së programit të studimit, shpërndarjes së krediteve[22] sigurimit të cilësisë sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare[23,24] dhe europiane[25]. |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, | Departamenti i Kimise Industriale ofron programin Master të Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", që sipas Komizes Shqiptare te Kualifikimeve.[26], i takon nivelit 7. Veprimtaria formuese e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"[27,]) organizohet në veprimtari te formimit bazë, veprimtari karakterizuese, disiplina |

16 Evidenca I.27 Lista e Pedagogeve te jashtem prane Departamentit te Kimise Industriale qe japin mesim ne Master i Shkencave"Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

17 Evidenca I.28 CV e personelit akademik me kontrate (PAK) prane Departamentit te Kimise Industriale

18 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes, Nenet 10 fq. 6. https:l/unitir.edu.allëp-com contentl/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetit te-tiranes.pdf

19 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes, Neni II.fq.6- 7 https:i/api.fshn.edu.al/uploads/Statuti_i_Ri_i_UT_59 16d9f405.pdf

20 Evidenca I.25 Kualifikimi i stafit akademik sipas grup-lendeve ku japin mesim https://(fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise_industriale

21 Ligji Nr. 80/2015 "Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor ne Institucionet e Arsimit te Larte ne Republiken e Shqiperise" http://arsimi.gov.al/up-content/uploads/2018/0?./AKTET_NENLIGJORE.pdf

22 Evidenca I.9 Plani Mesimor i Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", 21-23, 22-24

23 VKM- Nr. 875 date 18.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.41 date 24.1.2018 te Keshillit te Ministrave Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga institucionet e arsimit te larte" https://api.fshn.edu.al/uploads VKM_Nr_879 date IR_12_2019_46bla0c982.pdf

24 Evidenca I.29 Vendim i Keshillit te Ministrave nr. 824 date 24.12.2021 "Miratimin e Kodit te Cilesise se Arsimit te Larte"

25 Evidenca I.30 Standardet dhe Udhezimet per Sigurimin e Cilesise ne Hapesiren Europiane te Arsimit te Larte (SUE) hnps:www.enga.eu/about-enga/

26 Ligji Nr.23/2018 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin Nr.10 247. date 4.3.2010, "Per komizen Sbqiptare te kualifikimeve" fq.7 h11p://fshn.!gov.al/infos/niesim_diplome/ligj_23-20IR_I0052018.pdf

27 Evidenca I.9 Plani Mesimor i Programit Master i Shkencave"Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", 21-23, 22-24

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | ndërdisiplinore/integruese (nëndisiplina dhe lëndë profili me zgjedhje), veprimtari plotësuese dhe detyrime përmbyllese (punim diplome), në respektim të shpemdarjes në përqindje të secilit grup të disiplinave të formimit dhe i përcaktimit të krediteve. Element kodifikimi është fusha e studimit, e cila mund të përfshijë programe studimi të ngjashme, të cilat duhet të plotësojnë kushtin e ngjashmërisë deri në nivelin 70%. Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"[28,29] plotëson kushtin e ngjashmerisë me programin Master i Shkencave në "Teknologji Agroushqimore" dhe "Bioteknologji Ushqimore" në UBT.Mendojmë **se mund të shtohej edhe programi Master Shkencor në Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit që ofron gjithashtu UBT dhe madje edhe referencat bibliografike me evidencat përkatëse të programeve të UBT, për të vërtetuar ngjashmërinë me to.** Kjo lejon transferimin e studenteve [30] nga një institucion në tjetrin pa krijuar probleme ekuivalentim lëndesh për studentet. Kohezgjatja normale e studimeve për diplomimin në Master i Shkencave është 2 vjet dhe studentet diolomohen kur kanë fituar 120 kredite.[31] Në përfundim studenteve u lëshohet diplomë universitare Master i Shkencave në fushen e arsimimit të kryer. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | DKI ofron Master shkencor brenda profilit të tij. Përvec këtij masteri ky dep ofron Master edhe në Inxhinieria Mjedisore dhe Inxhinieria e Proceseve Kimike. |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | FSHN organizon aktivitete: seminare, ëorkshop-e, trajnime, simpoziume, konferenca kombëtare ose ndërkombetare ku marrin pjesë studente. Pjesë e oranizimeve janë edhe orët e hapura ku zhvillohen leksione dhe bashkëbisedime mbi tema interesante me profil profesional , nga lektorë të ftuar [32,33]. Në raport citohet që në kuadër të projektit NETCHEM ([34]financuar nga programi |

28 Evidenca I.9 Plani Mesimor Neni 89, fq. 56 https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti_i_Ri_i_UT_5916d9f405.pdf

29- Evidenca I.16 Tabelat Permbledhese Aneks RVB ASCAL, Tabela 10

30 Evidenca I.31 Procedure transferimi studimesh

31 Evidenca I.2 Statuti i Univeritetit te Tiranes, Neni 89, fq. 56 https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti_i_Ri_i_UT_516d9f405.pdf

32 Evidenca I.50 Seminar i hapur i zhvilluar ne Departamentin e Kimise Industriale, i ftuar Prof.Dr. Dhimiter Haxhimihali

34 Evidenca I.50.1 Leksion i hapur i zhvilluar ne Departamentin e Kimise Industriale i ftuar Prof.Asoc. Octavian Barna Pershkrimi i projektit NETCHEM https://fshn.edu.al/notifications/i1et-chem-ict-networking-for-overcoming-technical-and-social-barriers-i11-instrumental- analytical-chemistry-education-2019

35 Evidenca I.45 Projekti NETCHEM http://www.netcham.ac.rs/document=download.send&id=\699&catid=324&m=0

Ilttp://www.netchem.ac.rs/document Iask=doĕn\oad.send&id=\699&catid=324&m=0

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Erasmus+ jane realizuar 6 workshop-e me pjesmarjen edhe te studenteve.Nga bibliografia e cituar jepet nje evidence 1.45, që në fakt është një shkëmbim e mail ku nuk jepet informacion për 6 ëorkshope. Nga bashkepunimi me Njësinë Nanoalb pranë Akademise se Shkencave u realizua ëorkshop i parë i Nanoalb me pjesemarrjen edhe të studenteve([35]). **Shpjegimet e ofruara në raport për këtë kriter nuk janë shumë sqaruese që të justifikojnë përmbushjen e këtij kriteri, sepse kerkohet trajnimi i studenteve te diplomuar dhe jo atyre qe jane ne proces.** | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ gjykon që standarti është i përmbushur kryesisht sepse Shpjegimet e ofruara në raport për këtë kriter nuk janë sqaruese që të justifikojnë përmbushjen plotësisht , të standartit mbasi kerkohet trajnimi i studenteve te diplomuar dhe jo atyre qe jane ne proces të edukimit* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Statuti dhe Rregullorja e UT-se janë dokumenta ligjorë që rregullojnë mënyrën e bashkëpunimit brenda institucionit për mbarevajtjen e programit të studimit. UT operon në veprimtarinë e vet përmes njësive akademike, ndihmës-akademike dhe administrative që funksionojnë në nivel Rektorati dhe të njesive [36] Dekanati i FSHN bashkerendon oraret mesimore[37]dhe komunikimin midis njesive bazë të FSHN për lendët e programit të studimit që ofrohen nga departamentet e tjera si: Bioteknologjia, Matematika, etj. |

36 Evidenca I.51 Workshop of NanosAlb Albanian unit of nanoscience and nanotechnology Academy of Sciences of Albania, 17th December 2021 Tirana, Albania

37 Evidenca I.2 Statuti i Univeritetit te Tiranes, Neni 8, Pikat 1-7 fq. 5

https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 59 16d9f405.pdf

38 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes, Neni 47, Pika dh, fq. 30

| | |
|---|---|
| | Dekanati miraton paraprakisht kriteret, kuotat e pranimit te studenteve (38,39,40). dhe ja përcjell më tej për miratim përfundimtar Senatit Akademik. Me fillimin e vitit akademik, drejtuesi I Departamentit, përcakton kujdestarët akademik për ciklin Bachelor dhe atë Master. Roli I tyre është ndima ndaj studentëve respektivë[41]. Një detyrim akademik për stafin e departamentit është rishikimi dhe përditsimi I silabuseve të disiplinave akademike që ata mbulojnë[42]. Nën drejtimin e drejtuesit të departamentit, personeli akademik angazhohet edhe në veprimtari të tjera si transferimi I studentëve në programe të tjera apo institucione të tjera,[43],[44] punësimi I stafit akdemik dhe ndihmes akademik[45],[46], hartimi I kërkesave për buxhet, pjesmarrje në komisionet mbrojtjes së diplomes[47] etj. Një veprimtari tjetër ku bën pjesë stafi I departamentit, është edhe pjesmarrja në komisionet "Ad-hoc" për shqyrtimin e transferimeve dhe degëve të dyta[48]. Për cdo vit akademik, departamenti përgatit raportin e punës vjetore mesimore, kerkimore/aktiviteteve, nën drejtimin e drejtuesit të Departamentit, i cili e koordinon këtë veprimari me Zëvendës Dekanin për kërkim shkencor[49]. Raporti I përgatitur nga FSHN, përcillet në Rektorat dhe shërben si material referues për hartimin e Raportit Vjetor ne nivel Universiteti[50]. Në raport ka informacion të detajuar për cilesine e mësimdhënies, botimet dhe aktivitetin shkencor në tërësi, ku përfshihen pjesmarrjet në konferencat kombetare dhe nderkombetare, projcktet konkrete shkencore dhe infrastruktura laboratorike. Në UT funksionojnë këshillat e studenteve[51], të cilat nxisin pjesmarjen e studenteve dhe koordinojnë veprimaritë |

38 Evidenca I.33 Vendim SA nr.16 date 27.02.2023 Per miratim kuotash viti akademik 23-24

40 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

41 Evidenca I.2 Statuti i Univeritetit te Tiranes, Neni 90, Pika I dhe 6, fq. 56-57 https://ani.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 59 l6d9f405.pdf

41 Evidenca I.35 Kujdestaret akademik te studenteve te programil Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologiite Ushqimore"

42 Evidenca I.36 Njoflim per firmosjen e syllabuseve

43 Evidenca I.2 Statuti i Univeritetit te Tiranes. Neni 109, fq. 64 https://ani.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 5916d9f405.pdf

44 Evidenca I.37 Komisionet e shqyrtimit te dosjeve Dege e II & Transferime

45 Evidenca I.38 Procedure punesimi per personel akademik efektiv (PAE)

46 Evidenca I.39 Manual punesimi i stafit ne UT

47 Evidenca I.41 Model evidence te vleresimit ne mbrojtjen e diplomes te programit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore

48 Evidenca I.37 Konisionet e shqyrtimit te dosjeve Dege II & Transferimet

49 Evidenca I.42 Raportet vjetore te FSHN

50 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes, Neni 147, fq. 76

51 Statuti i keshillit studentor https://fshn.edu.al/info/statuti-i-keshillit-studentor

| | |
|---|---|
| | studentore si dhe i inkurajojnë studentët për të përfaqsuar veten e tyre në organet drejtuese të institucionit[52].<br>Në nivel institucional, UT ka ngritur Komisionin për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhenieve me Studentet[53]. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Në Ligjin e Arsimit të Lartë Neni 3, Pika 4[54] · ligjërohet e drejta e personelit akademik për të lidhur marrëveshje me persona juridike, publike dhe private, vendas ose te huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhenese, kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera. Nisur nga kjo e drejtë edhe programi i studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" i realizon objektivat e tij akademike jo vetëm përmës përpjekjeve në institucion, por edhe bashkëpunimit me institucione të tjera arsimore dhe kërkimore. Shembuj të tillë në UT, kemi nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkepunimit në kuadër te programeve si Erasmus+[55], [56]etj https://unitir.edu.al/marreveshjet-bilaterale-2/ Përmes këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi është orientuar_në ;shkëmbimin e eksperiencës akademike, realizimin e projekteve të përbashketa kërkimore / zhvillimore, kualifikimet e pedagogëve, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programeve Erasmus, realizimit të praktikave, leksioneve të hapura, aplikimit për projekte të perbashketa.Nga statistikat e referruara rezulton se UT gjatë viteve 2019-2023 ka nënshkruar 42 marrëveshje, ne kuader te Erasmus +[57].UT rezulton të ketë një numër të konsiderueshëm bashkëpunimesh me universitete homologe[58]. DKI rezulton i përfshirë në projektin NETCHEM, brenda kuadrit të programit Erasmus+[59], [60]. Ne kuader te projektit të mësipërm DKI ka realizuar edhe disa ëorkshop-e me |

52 Evidenca I.43 Vendim SA Nr.08, dt.30.01.2023 "Per perzgjedhjen e anetareve te komisioneve te perhereshme per sigurimin e Standardeve te Cilesise ne Universitetin e Tiranes" https://unitir.edu.al/komisioni-i-perhershem-per-sigurimin-e-standardave-te-cilesise

53 Evidenca 1.44 Rregullore e Komisionit te mbarevajtjes se veprimtarise dhe marredhenieve me studentet https://unitir.edu.al/up-content/uploads/2020/05/Rregullore-e-komisionit-t%C3%AB-mbar%C %.ABvajtjes-s%C3%AB- veprimtaris%C3%AB-dhe-marr%C3%ABdh%C3%ABnicë-m.:-stude1 1t%C3%ABt.pdf

54 Ligji Nr. 80/2015 "Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor ne IAL ne Republiken e Shqiperise" Neni 3, Pika 4-c hllp://arsimi.gov.al/up-content/uploads/2018/08/AKTET NENLIGJORE.pdf

55 Evidenca I.3 Strategjia e Zhvillimit te Universitetit te Tiranes 2023-2028, Pika 2, fq. 9 https://unitir.edu.al/ëp-content uploads/2024/0 I/Strategjia-e-Zhvi l limit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028.pdf

56 Marreveshjet ERASMUS+KA 107 te nenshkruara nga Universiteti i Tiranes https:/unitir.edu.a l/marreveshjet e-nenshkruara-nga-univers iteti-i-tiranes/ https://unitir.edu.al/arkiva-mareveshjet-erasmus-ka107-te-nenshkruara-nga-universiteti-I tiranes/

57 Marreveshjet ERASMUS+ KA107 te nenshkruara nga Universiteti i Tiranes https://unitir.edu.a l/marreveshjet-erasmus-ka l-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes

58 Arkiva-Marreveshjet ERASMUS+ KA107 te nenshkruara nga Universiteti i Tiranes htts://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes

59 Marreveshjet ERASMUS+ KAI07 te nenshkruara nga Universiteti i Tiranes https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/ Arkiva-Marreveshjet ERASMUS+ KAI07 te nenshkruara nga Universiteti i Tiranes https://unitir.edu.al/arkiva-marreveshjet-erasmus-ka 107-te-nenshkruara-nga-universiteti i-tiranes/

60 Pershkrimi i projektit NETCHEMI https://fshn.edu.al/Notification/net-chem-ict-11networking-for-overcoming-technical-and-social-barriers-in-instrumental- analytical-chemistry-education-21119 http:/www.netchem.ac.rs/about-project/s11111111arv

| | |
|---|---|
| | pjesemarjen edhe te studentëve[61]. Aktiviteti shkencor i DKI në projekte [62], në vitet e fundit ka qënë i orientuar edhe në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave, ku së bashku me të u formua Njësia e Nanoshkencës dhe Nanoteknologjise Shqiptare (Nanoalb) [63].,[64], ku janë përfshirë anëtarë të DKI. Me shumë interes shihet përfshirja edhe e studentëve të nivelit mastër në disa nga projektet që zotëron DKI . Më kokretisht citohet që:në projektin e financuar nga AKKSHI\ISUV me titull 'Dedektimi kromatografik i nitrofuraneve në ushqime me origjine shtazore', është perfshirë një student i nivelit Master. Po ashtu në projektin me titull 'Vlerësimi i cilësisë së ajrit nëpermjet monitorimit të përqëndrimit të grimcave të imta me permasa 2.5 µm në zona urbane, sub-urbane'", është i angazhuar një tjerër student i nivelit Master. FSHN [65] ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani që ushtrojnë aktivitet në fushën që mbulon DKI [66].Ne keto kompani studentët kryjne trajnime ose intership. DKI ka lidhur marrëveshje dhe aktivitete brenda fushes qe mbulon Departamenti i Kimise Industriale dhe programi i studimit Master i Shkencave si "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"[67], [68] si ISUV etj. |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon | Fakulteti dhe Universiteti kane lidhur marreveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave mesimore në Programin e ciklit të dytë[69],[70]. Më konkretisht në raportin e analizës vjetore rezulton se DKI ka lidhur 7 marrëveshje bashkëpunimi për të gjitha programet që ofron ky departament. Këto marrëveshje përdoren për aftësimin praktik të studentëve. Një mundësi e mirë për aftësimin praktik janë edhe laboratorët mësimorë në dispozicion të FSHN, për lëndët karakterizuese[71].Po kështu aftësimit dhe zhvillimit akademik të stafit dhe studentëve ju kanë kontribuar mobilitet e kryera jashtë vendit në kuadër të programit Erasmus +.[72] Në citimet e referuara pasqyrohet një |

61 Evidenca I.45 Projekti NETCHEM

62 Evidenca I.42 Raportet vjetore te FSHN

63 Njesia e Nanoshkences dhe Nanoteknologjise Shgiptare http://www.nanoalb.al/nanoalb/about.php

64 Evidenca I.42 Raportt vjetore te FSHN

65 Evidenca I.42 Raporte vjetore te FSHN

66 Evidenca I.46 Marreveshje bashkepunimi mbi realizimin e praktikave dhe intershipeve te studenteve

67 Evidenca I.42 Raport vjetor i FSHN 2023-2024, fq 30 Marreveshje bashkepunimi te FSHN me institucione te tjera

68 Evidenca I.16 Tabela Permbledhese Aneks RVB ASCAL, Tabela 5

69 Evidenca I.42 Raportet vjetore te FSHN

70 Evidenca I.46 Marreveshje bashkepunimi mbi realizimin e praktikave dhe internshipeve te studenteve

71 Evidenca I.49 Lista e marreveshjeve te Fakultetit te Shkencave te Natyres

Evidenca I.9 Plani Mesimore i Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", 21-23, 22-24

72 Evidenca I.52 Mobilitet stafi dales Jonida Canaj, Aferdita Shtembari

| | |
|---|---|
| me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve. | mobilit agreement të një anëtari të stafit akademik( J Canaj). |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Drejtuesi i Departamentit per realizimin e analizes vjetore njofton[73] rregullisht stafin akademik të DKI për marrëveshjet e bashkepunimit të cilat pasqyrohen në raportin e analizës vjetore të Departamentit [74]. Në raportin e analizës vjetore të Dep [75],[76], citohet që informacioni jepet kryesisht për projekte të përbashkëta. Kjo pasqyrohet edhe në raportin vjetor të FSHN. Analiza vjetore i percillet Dekanatit per raportimin vjetor ne nivel fakulteti dhe vihen në funksion të realizimit të programit të studimit Master i Shkencave si "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë aftësuar stafin akademik në mësimdhënie por edhe në kërkimin shkencor. |
| **Konkluzione** | *GVJ mendon se DKI ka bërë përpjekje për të siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologiite Ushqimore"

| **Standardi II.1** |
|---|
| **Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** |

73 Evidenca I.47 Njoftim mbi pergatitjen e analizes vjetore nga Departamenti i Kimise Industriale

74 Evidenca I.48 Analiza Vjetore e Departamentit te Kimise Industriale

75 Evidenca I.52 Mobilitet stafi dales Jonida Canaj, Aferdita Shtembari

76 Evidenca I.53 Mobilitet stafi hyres Octavian Barna

| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Master i Shkencave është ideuar në përputhje me Ligjin Arsimit te lartë në Republiken e Shqiperise" [77]dhe Udhëzimin nr. 15 dt. 04.04.2008 "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë"[78]. Programi Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" (SHTU) është i organizuar në veprimtari formuese ku në përfundim të tyre vlerësimi realizohet me kredite në perputhje edhe me Sistemin Europian të Grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve (ECTS) [79], [80]. Plani mesimor realizohet në 2 vite studimi ose në 4 semestra[81], [82]. Programi realizohet me 120 ECTS në total, ku 1 kredit është ekuivalent me 25 orë mësimore në auditor dhe studim individual[83]. Sasia mesatare e punës se kryer gjatë një viti studimesh, nga një student është 60 kredite ose 1500 orë mësimore pune të studentit. Programi i studimit Master i Shkencave SHTU është hartuar nga Departamenti Kimi Industriale dhe është miratuar ne Senatin Akademik[84]. Kreditet e lëndeve janë pasqyruar në syllabuset sipas VKM Nr. 41 date 24.01.2018 dhe janë pasqyrar edhe në kurrikulen dhe planin mësimor të cdo viti akademik. Në programin e këtij Masteri janë pasqyruar [85]<br><br>• Organizimi i Programit te Studimit<br>• Personeli akademik që realizon programin<br>• Plani Mesimor;<br>• Programet e lendëve/Syllabuset<br>• Rregullorja e programit<br>• Modeli i Diplomes dhe Suplementi i Diplomes<br>• Personeli ndihmes akademik<br>• CV e Personelit Akademik për programin Master |

77 Ligji Nr. 80/201S"Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor ne IAL ne Republiken e Shqiperise" Neni 75, fq.51 http://arsimi.gov.al/ëp-contenr/uploads/20 I8/08/AKTET NENLIGJORE.pdf

78 Udhezimi Nr. 19, i MASH, dL 04.04.2008 "Per organizimin e studimeve ne institucionet publike te arsimit te larte"

79 Ligji Nr.80/2015 "Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor ne Institucionet e Arsimit te Larte ne Republiken e Shqiperise",Neni 75, Pika 3; Neni 76 Pika 1,3, 4 fq.51 http://arsimi.gov.al/up-content/uploads/2018/08/AKTET NENLIGJORE.pdf

80 Evidenca I.2 Statuti i Univeritetit te Tiranes, Neni 92 Pika 2. Neni 94 https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 591 6d9f405.pdf11K VKM- Nr. 41, date 24.1.2018 "Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga institucionet e arsimit te larte" https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM nr 41 date 24 I 2018 9fab9l64a8.pdf

81 Evidenca I.9 Plani Mesimor i Programit Master SHTU 2020-2022;2021-2023;2022-2024

82 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", Neni 3

83 Evidenca I.9 Plani Mesimore i Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" 2020-2022;202 I-2023; 2022-2024

84 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes perditesuar 2016, Organizimi, Struktura, Elementet e Studimeve, Neni 31, https://fshn.edu.al/info rregullore/notifications/rregullore-e-u1-perditesuar

85 VKM- Nr. 41, date 24.1.2018 "Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga institucionet e arsimit te larte" https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM nr 41 date 24 I 2018 9fab9l64a8.pdf

Për vlerësimin e dijeve të përfituara janë përdorur forma te ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me ate përfudimtar.

Në strukturën e vitit akademik semestri është parashikuar me 15 javë dhe 3-4 javë provime. Struktura akademike e cdo viti shpallet në faqen zyrtare të Fakultetit.[86] Plani mësimor merr miratimin e tij tek Dekani dhe Rektori në cdo vit akademik. Për secilin nga kurset hartohen programet mësimore (syllabus)[87]. Veprimtarite formuese zhvillohen si lëndë të detyrueshme ose me zgjedhje nga vete studentet. Veprimtaritë formuese klasifikohen sipas VKM nr.41 nga A ne E, sipas metodologjisë së paraqitur ku:

Lendët e kategorise A + B plotesojne jo me pak se 60 % te numrit te pergjithshem te krediteve[88] Në planin mësimor [89] janë parashikuar 17 disiplina .formuese, nga të cilat një detyrim është mbrojtja e diplomës. Disiplinat janë të ndara në 13 të detyrueshme dhe 3 me zgjedhje. Lëndët me zgjedhje, përzgjidhen nga studentët midis 6 lëndëve që janë përcaktuar si të tilla. Në total këto tre lënde akumulojnë 13 kredite .Sipas tiplogjisë së tyre disiplinat formuese ndahen në përqindje si më poshtë [90]:

- Tipologjia A përfshin 1 lëndë me 6 kredite ose 5%
- Tipologjia B 10 lëndë me 60 kredite ose 50%
- Tipologjia C 4 lëndë me 19 kredite ose 16%
- Tipologjia D lëndë me 5 kredite ose 4 %
- Tipologjia E përfshin punimin e diplomës me 30 kredite ose 25%

Në llogaritjen e krediteve të disiplinave të vitit të parë, duhet të bëhej më shumë kujdes në llogaritjen e krediteve, mbasi rezulton që brenda tipologjisë së tipit B lëndë si ***"Mikrorganizmat industrial dhe …..",*** ku totali i orëve që mbulon lënda është 60 orë rezulton se sasia e krediteve është 5 kredite, ndërsa lënda "Ndotjet në produktet e Industrisë ushqimore" me 45 orë me 6 kredite. Në planin mësimor nuk është pasqyruar praktika profesionale e cila kryhet në semestrin e 4, kur studentët punojnë njëkohësisht për përgatitjen e tezës së

86 Evidenca II.17 Struktura Akademike e vitit aktual ne faqen zyrtare FSHN https://fshn.edu.al/info/struktura-akademike

87 Evidenca I.17 Komunikim me email per perditesimin e syllabuseve

88 VKM- Nr. 41, date 24.1.2018 "Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga institucionet e arsimit te larte" Tabela 2 https://api.fshn.edu.al/uploads/VKM nr 41 date 24 1 2018 9fab9164a8.pdf

89 Evidenca I.10 Programet e lendeve (Syllabuset) Programi Master SH-ITU. Per vitet akademike 2020-2022; 2021-2023; 2022- 2024

90 Evidenca I.16 Tabela permbledhese per Aneks RVB, Tabela 9-Plani mesimor i ndare sipas Veprimtarive Formuese (A-E

| | |
|---|---|
| | diplomës. Praktika profesionale si veprimtari formuese nuk pasqyrohetne kurrikul me ore dhe kredite.<br>Ne përfundim të programit të ciklit të dytë, lëshohet diploma Master Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore".[91]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "SHTU", synon drejt një formimit me karakter profesional të studentëve, prandaj i jepet shumë prioritet aftësimit të tyre në laboratorët mësimorë, ku studentët zhvillojnë aftesitë praktike. DKI që është përgjegjës për këtë program s tudimi, zotëron disa laboratore[92], ku ka 9 laboratorë mësimor shkencor, me 12-15 vende pune për studentët. Laboratorët kanë mjete dhe aparatura për realizimin e praktikave laboratorike, sipas lëndeve të programit të studimit. Laboratorët për realizimin e programit të studimit janë[93]:<br><br>• Laboratori mësimor dhe shkencor i **Teknologjisë Ushqimore** për lëndët Koncepte të avancuara në kimi dhe teknologji ushqimore.<br>• Laboratori mesimor dhe shkencor i **Mikrobiologjise Ushqimore** per lendet Mikrorganizmat industriale dhe bioteknologjia e fermentimeve.<br>• Laboratori i Inxhinierise kimike per lëndën **Inxhineria e proceseve biokimike.**<br>• Laboratori mësimor i **Inxhinerisë Kimike II**, për lëndën Modelimi dhe simulimi i proceseve.<br>• Laboratori për lëndën **Teknologji molekulare të aplikuara** në industrinë ushqimore.<br>Studentet angazhohen gjithashtu edhe në projekte të lidhura me industrinë. Programi i Studimit në ciklin e dytë Master i Shkencave SHTU synon përgatitjen e specialisteve të lartë te cilet mund të angazhohen dhe punojnë ne disa profesione të lidhura me ushqimin[94]. Studentët përmes këtij programi profilizohen për hallkat e prodhimit, manaxhimit, ruajtjes, kontrollit të cilesisë e sigurisë dhe certifikimit të ushqimeve. Synimi është t'i përgjigjen nivelit më të lartë sipas standarteve të Bashkimit Evropian. Ata përgatiten si specialist kimistë në fushën e analizave kimiko-fizike dhe mikrobiologjike të ushqimeve, për arritjen e cilesisë dhe sigurisë |

91 Evidenca II.5 Modeli i Diplomes per Programin e studimit Master i Shkencave "SHTU"

92 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", Neni 12

93 Evidenca I.18 Përbërja e hollësishme e infrastrukturës funksionale mësimore shkencore në shërbim të Programit studimit Master "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" të Departamentit të Kimisë Industriale

94 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER SHKENCOR "SHKENCAT DHE TEKNOLOGJITË USHQIMORE"

| | |
|---|---|
| | ushqimore .Përmes këtij programi ata kontribojnë në të gjitha etapat e zinxhirit ushqimor për transformimin e lendeve te para me origjine bimore, shtazore, duke përdorur teknologji të avancuara të përpunimit[95].<br>Programi ofron njohuri në lidhje me kontrollin e cilesisë dhe sigurisë ushqimore sistemet e certifikimit, të akreditimit në industrinë ushqimore dhe ligjishmërinë ushqimore, duke ju dhënë mundësi punësimi edhe në institucione të administratës shtetërore dhe private, të vlerësimit dhe menaxhimit të riskut në hallka të ndryshme të zinxhirit ushqimor. Aftësitë që fitohen në përfundim të ciklit të dytë pasqyrohen në seksionin "Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit" tek syllabuset e lëndës[96]. Ky program ofron përgatitje për:<br>• Të kryer punë kerkimore të pavarur në detyra të ndryshme zbatimi dhe projektimi.<br>• Të shfrytezuar literaturën shkencore të fushës në gjuhë të huaj.<br>• Tu përgatitur si specialist të kompletuar, në fushën e ushqimit të aftë profesionalisht, për sfidat bashkëkohore.<br>• Tregu ka kërkesa të larta për specialiste të kësaj fushe[97]. Të diplomuarit në këtë program mund të punësohen:<br>• Në industri të prodhimit ushqimor dhe përpunimit të lëndeve të para me origjinë shtazore dhe bimore.<br>• Laboratore të kontrollit të parametrave të cilesisë dhe sigurisë ushqimore publike dhc private.<br>    o Në laboratorë të kërkimit të fabrikave prodhuese në vend<br>    o Si specialiste në qëndrat rajonale të AKU, në komuna apo bashki<br>    o Në Industrinë e manaxhimit te mbetjeve, trajtimit të ujit të pijshëm, ajrit, dhe riciklimit të mbetjeve<br>• Në Institucione të kërkimit dhe zhvillimit (ISUV.)<br>• Në Institucione Akademike(Universitete dhe institucione Arsimore)<br>Në këtë program jep mësim një staf i kualifikuar[98] dhe me shumë njohuri.Falë eksperiencës së tyre dhe njohurive të spikatura, ata kanë hartuar silabuset ku shprehen aftësitë e studentëve pas përfundimit të këtij programi [99]. |

95 Evidenca I.9, Plani mesimor I programit Master

96 Evidence I.10, Silabuset e lendeve

97 Evidenca I.20. Rregullore e programit master, neni 2, pika 4

98 Evidenca I.24. CV e stafit te DKI

99 Evidence I.10, Silabuset e lendeve

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi Master është i fokusuar për të përgatitur specialistë që do ti shërbejnë sektorit të prodhimit industrial për industrinë ushqimore dhe prandaj e vlerëson maksimalisht aftësimin e studentëve përmes praktikës profesionale. FSHN dhe departamenti përkatës ka mundësuar lidhjen e disa marrëveshjeve me Industrinë ushqimore dhe Institucionet e ndryshme studentet ku mundësohet kryerja e vizitave dhe marja e njohurive[100].' Rezulton se Deparatmenti ka lidhur marrëveshje me 17 institucione, por jo të gjitha janë të fushës së industrisë ushqimore. Departamenti nëpërmjet pedagogut përgjegjes për realizimin e praktikave njofton studentët për kohën e kryerjes, menyrën e zhvillimit dhe programin e praktikës. Praktika mësimore është e detyrueshme të frekuentohet 1 00%.<br>Në raport thuhet që pedagogu mban lidhjet midis studentëve, dhe institucionit pritës ku kryhet praktika. Kur përfundon praktikën studenti paraqet një relacion reth saj[101]. Përgjithësisht praktika kryhet në institucione të industrisë ushqimore, por studentët mund të bëjnë edhe zgjedhje individuale psh në laboratorë ku shpesh realizojnë edhe temat e tyre të diplomës. Në përfundim edhe të këtij detyrimi akademik studentët kryejnë mbrojtjen e temës së diplomës.që është e ngarkuar me 30 kredite. |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | **N/A** |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të | **N/A** |

100 Evidenca I.49 Lista e marreveshjeve te Fakultetit te Shkencave te Natyres

101 Evidenca IV.39 Model Raporti mbi Praktiken e zhvilluar nga student ne nje institucion publik/privat

| | |
|---|---|
| përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Programi i studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" realizohet me ndjekje të mësimit me kohë të plotë. Pranimi i studenteve në Programin e Ciklit të Dyte te studimeve Master i Shkencave në"Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", në FSHN të UT realizohet bazuar në Nenin 75, të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Udhëzimet e përvitshme të MAS; në kriteret e parashikuara në Rregulloren e Universiteti të Tiranës, dhe kriteret e kuotat e propozuara nga DKI [102] dhe të miratuara nga Senati Akademik i UT. Procedura kalon në këto hapa:<br>1. Departamenti propozon kuotat e pranimit, kriteret e përzgjedhjes rë aplikantëve<br>2. Dekanati bën publike kriteret e përcaktuara jo më vonë se mbyllja e vitit paraardhës akademik<br>3. Kriteret i percillen rektoratit, i cili ja percjell MAS.<br>4. Drejtuesi i DKI ngre një komision me tre anëtarë të departamentit, (PAE), i cili shqyrton dosjet dhe ja paraqet për miratim listën e kandidatëve fitues, drejtuesit të departamentit.<br>5. Pergjegjësi i departamentit miraton studentët fitues, per programin e studimit "Shkencat dhe Tcknologjite Ushqimorc", dhe e dergon për miratim tek Dekani[103].<br>6. Dokumentacioni i aplikimit, afatet e shqyrtimit, shpallja e rezultateve, afatet e ankimimit dhe regjistrimi i kandidateve fitues përcaktohen në udhëzimin e MAS.<br>7. Pas perfundimit të procesit të regjistrimit të kandidateve fitues, UT-ja percjell në QSHA listën e studenteve të regjistruar, me qëllim pajisjen e tyre me numër matrikullimit (NIM). |

102 Evidenca I.34 Kriteret-e-pranimit-ne-ciklin-e-dyte-viti akademik 2023-2024.pdf
103 Evidenca II.22

| | |
|---|---|
| | 8. UT shpall publikisht procedurën e aplikimit,në faqen zyrtare të FSHN dhe UT.<br>Procedura e pranimit bëhet konform udhëzimeve të MAS[104]:<br><br>Më kokretisht pranohen kandidatët që zotërojne diplomë universitare "Bachelor" në drejtimet:<br>• Kimi dhe Teknologji Ushqimore<br>• Kimi Industriale e Mjedisore<br>• Kimi<br>• Bioteknologji Biokimi<br>• Inxhinieri Agroushqimore<br>• Inxhinieri Kimike<br>Si dhe plotesojnë kriteret shtesë të përcaktuara nga DKI, nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjeter njëkohësisht si dhe paguajnë tarifën shtetërore të programit. Pranimi i studenteve nga dege të tjera, i nenshtrohet ekuivalentimit të diplomes nga komisioni i ngritur nga DKI[105] .DKI përzgjedh studentët fitues dhe ja përcjell listën dekanit i cili bën miratimin formal[106]. Po kështu këtë të drejtë e kanë edhe studentët që kanë përfunduar një program studimi, dhe duan të ndjekin një të dytë por duke përballuar kostot[107]. Përjashtohen nga pagesa studentët e shkëlqyer. |

104 Evidenca I.20 Rregullore e programit te srudimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", Neni 12

105 Evidenca II.21 Shkrese e ngritjes se Komisionit Ad-hoc per transferim ose/ dhe ekuivalentim

106 Evidenca I.34 Kriteret e pranimit te studenteve viti akademik 2023-2024 hllps://api.fshn.edu.al/uploads/Viti akademik 2023 2024 5d49b89b4d.pdf

107 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 42 https://unitir.edu.al/up content/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Programi i studimit Master i Shkencave SHTU është në të njëjtën fushë studimi me Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master i shkencve në "Inxhinieri Agroushqimore", i ofruar nga Fakulteti Bujqesisë dhe Ushqimit në Universitetitn Bujqesor te Tiranes. Të dy këto programe mbulojnë fusha të ngjashme si teknologjite ushqimore, mikroorganizmat industriale, si dhe aplikimi i tyre si dhe disiplinat që lidhen me cilësinë dhe sigurinë ushqimore. Kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve sanksionohen në Rregulloren e UT dhe udhezimet e MAS[108]. DKI ngre komisionin ad-hoc që shqyrton njohjen e plotë apo të pjesshme të krediteve për studentët që transferohen nga brenda apo jashtë universitetit[109]. Komisioni vlerëson kërkesen dhe dokumentacionin e nevojshëm sipas përcaktimeve të Rregullores së UT dhe bën njohjen e ngjashmerisë së lendeve dhe krediteve përkatese për lëndet e përmbyllura dhe vlerëson ngjashmerine e programit në nivel, së paku 70%. |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Në UT programet e studimit të ciklit të dytë (Master), kanë kodet specifike për të identifikuar fushën e studimit dhe lëndët përkatese. Kodifikimi i programit të studimit dhe kodifikimi i lendëve bëhet sipas udhezimit Nr.3 I, date 15.11.2022 "Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqiperise"[110]. FSHN është përgjegjës për kodifikimin në perputhjc me Rregulloret e UT dhe Udhezimet e Ministrise se Arsimit. Kodi i Programit Studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" është [111] 72MS0711SH, sipas V.K.M nr.1225, dt.03.09.2008. |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i studimit Master SHTU që ofrohet nga DKI nuk është një program I përbashkët me institucione vendase apo të huaja. |

108 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 80

109 Evidenca II.21 Shkrese e ngritjes se Komisionit Ad-hoc per transferim ose/ dhe ekuivalentim

110 Evidenca II.30 Udhezimi Nr.31, date 15.11.2022 "Per procedurat per kodifikimin e programeve te studimit te ofruara nga Institucionet e Arsimit te Larte ne Republiken e Shqiperise".

111 Evidenca II.13 Kodifikimi i programeve te studimit ne FSHN

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Programi i studimit organizohet në pergjithesi ne përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.GVJ shpreh opinionin qe ky program studimi është konfrom legjislacionit në fuqi dhe akteve regulatore të Institucionit, por theksojmë nevojën në pasqyrimin korrekt në kurrikul dhe planin mësimor të praktikës profesionale me orë dhe kredite* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Fakulteti i Shkencave të Natyrës funksionon në përputhje me kerkesat e Ligjit Nr. 80/2015 si dhe në mbështetje të Statutit të UT[112].[113] FSHN, ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, dhe bën përpjekje për përmirësimin e infrastrukturës së mesimdhenies, mesimnxenies dhe kërkimit shkencor[114]. FSHN është nga fakultetet më me përvojë në UT. Ai përbehet nga 8 departamente dhe 1 qënder kërkimore me staf akademik me grada/tituj si Prof.Dr/, Prof. Asoc. Dr./ Dr. dhe Msc. FSHN dhe departamentet e tij kryejnë aktivitetet brenda një infrastrukture të përshtateshme për të garantuar plotesuar misionin[115].<br>Me kohë të plotë në vitin akademik 2023-2024 janë të angazhuar 17 pedagoge me këtë përbërje: 4 (kater) me titullin akademik "Profesor"; 3 (tre) me titullin akademik"Prof Asoc"; 9 (nente) me gradën shkencore"Doktor i Shkencave"; 1 (nje) asistente lektore. Me kontratë janë të angazhuar 2 (dy) Prof Asoc; 3( tre) Dr; dhe 3(tre) Master i Shkencave, Si ndihmës akademikë janë angazhuar 5 punonjës. Referuar dy viteve të mparshme akademike përbërja ka qënë përkatësisht:në vitin 2021-2022 janë angazhuar: 19 PAE (3) Prof. Dr; (4) Prof. Asoc; (10) Dr; (2) MSc; dhe 12 PAK (2) Prof. Dr; (2) Prof. Asoc; (3) Dr; (-) Dr.proc. (5) MSc.. Ne vitin akademik |

112 Ligji i Arsimit te Larte Nr.80/2015, Kreu III, Institucionet e Arsimit te Larte, Neni 23 (Fakulteti). pika 3

113 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes Kreu 11, Organizimi dhe Strukturat perberese, Neni 11, Njesite Perberese te UT https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 5916d9f405.pdf

114 Evideaca I.21 Historiku i Universitetit te Ti.ranes https://unitir.edu.al/historiku/

115 Evidenca I.22 Infrastruktura e Fakultetit te Shkencave te Natyres

| | |
|---|---|
| | 2022-2023 janë angazhuar: 19 PAE (3) Prof. Dr; (4) Prof. Asoc; (10) Dr; (2) Dr.proc;.dhe 12 PAK(2) Prof. Dr. (2) Prof. Asoc; (3) Dr. (-) Dr.proc. (6) MSc.<br>• Zv. Dekan per kurrkulat e Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë të Studimeve që ka për detyrë përgatitjen dbe zbatimin e planeve dhe programeve mësimore të ofruara sipas departamenteve.<br>• Zv. Dekani për Projektet Shkencorc dhc Qcndrat për Kërkim-Zhvillim që mbikqyr dhe koordinon veprimtarinë shkencore të njësive bazë të FSHN.<br>• Zv dekanin për doktraturën<br>DKI ka në përberje personel akademik me tituj e grada shkencore në përshtatje me Ligjin e AL, të punësuar me kohe të plote, si personel akademik[116],[117].<br>FSHN në strukturen organizative drejtuese ka[118]:<br><br>Bazuar ne Statutin e UT njësia bazë për ofrimin e këtij programi ëstë DKI që ofron; 5 programe studimi,në Bachelor (Kimi dhe Teknologji Ushqimore dhe Kimi Industriale Mjedisore) si dhe 3 programe Master i Shkencave ne:<br><br>I. Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore (SHIU)<br>II. Inxhinieri e Proceseve Kimike (IPK)<br>III. Kimi Industriale e Mjedisore (KIM)<br><br>DKI (FSHN) ofron edhe programe të ciklit të tretë. Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore "funksionon me këtë strukturë organizative: Pergjegjësi i DKI është autoriteti më i lartë për Master i Shkencave SHTU dhe pergjigjet për realizimin e misionit dhe veprimtarinë e gjithaneshme te këtij programi. Detyrat e tij I gjejmë të pasqyruara në Statutin UT, Rregulloren e UT si dhe Rregulloren e DKI.[119],[120]. DKI ka një staf akademik të kompletuar që përmbush detyrën e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, dhe shërbime për mbështetje dhe zhvillim të |

116 173https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-biologjise, https://fshn.edu.al/departmenls/departamenti-i-bioteknologjise, https://fshn.edu.al/departments/depanamenti-i-fizikes, https://fshn.edu.al/departaments/departamement-i-informatikes, https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise,https://fsh11.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale,https://fsh11.edu.al/departments/departamenti-i-matematikes, https://fshn.edu.al/deparments/departamenti-i-matematikes- aplikuar, https://fshn.edu.al/departament/qendra-kerkimore-e-flores- dhe-faunes

117 Evidenca I.16 Tabela pembledhese Aneks RVB. Tabela I

118 Evidenca I.23 Organigrama e Fakultetit te Shkencave te Natyres

119 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes: Neni 14, Pika 5 https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 591 6d9F405.pdf

120 Evidenca I.6 Rregullore e Departamentit te Kimise Industriale, Neni13

| | |
|---|---|
| | IAL, këshillim për studentet, si dhe veprimtari te tjera. Per vitin akademik 2023 - 2024 DKI ka 17 pedagog PAE , nga të cilët 4 janë me titull Prof, 3 Profesore të Asociuar, dhe 9 Doktor shkencash dhe një në process doktorature.[121],[122] Personeli ndihmës akademik ndahet në ndihmës akademik me karakter mësimor shkencor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ. UT ka ndërmarrë përmes këtij procesi përfshirjen në akreditim të Programit të Studimit të ciklit të dytë në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"[123],[124]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Mbështetur në Statutin e UT[125], DKI ka të angazhuar 5 personel ndihmës akademik ku 4 janë me karakter mesimor shkencor dhe një me karakter administrativ. Personeli ndihmes akademik me karakter mësimor shkencor[126] ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e mesimdhënies dhe/ ose te kërkimit shkencor. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Në mbështetje të Ligjit të AL[127] , DKI ka përcaktuar edhe koordinatorin e programit të studimit Koordinatori i programit harton një raport të detajuar për vijimësinë e programit, ku evidentohen problematikat e shfaqura gjatë vitit akademik[128]. Për cdo vit programit te studimit i bëhen përmirësime, me qëllim ngritjen e cilësisë së tij [129,130,131] Pervec drejtuesit të DKI, koordinatorit, funksionojnë edhe Përgjegjesit e Grupeve mësimore-kërkimore.[132]. DKI ka në përbërje 3 grupe mësimore kërkimore<br>1. Grupi Kimi dhe Teknologji Ushqimore<br>2. Grupi Teknologji Kimike<br>3. Grupi Inxhinieria e Proceseve |

121 Evidenca I.25 Kualifikimi i stafik akademik sipas grup-lendeve ku japin https:i/fslt11.cdu.al/depa11mc111s/dcparl<Imenti-i-kimise industriale

122 Evidenca I.16 Tabelat permbledhese ANEKS RVB ASCAL, Tabela 2, Lista e Personelit Akademik dhe ndihmes akademik te Departamentit KI

123 Evidenca II.9 Dokument aplikimi UT prane ASCAL per akreditimin e Programit te Studimit ne ciklin c dyte Master i Shkencave SHTU

124 Evidenca II.10 Dokument pagesa e Akreditimit te Programit te Studimit ciklin e dyte Masler i Shkencave SHTU nga UT

125 Evidenca I.6 Rregullore e Departamentit te Kimise Industriale, Neni 12

126 Evidenca I.16 Tabelat permbledhese ANEKS RVB ASCAL, Tabela 2, Lista e Personelit Akademik dhe ndihmes akademik te Departamentit KI

127 Ligji i Arsimit te Larte Nr. 80/2015, Neni 45, Pika 3.

128 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes, Neni 14

129 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 51, Pika 3 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/202"/08/rregullore -e-universitetit-te-tiranes.pdf

130 Evidenca I.42 Raporte vjetore te FSHN per vitet akademike 2021-2022, 20232024

131 Evidenca I.16 Tabelat permbledhese ANEKS RVB ASCAL, Tabela 11 Planet mesimore me ndryshime deri ne 20% Viti 2021

132 Evidenca II.11 Shkresa:Vendimi i Dekanit per emerimin e titullareve te grupeve mesimore kerkimore

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ shpreh opinionin që DIK përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, angazhimin e stafit akademik dhe atij ndihmës për të realizuar një program sa më cilësor.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | · DKI operon me një dokumentacion, të kompletuar si.<br>· Rregullorja e UT<br>· Rregullorja e DKI<br>· Rregullorja e programit të studimit të ciklit të Masterit SHTU<br>· Plani mësimor i programit të studimit të programit<br>· Programet e lëndëve<br>· Personeli akademik për realizimin e programit<br>· Kriteret e pranimit<br>· Modeli dhe Suplementi i Diplomës |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Master i Shkencave në SHTU realizohet me kohe të plotë me kohezgjatje 2 vjet, në katër semestra, dhe me 120 kredite. Semestri zgjat 15 javë për mesimdhënie dhe reth 3-4 javë për provime. Cdo semestër ka jo më shumë se 25 orë mësimore/ javë, të zhvilluara në auditor, përmes elementëve mësimorë si leksione, seminare, ushtrime, laboratore. Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga Dekanati në fillim të vitit akademik. Struktura akademike shpallet në faqen zyrtare të Fakultetit.[133] Një dokument i domosdoshëm [134] i Fakultetit është plani mësmor që hartohet dhe aprovohet në instancat drejtuese të institucionit. Cdo disiplinë formuese është formatuar me |

133 Evidenca III.12 Faqja zyrtare e fakultetit FSHN www.fshn.edu.al struktura e vitit akademik Ndarja e oreve mesimore ne auditor ne ore sipas elementeve te studimit per cdo disipline, percaktohet nga pedagogu pergjegjes/titullar i lendes ne baze te krediteve qe i jane caktuar lendes. Ne kete program studimi jane parashikuar disa forna mesimdhenie, ato jane te ndara qarte ne planin mesimor per cdo lende apo aktivitet tjeter formues.

134 Evidenca II.15 Komunikim per dorezimin e planeve mesimore/syllabus drejtuar titullarve te gruplendeve

| | |
|---|---|
| | informacionin e nevojshëm (tipologjia e lëndës, ngarkesa javore, orët në auditor/jashtë auditorit, kreditet, mënyra e shlyerjes së detyrimeve, masa e frekuentimit, mënyra e vlerësimit[135]. Programi i studimit, ka veprimtari formuese, që ngarkohen me kredite sipas Sistemit Europian te Transferimit te K.rediteve (ECTS). Rol ka pedagogu që ju shpjegon studentëve përqindjen e pikëve të veprimtarive formuese. Veprimtaritë formuese në këtë program klasifikohen në veprimtari formuese të tipologjive të ndryshme , të ndara me përqindje. Ndarja e oreve mësimore në auditor sipas elementeve të studimit per cdo disiplinë, përcaktohet nga pedagogu përgjegjes/titullar i lëndes. Mësimi në auditor përfshin leksionet, seminaret, seancat laboratorike, si dhe format e kontrollit të vazhdueshëm. Ngarkesa jashtë auditorit përfshin përgatitjen për provime, detyrave të kursit, si dhe pergatitjen e tezes së diplomes.[136] Ngarkesa mësimore e programit të studimit Master SHTU është 1260 ore, ku 960 janë në auditor dhe realizohen në 3 semestra; 300 orë i dedikohen praktikës profesionale dhe temës së diplomës [137].Për studimin individual janë përcaktuar 1740 orë. **Në planin mësimor të këtij programi nuk janë përcaktuar orë për kryerjen e praktikës profesionale dhe nuk janë përcaktuar kredite si dhe vleresimi me note për praktikën profesionale . Kjo përbën një mangësi, mbasi këto orë të shpenzuara nga studenti nuk mund të jenë të transferueshme në një program tjetër të ngjashëm brenda apo jashtë vendit .** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Pranimi i studenteve në Programin e studimit Master i Shkencave në "SHTU", bëhet mbi bazën e përcaktimeve në Statutin e UT dhe në kriteret e parashikuara në Rregulloren e UT,[138] si dhe në kriteret e kuotat e propozuara nga DKI. Procesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidateve kryhet nga DKI, FSHN, Rektorati i UT dhe Qëndra e Shërbimeve Arsimore (QSHA). DKI propozon kuotat dhe kriteret e pranimit, [139],[140] dhe të përzgjedhjes së fituesve, brenda vitit paraardhës akademik. Kriteret dhe procedurat e transferimit janë përcaktuar në Nenin 79 dhe 80 te Rregullores së UT dhe nenin I09 |

135 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 46, pika 3

136 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 50 pika 2

137 Evidenca I.16 Tabelat permbledhese ANEKS RVB ASCAL, Ngarkesa totale ne auditor e studenteve (Tabela 13)

138 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Nenet 38 pika 4 dhe Neni 39 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

139 Evidenca II.31 Procedura per percaktimin e kuotave ne Programin e studimit Master i Shkencave SHTU

140 Evidenca I.34 Kriteret e pranimit studenteve viti akademik 2023-2024 https://api.fshn.edu.al/uploads/Viti akademik 2023 2024 5d49b89b4d.pdf

| | |
|---|---|
| | te Statutit të UT, ku sanksionohet njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve nga programe të tjera.<br>Komisioni ad hoc I DKI shqyrton kërkesat, sipas përcaktimeve në Rregulloren e UT[141] dhe ben njohjen e krediteve për disiplinat mësimore të përmbyllura.[142] |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet e disiplinave formuese të MSH në "ShTU" Programet e lëndeve perputhen me objektivat formuese te te nxenit. Për mësimdhenie përdoren të gjithë elementet mësimore.Në silabuset e lëndëve gjejmë formën e vleresimit dhe detyrimet e studentit. Programi i lëndes është konform VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 ndryshuar me VKM Nr. 879, date I8.12.2019[143] si dhe Rregullores së FSHN, nenet 48 dhe 49..<br>• Syllabuset hartohen nga titullari i lëndes apo titullarët e veprimtarisë formuese, sipas kritereve të caktuara në VKM nr 879, dt 18.12.<br>• Programet lëndore/syllabuset perfshijne të gjithë elementet që paraqet modeli në VKM 41/2018.<br>• Studenti ka në zotërim literaturë në formë tekstesh, leksionesh hard copy ose elektronike.[144] Departamentit mban në kontroll zbatimin korrekt të programeve mësimore në disiplinat formuese në drejtim të mesimdhenies, respektimit të orarit [145].<br>Përgjegjesi i Departamentit drejton punën për rishikimin e planeve mësimore dhe ndjek zbatimin e tyre[146]. |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Rishikimi i planit mësimor, syllabuseve dhe lëndeve realizohet sipas Rregullores së UT. Ndryshimet i propozohen Dekanatit nga grupet mesimore kërkimore nëpermjet DKI, deri në miratimin perfundimtar nga Senati Akademik i UT-se, kur masa e ndryshimit të kerkuar nuk e kalon 20%[147]. Ndryshimi propozohet me qëllim që programi ti përshtatet zhvillimeve të reja në fushen e njohurive, kërkesave të studenteve, krijimit të mundësive për praktike ose shtimit te lendëve të reja (propozimet per ndryshime bëhen nga grup |

141 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Nenet 79 dhe 80 https://unitir.elu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore e-universitetit-te-tiranes.pdf

142 Evideoca I.31 Procedure transferimi

143 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Nenet 48 & 49 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e universitetit-te-tiranes.pdf

144 Evidenca II.12 Lista e titujve te literatures baze per lendet e programit Master i Shkencave SHTU

145 Evidenca II.14 Orari i mesimit te programit Master i Shkencave SHTU

146 Evidenca II.14 Orari i mesimit te programit Master i Shkencave SHTU

147 Evidenca II.20 Vendim Nr. 29 i Senatit Akademik date 21.10.2020 "Per miratimin e ndryshimeve deri ne masen 20% te planeve mesimore te ciklit te pare dhe te dyte te studimeve ne Fakultetin e Shkencave te Natyres, te UT-se per vitin akademik 2020-2021

| | |
|---|---|
| | lëndet përkatese në DKI dhe përcillen në Dekanat në periudhën Mars Prill). |
| **Konkluzione** | *GVJ shpreh opinionin që programi i studimit MSH në SHTU është i formatuar mirë, është informues, ka një strukturë dhe organizim në përputhje me VKM përkatëse në mbështetje të objektivave formuese të programit të ciklit të dytë, por ka si mangësi mospërfshirjen e praktikës profesionale si veprimtari formuese më vete me ore dhe kredite.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve ju ofron studentëve njohuri specifike në fushën e ushqimit për të përmbushur objektivat e pritshme për t'u perballur me dinjitet në tregun e punës. Në planet mësimore të MSH ne SHTU ka lënde karakterizuese ku mundësohet formimi profesional si: teknolog inxhinier kimist, specialist i ushqimit. Por në kurrikul përfshihen edhe lëndë me njohuri integruese, plotësuese. Në kuadër të akreditimit institucional,[148] UT ka realizuar studimin e tregut të punës . Në nivel të programit është realizuar pyetesori mbi punësimin e studentëve për vite të ndryshme akademike.[149] . Nga pyetsorët rezulton se [150]se studentët që ndjekin ose kanë përfunduar studimet e programit MSH në SHTU në masën 63% janë edhe të punësuar, 15% janë në pritje të punësimit dhe pjesa tjeter ndjek mesimin. Po ashtu rezulton që 41% e të anketuarve janë punësuar me kohë të plotë, dhe pjesa me e madhe e tyre, ku 60% e tyre punojnë në sektorin privat. Pyetsori na duket shumë informativ dhe jep një informacion shumë të vlefshëm për impaktin e programit të studimit në tregun e punës. |

148 Evidenca I.11 Akreditimi periodik insitucional i Universitetit teTiranes

149 Evidenca L14 Modeli i pyetesorit per studimin e tregut te punes

150 Evidenca L15 Raporti i studimit te tregut te punes per programin Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Programi i studimit te MSH ne SHTU zhvillohet në 4 semestra, me 120 kredite. Në kurrikul ka 17 disiplina formuese, nga të cilat njëra është punimi dhe Mbrojtja e Diplomës. Disiplinat kanë këtë strukturë:13 te detyrueshme dhe 3 me zgjedhje. Nga grupi prej 6 lëndësh , studentët zgjedhin 3 lëndë (13 kredite)[151]. Në fund studimet permbyllen me mbrojtjen e diplomes' e cila ka 30 kredite. Njohurite që marrin studentët mundësojnë realizimin e objektivave formuese të programit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit profesional. Në planin mësimor ka një ndarje mirë të identifikuar të orëve në auditor për leksionet, seminaret dhe orët laboratorike[152]. Në programin mësimor ka lëndë javore që zhvillohen në raportin L/P 1/1[153]. Cdo vit, drejtuesi i DKI harton një raport për ecurine c programit të studimit[154], që është pjesë e analizës së procesit mësimor vjetor. **Ritheksojme që në planin mësmor të vitit të dytë nuk janë identifikuar praktika profesionale me orë dhe kreditet përkatëse. Ka një planifikim prej 300 orësh së bashku me punimin e diplomës.** |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Programi i studimit Master i Shkencave "SHTU", mbështetet në sistemin Evropian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS). Ka ngjashmëri me programe të tjera të ngjashme nderkombetare.[155.] Në raport programi gjen ngjashmëri me Food Science and Technology në Universitetin e Bolonjës, me kod 6788 në gjuhën italiane. Scienze e Tecnologie Alimentari që jep diplomë sipas kuadrit të kualifikimit Italian **LM** 70 R, ku ngjashmeria e kurrikulës me programin e SHTU ne FSHN në UT është rreth 60% referuar krediteve të lëndeve përkatese.. Programi është i organizuar në mënyrë të harmonizuar në të gjithë komponentët lidhur me shpëmdarjen e krediteve në aktivitetet formuese, sigurimin e cilësisë sipas udhëzimeve të ASCAL dhe udhëzimeve evropiane. Referuar lëndeve që përfshijnë leksione, seminare dhe laboratore konstatohet që në silabuset raporti i oreve leksion/laborator është 1: 1. Konstatohet që shumica e disiplinave që i takojnë kategorisë B kanë një raport L/P përafërsisht 1/1. Po kështu ka një shpërndarje uniforme të |

151 Evidenca I.16 Tabela permbledhese per Aneks RVB, Tabela 9-Plani mesimor i ndare sipas Veprimtarive Formuese (A-E)

152 Evidenca I.9 Plani Mesimor i Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

153 Evidenca I.10 Programet e Lendeve te Programit Master SHTU (Syllabuset) shembull: Koncepte te avancuara ne Kimi e Teknologji Ushqimore dhe Inxhinieria e Proceseve Biokimike

154 Evidenca I.42 Raporte vjetore te FSHN 2021/2022 fq. 26 Monitorimi dhe vleresimi periodik i mesimdhenies

155 https://corsi.unibo.it/cycle/Food ScienceTechnology

| | |
|---|---|
| | shpërndarjes së krediteve konform ngarkesës në orë që kanë disiplinat . |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Disiplinat formuese në programin MSH ne SHTU janë organizuar në perputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemit Europian te Grumbullimit dhe Transferimit te Krediteve (ECTS)[156],[157]. Kjo bën të mundur mobilitetin e studimeve brenda dhe jashtë vendit . Veprimtaritë formuese të këtij programi janë në përputhje me specifikimet e VKM nr 41 pika 2.4:a, b. Në program elementët e mësimit në auditor si: leksione, seminare, ushtrime, orë laboratorike, janë në funksion të përfitimit të diplomes. Programi ka 960 orë ne auditor nga të cilat: 517,5 orë leksione; 277,5 orë seminare dhe 165 orë seanca laboratorike.Konstatohet një peshë më e lartë tek leksionet ( 517,5 orë ) se sa tek seminaret dhe laboratoret me 442,5 orë. Totali i orëve që mbart ky program eshte 1260 orë qe ngarkohen me 120 kredite.[158] Studimi individual, si: studim, pergatitje relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, dhe për pergatitjen e diplomës; jane më shumë se gjysma e sasisë së pergjithshme të orëve mësimore vjetore. (120 x 25 =3000 ore). Orët e studimit individual llogariten 1740orë. Laboratoret kanë një infrastrukturë të mirë që mundëson zhvillimin cilësor të seancave laboratorike.[159]. Normalisht grupet mësimore për zhvillimin e laboratorëve janë me 15 studentë. Kjo strukturë e shpërndarjes së orëve është e ngjashme me atë të Programit analog të ofruar në UBT. Kjo mundëson transferimin e krediteve. |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Syllabuset e lendëve që realizohen në programin Master i Shkencave në SHTU përditësohen[160] vazhdimisht në lidhje me futjen e leksioneve të reja dhe literaturën përkatëse. Literatura e përdorur ndahet në literaturë bazë dhe te rekomanduar. Literatura pasqyrohet në programin e lëndeve, e detajuar sipas kapitujve. Tekstet bazë të botuara nga personeli akademik janë në mbështetje të programit mesimor, dhe sigurojnë transmetimin e njohurive bashkëkohore. Në programin Master i Shkencave SHTU, një pjesëë e lëndëve mbulohen me tekste mesimore bazë në shqip. Disa lënde ofrohen si leksione të shkruara dhe ppt për të dhenë njohuri |

156 Ligji Nr.80/2015 "Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencor ne Institucionet e Arsimit te Larte ne Republiken e Shqiperise", Neni 75, Pika 3; Neni 76 Pika 1,3, 4 fq.51 https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/A KTET NENLIGJORE.pdf

157 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes, Neni 92 Pika 2, Neni 94 https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 5916d9f405.pdf

158 Evidenca I.16 Tabelat permbledhese ANEKS RVB ASCAL Tabela 13; Ngarkesa totale ne auditor e studenteve per Format e mesimdhenies ne programin SHTU

159 Evidenca III..10 Inventaret e laboratorit te Teknologjise Ushqimore dhe lista e aparaturave

160 Evidenca II.15 Komunikim per dorezimin e planeve mesimore/syllabus drejtuar titullarve te grupeve

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | bashkëkohore[161]. Në mbeshtetje të literatures bazë ofrohen leksionet e përditsuara ose tekste nga internet. | | | |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Programi Master i Shkencave në "SHTU", garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave duke zhvilluar dhe përmiresuar permbajtjen e tij. Objektivat, njohuritë dhe aftesitë me të cilat pajiset studenti gjenden në faqen ëeb te DKI[162]. Ky program mundëson aftësi për veprimtari kërkimore të pavarur hulumtime shkencore si dhe I edukon studentët të shfrytezojne literaturën shkencore të fushes. Studentet përgatiten profesionalisht, për tiu përgjigjur nivelit bashkëkohor në lidhje me prodhimin dhe vleresimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore. | | | |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Programi MSH në SHTU përmes kurrikulës së vet I ofron studentëve që përfundojnë studimet informacion dhe njohuri lidhur me shkencat e ushqimit, të domosdoshme për të përballuar tregun e punës që lidhet me këtë sektor të ekonomisë. Dijet e përfituara nga programi I japin aftësi profesionistëve të ardhshëm të garantojnë cilësi dhe siguri ushqimore sipas standartëve kombëtare dhe atyre të BE.. Studentët që kanë përfunduar këtë nivel studimi rezulton që janë të punësuar në masën 65%. Ata kanë të gjithë të drejtën të vijojnë me ciklin e tretë në doktoraturë. Kjo gjë sanksionohet edhe në pyetsorin e përgatitur nga DKI[163], ku aplikuesit e konfirmojnë këtë orientim. | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ gjykon se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

161 Evidenca II.12 Lista e titujve te literatures baze per lendet e programit Master i Shkencave SHTU

162 https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-kimise-industriale/programet/shkencat-dhe-teknologjise-ushqimore-ms

163 Evidenca I.14 Modeli i pyetesorit per studimin e tregut te punes

| Standardi II.5<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | DKI për hartimin e këtij programi ka kryer një proces konsultimi me tregun e punës, duke përfshirë institucione partnere, studente të diplomuar, si dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës. Konkretisht DKI është konsultuar me universitete, qëndra kërkimore, laboratorë kërkimorë, të cilët japin një kontribut të vyer në vend. FSH/DKI ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi më universitete si psh Universitetet e Greqisë: të Patras, Janinëss, Thesalisë, Univ. Hohenheim Gjermani për ciklin e tretë të studimeve, Universitetin Saarland, Universitetin e Mitrovices-Kosove. Studentët e diplomuar kanë dhëne një feedback të vlefshem për programin e studimit duke kërkuar përmirësime apo duke bërë sygjerime te dobishme për karrieren e tyre. Pyetsori i shpërndarë për "Vlerësimin e studenteve që diplomohen" nxorri në pah vlerësime të nevojshme mbi cilësinë e programeve të studimit. Raportii DSBCK/, për programin e studimit MSH në SHTU na njeh me reagimin e të anketuarve që arrin në 85% deri 90% në kategoritë "shkëlqyeshëm dhe shumë mire ". Në procesin e konsultimit për programin e studimit janë përfshirë aktorë nga tregu i punës si punëdhenës, përfaqesues të industrive, agjenci rekrutimi, përfaqësues të shoqatave profesionale. Ata ofrojne informacion për trendet e tregut dhe aftesitë specifike që kërkohen nga punëdhënësit. Ky bashkëpunim ndihmon në mundësite për praktikë profesionale për studentet. Po ashtu bashkëpunimi ka ndihmuar në realizimin e projekteve reale për të mësuar nga praktikat dhe teknologjitë që perdor industria ushqimore. Në citimet bibliografike nuk rezulton ndonjë dokumentacion konkret që sanksionon reagimin e biznesit karshi cilësisë së programit të studimit FSHN/DKI ka organizuar Panairet e Karrierës për të ndihmuar studentët në një qasje më të mirë me tregun ee punes, si dhc mundësi punësimi dhe internshipi. Këto panaire shërbejnë edhe për krijim të marreveshjeve të bashkëpunimit. Departamenti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani që ushtrojnë aktivitete brenda fushës së programit studimit SHTU si:: Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti", Lufra, AK.U, Birra Tirana, Birra $TELA, Kompania AMITA Dt 28.07.2022 marrevesbja; K.Jegen SH.P.K Shkoder-Dt 03.08.2021; Kompania ELKA S.A Gjirokaster etj Permirësimit të MSH në |

| | |
|---|---|
| | SHTU i kanë shërbyer edhe kontributet nga projektet e ndryshme si : NUTRICION. ERASMUS+; Projekti "Studime me karakter aplikativ në industrinë kimike dhe ushqimore përmes implementimit efikas të koncepteve inxhinierike e bioinxhinierike", financuar nga UT; ICA –Janinë; Shkolla verore "PISU" ne Kosove. |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | DKI mbështet dhe inkurajon dialogun e hapur dhe diskutimet c vazhdueshme mes studenteve, stafit akademik dhe administratës, përnes takimeve te rregullta, seminareve, dhe forumeve, ku studentet shprehin mendimet e tyre për përmbajtjen e programeve të studimit dhe metodologjinë e mësimdhënies. Konsultimi dhe bashkëpunimi me studentët e diplomuar vlerësohet si shumë i rëndësishëm. DKI mban kontakte të rregullta me studentet e diplomuar, për t'u siguruar që ata të mund të ndihmojne me sygjerime për përmbajtjen e programit të studimit, përgatitjes për tregun, e punës dhe nevojat e industrisë [164]. Integrimi i mendimeve të studenteve dhe alumni[165] ndihmon në përmiresimin e cilesisë dhe përshtatjen e metodologjive të mësimdhënies. Studentet alumni ndihen më të vlerësuar kur perfshihen në procesin e përmiresimit të programeve. Kjo eksperiencë e Dep e dokumentuar është me interes për një reflektim cilësor të përmirësimit të programeve. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | DKI bën përpjekje të vazhdueshme për përditësuar programet e studimit në përputhje me zhvillimet e fundit të industrisë dhe arritjeve shkencore në fushat perkatese. Në cdo fillim viti akademik rishikohen dhe dorëzohen syllabuset e lëndeve të përditësuara[166]. Përshtatja e programeve synohet të bëhet në përputhje me kërkesat dhe inovacionet që dalin në fusha të ndryshme si: avancimi i sistemeve teknologjike në prodhimin e ushqimeve, metodat e reja të prodhimit/ ruajtjes së produkteve ushqimore, teknologjitë molekulare të aplikuara në industrinë ushqimore, llojet dhe format e reja të paketimit, disinfektimit etj. DKI angazhohet në krijimin e lidhjeve me rjete profesionistësh dhe shoqata profosionale të Kimisteve, Inxhiniereve, Shoqatat e Bioteknologëve dhe Urdhrin e Mjekëve. DKI bashkëpunon me institucione publike dhe private, laboratorët, kompanitë prodhuese dhe institucione të shëndetit public.[167] Bashkepunimi ndihmon në shkembimin e eksperiencave |

164 Evidenca V.44 Histori suksesi e studentëve të Dep. Kimi Industriale 18.05.2022.pdf.

165 Evidenca V.41 Takim me Kompanine Lufra dhe Alumni me DKI ne 0 1.02.2023

166 Evidenca V.15 Komunikim per dorezimin e planeve mesimore/syllabus drejtuar titullarve te gruplendeve

167 Evidenca I.16 Tabelat permbledhese ANEKS RVB ASCAL Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat bashkepunuese, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punes dhe aktore te tjere shoqerore te rendesishem per arsimin e larte

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | midis botës akademike dhe asaj të profcsionisteve. Ky proces bashkëpunimi lehtëson edhe karierën e studentëve . | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ mendon se DKI ka punuar me objektiva dhe qellime të qarta duke nxitur përfshirjen e studentëve, te diplomuarve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Ky angazhim I DKI sanksionohet nga dokumentacioni shoqerues* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Programi i studimit MSH në SHTU është në përputhje me objektivat madhore të UT. UT fokusohet në ofrimin e një arsimi të cilësisë së lartë dhe në zhvillimin e një mjedisi kërkimor që kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. FSHN ka qëllim të ofrojë arsimin dhe kërkim shkencor në fushat e shkencës natyrore dhe teknologjisë, duke nxitur inovacionin. Programi i studimit MSH në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", synon të zhvillojë një kuadër edukativ dhe profesional në përmbushje të nevojave të industrisë dhe kërkcsat e shoqërisë për zhvillim të qëndrueshem dhe teknologji inovative në fushën e ushqimit. Ky program ofron formimin e profesionistëve të kualifikuar dhe të aftë për zhvillimin e industrive ushqimore me teknologji të avancuara si dhe për kërkime shkencore në fushat e shkencës së ushqimit. Objektivat e Programit Master i Shkencave në SHTU janë si më poshtë:<br><br>1. Formimi i eksperteve të Industrisë ushqimore dhe Cilesisë dhe Sigurisë Ushqimore , përmes paisjes së studentëve me njohuri dhe aftësi teknike per të optimizuar procese kimike në industritë ushqimore, lendeve te para bimore apo shtazore, por edhe të industrive të tjera .Ndihmon në paisjen e studentëve me metodologji analitike për të vlerësuar cilësinë dhe sigurinë ushqimore<br>2. Kërkim Shkencorc dhe Inovacion: Të përfshijë dhe mbështesë studentet për të marr pjesë në kërkime shkencore, |

| | |
|---|---|
| | të cilat mund të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve të industrisë ushqimore dhe të shoqerisë . Një pjesë e temave janë eksperimentale dhe fokusohen drejt cilesisë dhe sigurisë ushqimore. DKI promovon ndjekjen e kërkimeve inovative që lidhen me fushën e konservuesve natyrale (përdorimi i mikroorganizmave, metaboliteve të tyre, enzimave); inhibimin e mikroorganizmave ose rritjen e jetëgjatesise së produkteve ushqimore, në ndihmë të sigurisë ushqirnore.<br>3. Pergatitja e studenteve me aftësi drejtuese dhe menaxheriale: Programi ndihmon në aftësimin e studentëve edhe për nxitjen e aftësive drejtuese dhe menaxhuese, të nevojshme për të drejtuar ekipe të inxhiniereve dhe teknologëve.<br>4. Përputhshmëria me kërkesat ndërkombëtare: Programi MSH në SHTU ofron njohuri dhe praktika laboratorike qe janë konform standardeve ndërkombetare dhe kërkesave globale në fushën e analizave të ushqimeve mbi cilesinë dhe sigurinë ushqimore, bioinxhinierinë e proceseve kimike, duke i mundësuar studentëve që të integrohen në tregun ndërkombetar të punës |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | FSHN/DKI nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhenies, të punës kërkimore, por duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. Në fillim të cdo viti akademik DKI, bazuar në burimet njerezore të brendshune dhe të jashtme të tij, harton planin mesimor[168] i cili miratohet nga Senati Akademik. Personeli akademik i DKI është i ngarkuar për të kryer disa veprimtari si mësimdhënia, kërkimi shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UT, këshillim për studentë, etj. [169], [170], [171] DKI rekruton staf akademik cilësor si dhe garanton kualifikimin e mëtejshëm te të rinjve DKI nxit dhe bashkërendon veprimtaritë akademike dhe siguron koordinimin e tyre, duke ofruar edhe mbështetje financiare për realizimin e botimeve, trajnimeve dhe seminareve që lidhen me programin e studimit. FSHN është i angazhuar për mbrojtjen dhe respektimin e lirive akademikc të stafit, duke siguruar që stafi efektiv I brendshëm të zhvillojë mendimin kritik dhe krijimin e një mjedisi të hapur për mësim dhe kërkim shkencor. FSHN kujdeset për dhënien e burimeve dhe financave për kerkime të ndryshme, organizimin e grupeve kërkimore dhe jep mbeshtetje për punime shkencore që |

168 Evidence IL15 Komunikim per dorezimin e planeve mesimore/syllabus drejtuar titullarve te gruplendeve
169 Evidenca II.7 Ngarkesa mesimore e PAE te Departamentit KI sipas viteve
170 Evidenca II.27 Raporti vjetor FSHN 2021-2022, fq. 115-122 Produktet e kerkimit Shkencore
171 Evidenca I.35 Kujdestaret akademik te studenteve te programit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore·

| | |
|---|---|
| | kontribuojnë në avancimin e fushës përkatese. Zv/dekani përgjegjes për kërkimin informon stafin për hapjen e aplikimeve të projekteve kombëtare për aplikimin për mobilitete të stafit në kuader të Programit Erasmus etj. [172],[173] |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | FSHN dhe DKI koordinon zhvillimin e aktiviteteve që ndihmojnë në thellimin dhe zgjerimin e fushave të studimit. Ky proces përfshin ofrimin e mundësive që studentët të marrin pjesë në studime apo projekte konkrete. Programi i studimit në SHTU, motivon angazhimin e studenteve në aktivitete kërkimore dhe projekte, si brenda ashtu dhe jashtë institucionit përmes bashkepunimit me industrinë apo duke marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare. Angazhimi në projekte kërkimore akademike nxit zhvillimin e aftësive praktike, duke i pergatitur ata per karriera te suksesshme dhe në kërkimin shkencor. Motivimi konsiston në:<br>I. **Projekte kërkimore të brendshme** që inkurajonë studentët të angazhohen – në punë kërkimore që zhvillohen brenda laboratoreve të FSHN, si dhe në bashkëpunim me institucione të tjera akademike. Gjithashtu ky program krijon mundësite per te kontribuar në vlerësimin e sigurisë ushqimore në lidhje me evidentimin e ndotësve toksike, kimike në ushqime. Në mënyrë të vecantë kanë prioritet diplomat eksperimentale, prane DKI.[174]<br>II. **Pjesemarrja në projekte industriale dhe** bashkëpunime me sektorin privat është I rëndësishëm. Në mënyrë të vecantë ka rëndësi bashkepunimi me kompani të industrise ushqimore. Kjo marrëdhënie forcohet në kohën kur kryhen praktikat profesionale si dhe gjatë realizimit të temave te diplomave.<br>III. **Aktivitete dhe konferenca shkencore.** Studentet inkurajohen në seminare dhe konferenca shkencore[175]. Aktivitete të tilla ndihmojnë që të zhvillohen aftesitë komunikative.<br>IV. **Bursat dhe mundësitë e financimit për kerkime.** UT ofron mundësi financimi dhe bursa për studentet që dëshirojnë të zhvillojne projekte kërkimore të pavarura ose edhe në projekte të mëdha shkencore. **Kjo iniciative serioze e UT duhet të dokumentohet**<br>V. **Mobiliteti dhe mundesitë e studimit jashtë vendit**. DKI nxit mobilitetin [176]akademik dhe ofron mundësi që ata të studiojnë |

172 Evidenca II.23 Njoftime me email - Fwd mbi Njoftim per thirrje ERASMUS+

173 Evidenca II.24 Njoftime me email - Fwd, Mbi bursat e landit te Bavarise

174 Evidenca II.16 Skedari i temave te diplomave te mbrojtura ne programin Master i Shkencave SHTU ne vitet 2022, 2023, 2024

175 Evidenca V.5 Vendimi SA Nr.40 date 09.10.2023 "Per zhvillimin e konferences shkencore studentore nderkombetare-UT

176 https://fshn.edu.al/info/bursa-erasmus

| | |
|---|---|
| | apo marin pjesë në aktivitete kerkimore në institucione të tjera jashtë Shqiperise. |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | Ne aktivitetin e saj akademik dhe shkencor DKI mbështetet financiarisht nga UT dhe FSHN. Burimet dhe mënyrat e mbështetjes financiare janë:<br>I. **Financimi nga (UT).** Buxheti i brendshëm siguron fonde për zhvillimin e aktiviteteve kërkimore dhe shkencore, duke mundësuar përfundimin c projekteve të kërkimit, mbështetje për materialet dhe pajisjet laboratorike[177], si dhe mbështetje për organizirnin e aktivitcteve akademike dhe shkcncore si konferenca dhc seminare.<br>II. **Mbeshtetje nga FSHN.** Fakulteti ofron mundësi financimi për kërkime drejt aplikimeve praktike dhe industriale, duke u përqendrnar në mbështetje për zhvillimin e programeve kërkimore[178] dhe të studimeve të avancuara në industrinë ushqirnore.<br>III. **DKI administron të ardhura** nga aktivitete të ndryshme, grante kërkimore nga institucione të tjera akademike, ose bashkëpunime me industrinë për zhvillimin e projekteve aplikative dhe kërkime të lidhura me nevojat e tregut dhe industrisë. **Mungon dokumentacioni shoqërues**<br>IV. **Trajnime dhe kurse të specializuara**, të cilat mund të mbështeten financiarisht nga pjesëmarrcsit dhe kontribuojnë në zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike të studentëve[179] dhe profesionisteve.<br>V. **Bursa dhe financim për studentet.** DKI ofron bursa dhe mbështetje financiare për të ndihmuar në zhvillimin e punimeve të kërkimeve të tyre[180], si dhe për pjesemarje në konferenca dhe seminare shkencore. |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson që ky Program studimi garanton një orientim të dëshirueshëm në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor për industrinë ushqimore por jo vetëm .Mbështetur në objektiva të qarta, DKI shfrytëzon të gjitha mundësitë e financimit për të mbështetur stafin akademik por edhe studentët në aftësimin e tyre akademik dhe shkencor* |

177 Evidenca I.40 Njoftim per ngritjen e grupit per pergatitjen e buxhetit

178 Evidenca III.1 Udhezues per Programin "UT-Kerkim, Ekselence dhe Inovacion"

179 Evidenca V.43 Trajnim me fokus studentet "Keshillim karriere" nga Qendra e zhvillimit profesional UT 13.12.2023

180 https/fshn.edu.al/notification/ventures-thrive-ca1 1-open-for-start-ups-in-widening-countries

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | Vlerësimi i ekspertëve |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | DKI mbështet iniciativat për projektet e reja kërkimore- shkencore, duke siguruar burime dhe mundësi për zhvillimin e tyre. Këtu përfshihen financimet për pajisjeve kërkimore[181], dhe mjedise laboratorike që janë të rëndesishme për kurrikulat e programit të studimit. Projektet që fitohen nga stafi PAE përputhen me objektivat e programit të studimit, dhe kërkimet dhe mbështesin zhvillimin e njohurive për diplomimin dhe avancimin e studenteve. DKI promovon bashkëpunimin me strukturat kërkimore brenda dhe jashte FSHN ose UT [182] ku shkëmbehen edhe eksperienca. (psh bashkëpunimi me Albanian University në projektin e financuar nga AKKSH, "Vlerësimi i ekspozimit të ndotjes së ajrit ne shkollat 9 vjecare " FSHN ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione vendase dhe te huaja në fushën e kërkimit shkencor, të cilat kanë forcuar cilesinë e shërbimeve dhe produkteve shkencore të stafit akademik. Bashkëpunimi mundëson që projektet kerkimore të kenë impact të gjere dhe ofrojnë mundësi financimi, dhe mundësi për shkëmbime ndërkombetare, për të ndërmarrë projekte kërkimore në përputhje me standardet globale. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | DKI ka një rol kyc në angazhimin dhe mbështetje ndaj kërkesave për analiza, studime dbe projekte me karakter kërkimor shkencor. Procesi i angazhimit në projekte kërkimore siguron mundësi për bashkëpunim ndër-institucional dhe shkëmbim përvoje me universitete dhe institucione kërkimore të tjera, duke mundësuar rritjen e mjeteve të kërkimit dhe në realizimin e projekteve të përbashketa. Ky proces krijon mundësi për pjcsemarrje në projekte ndërkombetare si dhe për përgatitjen e stafit dhe studenteve për karrierë në kërkimin shkencor dhe industri. Personeli akademik PAE është i angazhuar si koordinator në projekte kërkimore, ose duke ofruar ekspertizë, konsulencë dhe drejtim shkencor. Studentet gjithashtu mund te angazhohen nga stafi, duke përfituar mundësi |

181 Evidenca I.40 Njoftim per ngritjen e grupit per pergatitjen e buxhetit

182 Evidenca II.27 Raporti vjetor FSHN 2021-2022, fq. 37 & 52 Projekte shkencore

| | |
|---|---|
| | për më shumë aftësi praktike dhe kërkimore. Ata realizojnë analiza dhe hulumtime mbi kërkimet shkencore..<br>Në shumicën e lëndëve të programit MSH SHTU perfshihen detyra kursi individuale dhe/ose projekteve në grup për cështje të caktuara. Keto punime prezantohen dhe diskutohen në prani të gjithë studenteve të kursit duke krijuar mundësi që të gjithë të mrrin informacion të ri. DKI ofron trajnime që organizon UT dhe kurse të avancuara, që ndihmojnë në përmiresimin e aftësive kërkimore dhe shkencore. |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | Aktivitetet shkencore kanë qëllim prezantimin e kërkimeve dhe studimeve me bashkëkohore me pjesmarrje nga stafi akademik, eksperte të huaj. Në vitin akademik 2023-2024 stafi I DKI është angazhuar në 20 konferenca ndërkombëtare dhe kombëtare dhe ka publikuar 35 artikuj shkencorë[183,184]. Pervec konferencave, DKI në bashkëpunim me UT dhe gruplëndet e fakulteteve të tjera, organizojnë aktivitete (kurse trajnimi, workshope dhe seminare).[185] Këto aktivitete mbulojnë fusha të ndryshme si: metodat kërkimore, teknologjitë e reja, ndërveprimi me industrinë dbe zhvillimin e aftësive për udhëheqje/lider dhe menaxhim të projektcve kërkimore,. Departamenti përmes zyrave përkatëse në nivel Rektorati lehteson shkëmbimin e eksperiencave ndërkombëtare[186], duke pasur mundësi organizimin e takimeve ose seminareve në bashkëpunim me universitete dhe institucione kërkimore nderkombetare. Këto aktivitete ofrojnë mundesi bashkëpunimi me kolegët e huaj [187]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | Programi i studimit Master i Shkencave SHTU është hartuar për të formuar profesionistë të përgatitur për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Përmes këtij programi mundësohet zhvillimi i aftesive dhe njohurive të nevojshme për t'u integruar dhe për të kontribuar në industrinë ushqimore dhe fushat profesionale të tyre. Hartimi dhe realizimi i programit është udhëhequr nga nevojat e biznesit dhe industrisë ushqimore, për t'iu përgjigjur përfitueseve (tregut te punes).[188] Rritja e vazhdueshme e ndërmarjeve industriale, atyre ushqimore si dhe linjave të agropërpunirnit, ngritja e laboratoreve të kontrollit në rajone të ndryshme të vendit, rjeti i |

183 Evidenca I.50. Leksion i hapur i zhvilluar ne Departamentin e Kimise Industriale, i ftuar Prof.Asoc. Octavian Barna

184 Evidenca II.26 Aktiviteti shkencor i stafit te Departamentit Kimi Industriale ne vitet 2021-2024

185 https://fshn.edu.al/notifications/gcm-silkway-summer-school-tirana-2024

186 Evidenca I.53 Mobilitet stafi hyres Octavian Barna

187 Evidenca I.52 Mobilitet stafi dales Jonida Canaj, Aferdita Shtembari

188 Evidenca II.27 Raporti vjetor FSHN 2021-2022 fq 13, 163, 164

| | |
|---|---|
| | shërbimit catering tregon nevojën e tregut të punës për specialist në të gjitha drejtimet. Programi ofron kurrikul duke integruar teorine dhe praktikën në fushën e shkencave të[189] ushqimit. Programi i studimit siguron angazhim në aktivitete praktike që ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi të aplikuara në realitetin profesional, mundësi për internshipe, pune në projekte kërkimore ose bashkëpunime me industrinë dhe organizata të tjera profesionale. Gjatë studimeve, studentet zhvillojnë dhe forcojnë rrjetet profesionale, përmes shkëmbimeve me profesionistë, eksperte të fushës së ushqimit dhe pjesemarrjes në aktivitete dhe konferenca profesionale. Kjo përgatitje e bën studentin të konkurueshëm, duke zhvilluar një profil të kërkuar nga punëdhënësit dhe ka mundësi qe ata të jenë të suksesshëm në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombetar. Programi i studimit Master i Shkencave SHTU ndihmon të zhvillojë përvojë ndërkulturore, përmes mundësive për të punuar dhe studiuar jashtë vendit, si dhe përmes bashkëpunimeve me universitete dhe institucione ndërkombetare. me Universitetin Valladolit Spanje. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | Programi i studimit Master i Shkencave në SHIU jep diplome në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"; Punesim I të diplomuarve nuk kërkon marjen e licensës për të ushtruar profesionin. DKI dhe FSHN mer parasysh rekomandimet dhe kërkesat e urdhrave, shoqatave dhe rrjeteve të profesionisteve për të siguruar që programi i studimit është në përputhje me kërkesat e kompetencave sipas akteve ligjore që lidhen me ushtrimin e profesionit. |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | NA |

189 Evidenca II.25 Ekstrakt i Programit te studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ mendon qe Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, përmes përzgjedhjes së një kurrikule bashkëkohore, që buron nga ekspertiza me profesionistët më të mirë të fushës. Po kështu DKI ka punuar për ta shtrirë ndërkombëtarizimin kryesisht nga pjesmarrja në projektet Erasmus dhe realizimin e kërkimit shkencor me partnerë vendas dhe të huaj.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Mësimdhenia në MSH në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" realizohet sipas standarteve të vendosura nga UT, dhe në përputhje me standartet shteterore të cilësisë për akreditimin e programeve[190]. UT ka bërë përpjekje për të aplikuar metodat inovative dhe ka hartuar Strategjinë e mësimdhënies 2022-2027, në ndihmë të pedagogëve dhe studentëve. Një metode inovative e mësimdhenies është E-learning e cila zhvillohet me paisje elektronike[191]. Kjo metodë ka ndihmuar stafin akadamik të perdorë teknikat audiovizive, si forma të standardizuara të shperndajes së leksioneve të shkruara, ppt, dhe video me teknikat laboratorike për shumicën e lendeve[192],[193]. Një arritje e mirë për IAL ishte zhvillimi I programit të Formimit Pedagogjik-Psikologjik të Lektorëve të rinj "Bazat e Mësimdhënies në Arsimin e Lartë"në vitin akademik 2022-2023 (Kahoot, Mentimeter, etj) për ta bërë më tërheqës orën e leksionit apo |

190 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes, Neni 7. fq. 4 https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 591Cid9f405.pdf

191 Evidenca III.21 Lista e personelit akademik e pajisur me laptop dhe pajisje audio-vizive

192 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

193 Evideoca III. 10 Inventaret e laboratorit te Teknologjise Ushqimore dhe lista e aparaturave

| | |
|---|---|
| | seminarit[194]. Gjatë periudhës së Pandemisë, UT, miratoi udhëzuesin[195] për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë, me platformën Microsoft Teams[196]. të shoqeruar me Rregulloren e posatshme mbi mënyren e zhvillimit të provimeve online.[197]. Por kjo rregullore përdoret edhe për realizimin e projekteve, detyrave te kursit, në raste të vecanta.etj. Format e mësimdhenies janë leksionet, seminaret, ushtrimet, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, praktikat/vizitat në linja prodhimi të industrisë ushqimore të cilat pasqyrohen në Planin mësimor të Programit të Studimit dhe në syllabuset e lëndeve të ketij programi studimi. Përshkrimi i syllabuseve në këtë program është në bazë të modelit të VKM Nr 41'/2018. DKI fton profesore të fushës (të huaj ose të vendit) për zhvillimin e orëve të hapura në programin e studimit, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira mesimdhenese[198,199]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | UT ka zhvilluar programin e Formimit Pedagogjik-Psikologjik të Lektoreve të rinj "Bazat e Mësimdhënies në Arsimin e Lartë" ku pedagoget pjesemarrës kanë mësuar shumë rreth aplikacioneve të mesimdhenies (Kahoot, Mentimeter, etj), cituar në kriterin e mësipërm. Studentët plotësojne pyetsor duke shprehur nevojat e tyre në lidhje me mësimdhenien[200] dhe pedagogët reflektojnë në lidhje me nevojat dhe kërkesat e studenteve. Studentët shprehin opinione psh për më shumë demostrime praktike në lidhje me njohuritë që përfitojnë. Ka përpjekje nga stafi që nevoja e studentëve të realizohet në ambjentet laboratorike[201] duke patur në dispozicion paisje të ndryshme, të cilat shtohen vit pas viti . |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | DKI nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies[202], duke u bazuar në analizat vjetore të punës. Një ndihmesë është edhe vlerësimi i studentëve, drejtuesit të deparatamentit për vlerësimin e pedagogëve . Më tej rezultatet e nxjera përpunohen, dhe shihet dhe analizohet niveli i performancës në Departament dhe përgjithësohen praktikat e mira. |

194 Evidenca III.22 certiifikate ne programin e Formimit Pedagogjik-Psikologjik te Lektoreve te rinj "Bazat e Mesimdhenies ne Arsimin e Larte"

195 Evidenca III.3 Udhezues i Universitetetit te Tiranes per perdorimin e sistemit te mesimit ne distance https://fshn.edu.al/1101ifications/udhezues-i-universitetit te tiranes-per-perdorimin -e-sistemit-te-mesimit-ne-distance. https://api.fshn.edu.al/uplm1ds/Udhezues i UT per mesimin ne: distance f.!c2b8 1980.pd

196 Evidenca III.2 Udhezues bazik per perdorimin e platformes Microsofi Teams https://unitir.edu.al/manual-perdorimi-microsoft-teams/

197 Evidenca III.4 "Rregullore e posacme e UT mbi menyren e zhvillimit te provimeve online" te sezonit te dimrit te vitit akademik 2021-2022

198 Evidenca I.50 Seminar i hapur i zhvilluar ne Departamentin e Kimise Industriale, i ftuar Prof.Dr. Dhimiter Haxhimihali

199 Evidenca I.50.1 Leksion i hapur i zhvilluar ne Departamentin e Kimise Industriale, i ftuar Prof.Asoc. Octavian Barna

200 Evidenca III.6 Raporti i pyetesoreve te studenteve te Programit te Studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

201 Evidenca III.10 Inventaret e laboratorit te Teknologjise Ushqimore dhe lista e aparaturave

202 Evidenca III.35 Politika per te mesuarit, mesimdhenien dhe cilesine ne mesimdhenie ne SHTU

| | |
|---|---|
| | Me shumë interes shohim ngritjen Qendrës për Mësimdhenie dhe të Nxënit në AL(QMNAL)[203], e cila organizon trajnime për stafin akademik me qëllim ndihmën e pedagogëve për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjithashu në UT funksionon Rregullorja për "Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilesisë të UT" ku është cituar në nenin 4 pika c pikërisht vleresimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënie.[204] |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studenti mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Stafi akademik i MSH në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" përdor metoda interaktive që nxisin diskutimin tek studentët. Stafi ka eksperiencën dhe përgatitjen e duhur[205] shkencore dhe didaktike për të pasur aftësi në mësimdhënien e leksioneve, dhe puneve praktikave në laborator. Ai përdor videoprojektorë për realizimin e laboratorëve virtuale. Metodat sipas tipit të veprimtarisë mësimore janë:<br>• Leksione: shpjegimi i shoqëruar me paraqitje grafike në dërrase, videoprojektore, pyetsor dhe diskutim interaktiv..<br>• Seminare dhe diskutim interaktiv realizuar nepermjet përgatitjes dhe prezantimit të detyrave osc projckteve të kursit, individuale ose në grup, dhe diskutimit në auditor të argumentave të ndryshme për tematikat e zhvilluara në leksion.<br>Psh lënda "Mikroorganizmat industrialë dhe bioteknologjia e fermentimit" shoqërohet me seminar dhe laborator ,[206],[207],[208].<br>Personeli akademik siguron, mbështetjen dhe ndërtimin e marredhënieve të respektit të ndërsjelltë me studentët duke respektuar etikën e sjelljes, sanksionuar edhe në Statutin e UT, ku kujdestari akademik ka rol të rendësishem në mbështetjen e studentëve[209]. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe | Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë dhe Karrieres, pranë FSHN si strukturë për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, publikon në menyre periodike raportin e analizës |

203 https://qzhp.unitir.cdu.al/formimi-psiko-pedagogjik/

204 Evidenca III.5 Vendim SA Nr. 10 date 11.04.20 19 "Per miratimin e Komisionit te Perhershem per Sigurimin e Standardeve te Cilesise te UT"

205 Evidenca I.24 CV e stafit akademik efektiv (PAE) te Departamenti te Kimise Industriale

206 Evidenca I.9 Plani Mesimor i Programit te studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

207 Evidenca I.10 Programet e Lendeve te Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" (Syllabuset)

208 Evidenca III.9 Syllabus i lendes se Programit te studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" - Mikroorganizmat industrial dhe bioteknologjia e fermentimit

209 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes, neni 75.126, 127 https://fshn.edu.al/info/rregullore/1101ifications/rregullore-e-ut-perditsuar

| | |
|---|---|
| përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | së pyetesorëve per vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndet, së bashku me rekomandimet përkatese.[210] Ato përpunohen edhe nga Zevendes Dekani për mësimin dhe hartohen raportet e vlerësimeve, të cilat përdoren, për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.[211], [212]. Raporti i Analizës së Pyetesorit nga ana e DSBCK është I përvitshëm dhe bëhet publik. Rezultatet e anketimeve përpunohen nga DSBCK dhe pasqyrohen edhe në Raportin e Analizës vjetore të Departamentit dhe FSHN[213].<br>Drejtuesi i Departamentit gjithashtu kryen monitorimin e përformancës së stafit akademik dhe ndihmës/akademik dhe i propozon Dekanatit masat në rastet problematike.[214]Rezultatet e monitorimit pasi ka dëgjuar dhe mendimin e studenteve diskutohen në mbledhje departamenti [215]. |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe | UT, FSHN ka struktura që mbështesin personelin akademi në aspektin didaktik dhe ofrojnë teknologji lehtësuese të dobishme për përvetesimin e e plotë të dijeve në procesin mësimor. Keshtu në këtë program mundësohet përdorimi i metodave të shumëllojshme, fleksibile të zhvillimit të mësimit por duke marrë në konsideratë mësimnxënien dhe objektivat formuese të programit[216]. Kualifikimi në vazhdimësi i stafit të ri pedagogjik është prioritetet në FSHN. Këtij objektivi i kanë shërbyer mobilitetet e stafit akademik në kuadër të marrvëshjeve me institucione arsimore, qëndra kërkimi jashtë vendit. Këto forma ndihmojnë në mësimdhënien më cilësore, dhe rritjen e kapaciteteve akademike[217], [218] Në UT është ngritur një strukture me karakter akademik në vartësi të Rektoratit, QMNAl e cila ka |

210 Evidenca VI.9 a.l) Raport per pyetsorin "Vleresimi i studenteve qe diplomohen.. dhe a.2) Raport per pyetsorin "Raporti Studenti"', viti akademik 2021 -2022, b.I) Raport per pyetesorin "Vleresimi i studenteve qe diplomohen" dhe b.2) Raport per pyetesorin "Raporti Studentit", viti akademik 2022 -2023, c 1) Raport per pyetesorin "Vleresimi i studenteve qe diplomohen" dhe c.2) Raport per pyetesorin "Raporti Studentit"', viti akademik 2023 -2024

211 Evidenca VI.10 a) Raport Vjetor per vleresimin e cilesise se programeve te studimit ne Fakultetin e Shkencave te Natyres, viti akademik 2021-2022, b) Raport Vjetor per vleresimin e cilesise se programeve te studimit ne Fakultetin e Shkencave te Natyres, viti akademik 2022-2023, c) Raport Vjetor per vleresimin e cilesise se programeve te studimit ne Fakultetin e Shkencave te Natyres, viti akademik 2023-2024

212 Evidenca VI.8 a) Vleresimi i lendes nga studenli, semestri I, viti akademik 2021 -2022. b) Vleresimi i lendes nga studenti, semestri II, viti akademik 2021 -2022, c) Vleresimi i lendes nga studenti, semestri I, viti akademik 2022 -2023, d) Vleresimi i lendes nga studenti, semestri II, viti akademik 2022-2023

213 Evidenca I.48 Analiza Vjetore e Departamentit te Kimise Industriale

214 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 25 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

215 Evidenca III.7 Shembuj Mbledhje Departamenti KI 2021-2024

216 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 84, fq. 47 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

217 Evidenca II.26 Aktiviteti shkencor i stafit te Departamentit Kimi Industriale ne vitet 2021-2024

218 Evidenca III 28 Trajnimet "on line" per personelin akademik perperdorimin e platformes MicrosoftTeams

| | |
|---|---|
| zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | si mision trajnimet e personelit dhe dhënien e aftësive të mësimdhënies për [219]. |
| **Konkluzione** | *GVJ shpreh opinionin që Institucioni ku bën pjesë DKI garanton me seriozitet dhe impenjim procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Ka një përpjekje nga institucioni përmes DSBCK për monitorimin përvitshëm dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, duke realizuar pyetsorë , rezultati I të cilëve publikohet në raportin e analizës së FSHN per vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndet, së bashku me rekomandimet përkatese* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kontrolli i dijeve mat vlerësimin e studentit dhe përvetësimin e objektivave dhe kompetencave profesionale të studentit. Kontrolli i dijeve dhe vleresimi eshte dinamik dhe perbehet nga disa komponente. Kontrolli i dijeve realizohet me testimet me shkrim e me gojë, detyrave të kursit, relacioneve të praktikave laboratorike. Rregullorja e programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" pasqyron kriteret dhe mënyrat e kontrollit të dijeve[220], që pasqyrohet edhe në syllabuset e lendëve. Shumica e lëndeve i kane të shpërndara orët në leksione/seminare ose ushtrime/dhe laboratore. Njohurite e përfituara nga studenti kontrollohen dhe vlerësohen me pikë duke kombinuar: |

219 Evidenca III.22 Certifikate ne programin e Formimit Pedagogjik-Psikologjik te Lektoreve te rinj "Bazat e Mesimdhenies ne Arsimin e Larte"

220 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

| | |
|---|---|
| | • Frekuentimin dhe aktivizimin e studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, (seminare, ushtrime)<br>• Kontrollet me shkrim,<br>• Detyrat e kursit,<br>• Frekuentimin dhe angazhimin në seancat laboratorike.<br><br>Elementët e mësipërm kanë kontribut në përqindje të caktuar [221]. Vlerësimi vitit plotësohet me vleresimin në provimin përfundimtar. Të gjitha këto specifika janë të reflektura në Rregulloren e UT[222] si dhe në faqen zyrtare të FSHN, Rregulloren e DKI [223] si dhe në Rregulloren e Programit të Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore". Kontrolli i dijeve bëhet publike në syllabuset e lendeve[224]dhe ju bëhet e ditur studenteve në fillim të semestrit[225]. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në fillim të semestrit, studentëve ju vihet në dispozicion i gjithë informacioni i domosdoshëm për cdo lëndë. Më konkretisht studentët njihen me: emërtimin dhe kreditet e lëndës, pedagogun/pedagogët e lendës, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë në formimin terësor të studentit, (tipologjia e lëndës), ngarkesa në auditor si dhe orë mësimore individuale, njohuritë dhe aftesitë qe i jep studentit kjo lëndë. çështjet përkatëse, format dhe metodat e mësimdhenies të lëndës dhe raportet midis tyre. Studenti merr informacion mbi format e vlerësimit, (vlerësimi vjetor, me provim në fund, me shkrim apo me gojë; numrin e kontrolleve të ndërmjetme) si dhe literaturën e detyruar dhe ate të rekomanduar.[226]. Rregullorja e UT, Rregullorja e DKI , si dhe Rregullorja e MSH në "SHTU" shpalosin informacionin e nevojshem. |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të | Kontrolli I dijeve vlerësohet duke marrë në konsideratë vlerësimin e vazhduar vjetor dhe atë përfundimtar që është provimi I lëndës. Më konkretisht vlerësimi bëhet:<br>1. Frekuentimi i lëndës dhe pjesemarrja aktive vlerësohet me 5-20% të pikëve totale '<br>2. Detyra e kursit me 10%-30%, për lëndët që nuk kanë të |

221 Evidenca 1.16 Tabelat permbledhese ANEKS RVB ASCAL, Tabela I 5

222 Evidenca 1.8 Rregullore e Universitetit te Tirnnes 2022, Neni 58-62 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

223 Evidenca 1.6 Rregullore e Departamentit te Kimise Industriale, Neni 23 fq.16

224 Evidenca 1.10 Programet e Lendeve te Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" (Syllabuset

225 Evidenca.1.8 Rregullorja e UT-se Nenet 46- 49 https://api.fshn.edu.al/uploads/RREGULLORE E UNIVERSITETIT TE TIRANES 0904201901121 5 1256b853ff.pdf

226 Evidenca III.11 Syllabus i lendes se Programit te studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"- "Koncepte te avancuara ne Kimi dhe Teknologji Ushqimore"

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | parashikuar praktika laboratorike sip.sh. lënda "Ndotja në industrinë e produktcve ushqimore".<br>3. Disa lëndë kanë seanca laboratorike cdo javë, dhe në këte rast vlerësimi në laboratorët e lendëve bëhet me 10%-30% të totalit të pikëve<br>4. Provimi përfundimtar vlerësohet në masen 70%-85% të vleres totale prej 100 pike.[227]<br>Format e kontrollit të njohurive ndryshojnë nga lënda në lëndë sipas natyrës specifike. Provimi me shkrim mund të jetë me pyetje alternative dhe/ose shtjelluese. Tezat e provimit riformulohen cdo vit. Tezat e provimit final hartohen nga titullari i lëndës dhe firmosen nga drejtuesi I departamentit [228]. | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ shpreh opinionin që ky është një institucion që funksionon mbi bazën e rregulloreve dhe procedurave të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre duke ja bërë të ditura studentëve që me fillimin e vitit akademik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Vlerësimi në cdo lëndë, është dinamik dhe bëhet gjatë gjithëë semestrit. Ai realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Kjo gjë pasqyrohet në Syllabuset e cdo lënde, në seksionin "Elementët e vlerësimit".[229] Vlerësimi ndryshon sipas specifikave të programeve të lendëve. [230], [231] Kur vlerësimi është i vazhduar, studenti testohet 2-3 herë/semestër[232]. Vlerësimi bëhet sipas pikëve nga 0-100 pike (në përqindje nga 0-100%). Cdo student mund të mbledhë një seri pikësh gjatë vitit sipas elementëve mësimorë të përmendur në standarti III.2/kriteri 3. Rezultati |

227 Evidenca.I.16 Tabela permbledhese Aneks RVB ASCAL, Tabela 15

228 Evidenca III.25 Model Teze Provimi

229 Evidenca I.10 Programet e Lendeve te Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" (Syllabuset)

230 Evidenca I.10 Programet e Lendeve te Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" (Syllabuset)

231 Evidenca I.16 Tabela permbledhese per ANEKS RVB ASCAL, Tabela 15

232 Evidenca III.26 Shembull Program te lendes me Vleresim te Vazhduar (VLV) (Syllabus)

| | |
|---|---|
| | perfundimtar I pikëve konvertohet me notë, duke filluar nga I (njëshi) deri 10(dhjetë),ku nota 1 (nje) deri në 4 (katër) janë jokaluese; ndërsa notat nga 5-: (pese) deri në 10(dhjetë) janë kaluese. Kjo sanksionohet edhe në rregulloret përkatëse që janë Rregullorja e Përgjithshme e UT-së, dhe ajo e programit të studimit[233],[234]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Vlerësimi i provimeve bëhet nga pedagogu/pedagogët e lendës. Për lëndët me zgjedhje ose për grupet mësimore të vogla provimi bëhet i sekretuar. Kjo procedure mund të kërkohet nga studentët per te garantuar objektivitetin në vleresim dhe për të rritur transparencen (nuk përdoren barcode). Mënyra e hartimit të tezes në dy seksione, me pyetje me alternativa në përqindje të konsiderueshme dhe me pyetje me shtjellim ku kërkohet arsyetim ; shmang mundësine e abuzimit nga studentët. Sipas Rregullores së UT dhe studentët njihen me vlerësimin përfundimtar dhe pikët në provimin me shkrim. Në vitet 2019-2020 dhe 2020-2021 kur mësimi u zhvillua on line dhe UT implementoi testimin përmes platformes elektronike Microsoft Teams për testimin dhe vlerësimin e studentëve [235,236,237] i cili garantoi transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershem për studentet. Perdorimi j aplikacioneve online si kahoot, google forms ku studentët zgjedhin alternativat e sakta mundëson marrjen e rezultateve të shpejta dhe transparente. Kjo formë përdoret ndonjëhere edhe në seminare. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Titullari i lëndës është përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentëve. Kur lënda ka edhe pedagogë të tjerë vlerësimi bëhet nga të dy pedagogët që angazhohen për elementët e lendës[238].Në tezë deklarohen pikët për pergjigjet e sakta për cdo seksion. Në tezë ka informacion edhe për % e pikëve që studenti të shpallet kalues dhe që rezulton 45-50% të |

233 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022. Neni 60, fq. 31 https://unitir.edu.al/ content/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetil-te-tiranes.pdf

234 EvidencaI.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore

235 Evidenca III.3 Udhezues i Universitetit te Tiranes per perdorimin e sistemit te mesimit ne distance https://fshn.edu.al/notilications/udhezues-i-universitetit-te-tiranes-per-perdorimin-e-sistemit-te-mesimit-ne-distance https://api.fshn.edu.aploads/Udhezues_i_UT_per_mesimin_ne_distance_12c2b81980.pdf

236 Evidenca III.4 Rregullore e posacme e Universitetit te Tiranes mbi menyren e zhvillimit te provimeve "online" te sezonit te dimrit te vitit akademik 2021-2022https://fshn.edu.al/Info/rregullore/notifications/rregul lore-e-posacme-e-universitetit-te-tiranes-mbi-menyren-e-zhvil limit-te-provimeve-online-te-sezonit-te-dimrit-te-vitit-akademik-2021-2022 /

237 Evidenca III.2 Udhezues bazik per perdorimin e platformes Microsoft Teams https://unitir.edu.al/manual-perdorimi-microsoft-teams

238 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 59, fq.31 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

| | |
|---|---|
| | pikëve totale të tezes[239]. Studentët merren në provim nga një komision i përbëre nga minimumi dy pedagogët e lëndës, Komisioni përzgjidhet nga përgjegjësi i grup lëndëve [240],[241]. |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i njohurive shoqërohet me komentet e nevojshme, për të sqaruar dhe ndihmuar studentin që të përmirësohet. Pedagogu pas provimit, mund të informojë studentin për përgjigjet ose zgjidhjet e tezës.Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit. Ai njihet me pikët totale të vleresimit të tezës si dhe me pikët e cdo rubrike. Ai mund të ankimohet brenda 24 oreve nga shpallja e rezultateve. Këto Te drejta sanksionohen në Rregulloret e UT[242] dhe atë të MSH në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Rregullorja e Diplomimit parashikon procedurë dhe rregulla për zhvillimin e provimit, ndalimin e kopjimit dhe plagjaturës për detyrat e kursit ose punimeve të diplomes; si dhe respektimin e Kodit të Etikes në UT. Në rast të konstatimit të kopjimeve, studentit i zerohen pikët e vlerësimit. Punimi i diplomes nuk duhet të jete plagjiature[243], në të kundërt pedagogu udheheqës, nuk lejon mbrojtjen e diplomës nga studenti[244],[245]. |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Vleresimi i dijeve dhe njohurive bëhet mbi bazën e respektimit të Rregullores së UT dhe Rregullores së programit Master i Shkencave në "Shkenca dhe Teknologjitë Ushqimore". Rezultatet e provimit me gojë jepen menjëherë ndërsa të provimit me shkrim brenda 5 ditëve nga data e provimit[246],[247]. Më tej pasi studenti merr rezultatin dhe ka për të bërë sqarime, pritet 2 ditë dhe pastaj doëzohet procesverbali në sekretarinë mësimore. Përmes sistemit e-studenti[248] hidhen notat paraprake dhe studenti ka të drejtë te ankimojë vlerësimin dhe më tej mer sqarimin nga pedagogu dhe kalohet në vlerësimin përfundimtar, ku bëhet |

239 Evidenca III.25 Model teze provimi

240 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022. Neni 59, fq. 31 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e-uniiversitetit-te-tiranes.pdf

241 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

242 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022. Nenet 61-62, fq. 32 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2O22/O8/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

243 Evidenca III.34 Urdher i brendshem Nr. 18 dale 15.06.2022 "Per ngritjen e grupit te punes per hartimin e Projekt Rregullores per kontrollin antiplagjiature ne UT"

Evidenca V.4 Rregullore Per "Diplomimin ne Ciklin e I. II dhe te III ne Universitetin e Tiranes

244 Evidenca II.3 Rregullore per diplomimin ne Programin e studimit Cikli II Master i Shkencave ne DKI, neni 7

245 Evidenca V.4 Rregullore Per "Diplomimin ne Ciklin e I. II dhe te III ne Universitetin e Tiranes

246 Evidenca II.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 60 https://fshn.edu.al/info/rregullore/notification rregullore-<!-ut-perditesuar

247 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

248 Evidenca V.23 Manuali per sistemin eStudent te UT-se

| | |
|---|---|
| | arkivimi i notave[249]. Procedura duhet të përfundojë brenda 7 ditëve. Më tej procesverbalet dorëzohen fizikisht hardcopy në sekretarinë mësimore të firmosura nga pedagogu.[250] Kur ka probleme në funksionim e-studenti, rezultatet ju njoftohen studentëve përmes e-mailit te studentit. Në përfundim të programit të studimit, studentëve ju njehsohet nota e ponderuar, qe mer në konsideratë dhe kreditet respektive për cdo disiplinë[251],[252]. |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Në Rregulloren e UT[253], sanksionohet e drejta e studentit për ankimim per zhvillimin dhe rezultatin përfundimtar të provimit. Sikurse u citua në kriterin e mësipërm përmes sistemit e-studenti njihet e drejta e studentit per t'u njohur me vleresimin individualisht dhe kërkesa për rishikim të vleresimit [254,255,256].<br>Pas shpalljes së rezultatit të provimit studenti ka të drejtë, ti drejtohet pedagogut/pedagogëve të lëndës për sqarim. Në rast të mos-sqarimit ai I drejtohet me shkrim drejtuesit të departamentit që mbulon atë lëndë. Kur problemi nuk zgjidhet, atëherë drejtuesi njofton dekanatin për situatën dhe mbasi bëhet verifikimi, dhe e gjen të drejtë ankensën, dekanati ngre komision ad-hoc i cili bën rivlerësimin dhe jep vlerësimin përfundimtar të provimit. [257],[258] |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Mbështetur në Rregulloren e UT dhe Rregulloren e Programit të Studimit neni 26, studenti ankimom rezultatin e provimit, brenda 24 oreve, tek pedagogu i lëndes ose komisioni i provimit dhe kur nuk bindet përsëri, brenda 48 orëve nga marrja dijeni e rezultatit të provimit, ai paraqit me shkrim një kërkesë drejtuesit të departamentit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur nuk gjen dot zgjidhjen e ankesës, njofton dekanatin, I cili ka kompetenc të ngreje komision ad-hoc për të dhënë zgjidhjen përfundimtare. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlercsimin përfundimtar të provimit. Procedura e ndjekur arkivohet [259], [260] |

249 https;//e-student.unitir.edu.al/e student al/

250 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", Neni 26

251 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf'

252 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", Neni 32

253 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022. Neni 62 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

254 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 62 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e unitmiversitetit-te-tiranes.pdf

255 Evidenca I.6 Rregullore e Departamentit te Kimise Industriale

256 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Usbqimore", Neni 29

257 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 62 https://unitir.edu.al/wp-content uploads/2022/08/rregullore e-universitetit-te-tiranes.pdf

258 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologiite Ushqimore", Neni 29

259 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Neni 62 https://unitir.edu.al/wp-content/uploadM2022/08/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

260 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", Neni 29

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ shpreh opinionin që DKI operon mbi bazën e legjislacionit në fuqi. Ai siguron një vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Dokumentacioni shoqërues në bibliografi është bindës për këtë qasje korrekte* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Programi Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" synon arsimimin dhe formimin e specialisteve në fushën e kimisë dhe teknologjisë së ushqimeve.Po ashtu synimi edhe krijimi i aftësive profesionale, interpretuese, analitike dhe zbatuese, të përftuara gjatë periudhës së studimit. Studentët në këtë program marrin formim të thelluar në lëndët: Industria ushqimore e lëndeve bimore e shtazore, Mikroorganizmat industrial dhe Teknologjia e fermentimit, Konceptet e Avancuara të Teknologjisë Ushqimore, Enzimologjia e aplikuar, Ndotjet në produktet e industrisë ushqimore, Teknologjitë e ruajtjes së produkteve ushqimore, Modelimi dhe simulimi i proceseve, etj. Po ashtu një synim tjetër është fitimi i aftësive praktike në laborator nëpermjet seancave laboratorike ku përpunohen dhe analizohen mostra ushqimore. Përmes këtyre seancave studentët përdorin mjete dhe aparatura bazë dhe te sofistikuara në një laborator me drejtim fiziko- kimike si në drejtim mikrobiologjik.. Në lëndet karakterizuese studentët te praktikojnë aftësi profesionale nëpërmjet eksperimenteve dhe përdorimit të instrumentave laboratorike.[261] Një drejtim i synuar për aftësimin e studentëve është edhe orientimi drejt njohurive të informacionit,[262] dhe prezantimit në publik. Kjo gjë realizohet përmes detyrave të kursit [263] Gjithashtu, garanci për një program studimi efikas është jo vetëm kurrikula[427], por dhe personeli akademik dhe strukturat e nevojshme të cilat mundësojnë rritjen e kompetencave, në |

261 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", Neni 34

262 Evidenca I.16 Tabela permbledhese ANEKS RV8 ASCAL, Tabela 9

263 Evidenca III.27 Detyre kursi studenti- (Demostrim)

| | |
|---|---|
| | përgjigje të nevojave të tregut të, punës. Laboratorët janë të pajisur me të gjitha aparaturat didaktike për zhvillim cilësor të seancave laboratorike.[264], [265]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Programi MSH ne SHKI ofrohet në gjuhën shqipe. Kurrikula e programit të studimit përmban lëndë bazë dhe lendë nëpërmjet të cilave studenti merr njohuritë dhe zhvillon aftesitë profesionale e të vecanta në fushën e teknologjisë së inforamacionit, komunikimit dhe ndërveprimit. Për këtë zhvillohet lënda 'Statistika e aplikuar në industrinë ushqimore', 'Modelim dhe Stimulim', lëndët me zgjedhje për zhvillimin e aftësive humane dhe sociale për mundësi komunikimi dhe ndërveprimi.[266] . Me fillimin e vitit akademik dekanati kërkon informacion në lidhje me lendët që mund të zhvillohen në gjuhë të huaj. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Në syllabuset e cdo lënde studentet informohen në lidhje me kompetencat dhe aftesitë, rezultatet e të nxënit, që marrin në cdo lëndë të këtij programi studimi.[267] Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentet maten përmes vlerësimit të studentit, në gjithe treguesit e vleresimit. Metoda e vlerësimit është simestrale, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me gojë (në orët e seminarit dhe seancave të laboratoreve) dhe me shkrim në orët e kontrollit semestral të lendës. |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e | Kopetencat profesionale që fitohen në laboratorë kontrollohen nga pedagogu dhe ato zënë një peshë në vlerësimin përfundimtar 10-30%. Në orën e fundit të semestrit për cdo lëndë pedagogu bën një përmbledhje dhe një diskutim me studentët në formë konsultimi[268]. Vlerësimi I elementëve mësimorë bëhet me përqindje dhe pikë në silabuset e lëndëve[269],[270]. Kompetenca e stafit akademik të lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" është garancia për të përcjelle tek studentet njohuri në mënyrë aplikative. Pervec kësaj departamenti ka laboratore shkencore, të cilët ndihmojnë në realizimin e |

264 Evidenca I.18 Perberja e hollesishme e infrastruktures funksionale mesimore-shkencore te Departamentit te Kimise Industriale

265 Evidenca III.10 Inventaret e laboratorit te Teknologjise Ushqimore dhe lista e aparaturave

266 Evidenca I.9 Plani Mesimor i Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

267 Evidenca I.10 Programet e Lendeve te Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" (Syllabuset)

268 Evidenca III.20 Evidenca e stafit akademik per ngarkesen mesimore (demostrim)

269 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne"Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", Neni 21

270 Evidenca III.11 Syllabus i lendes se Programit te studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

| | |
|---|---|
| problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë te përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | seancave laboratorike qe ndihmojne të zhvillojnë njohurite e marra në leksione dhe ofron mundësi të zhvillimit të punimit të diplomes në menyrë eksperimentale[271] Rezultatet e të nxënit, studenti i zhvillon deri në përfundim të lendës. Mësimdhenia kombinon formimin teorik me pervojën praktike në bashkëpunim me institucione ku zhvillohen, vizita tematike.[272], të cilat kryhen pranë institucioneve si ndërmarje prodhimi të industrisë ushqimore, linja të përpunimit të lendëve të para ushqimore si Lufra, laboratore te vlerësimit të cilesisë dhe sigurisë ushqimore si ISUV. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Si pjesë e veprimtarive ekstra kurikulare konsiderohen leksionet e hapura, me lektorë të ftuar, që organizohen në department. Në mënyrë të vazhdueshme mbahen leksione të tilla me tematika të vecanta dhe njoftimi reth tyre bëhet në faqen zyrtare në rubriken njoftime të FSHN[273]. Ftohen profesorë të huaj apo edhe specialistë vendas që kanë akses me teknologjitë e reja. Personeli akademik merr pjesë në trajnime[274], shkolla verore[275] për të percjellë zhvillime të reja të shkencës tek studentet e tyre nëpërmjet leksionevc të hapura.**Sipas ketij kriteri kerkohet qe stafi efektiv te realizoje leksione te hapura me studentet per tema specifike. Nuk na duket e arsyetuar nga raporti sepse nuk ka dokumentacion shterues.**<br>Realizohen vazhdimisht trajnime të dedikuara për stafin të organizuara nga Universiteti i Tiranës, Qëndra e Zhvillimit profesional. |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Personeli akademik përdor disa forma për përfshirjen e studentëve në debat interaktiv për te nxitur bashkëpunimin mes tyre. Një nga format e përfshirjes konsiderohen detyrat e kursit, diskutimi i rasteve të studimit eksperimental marrë nga literature bashkëkohore, simulimi i një situate, ushtrime, etj.. Pjesë e vlerësimit vjetor është paraqitja e detyrave të kursit, individuale dhe/ose në grup. FSHN nxit zhvillimin, inovacionin nëpërmjet përfshirjes së tyre në konkurse të ndryshmne si projektet e financuara nga Balfin grup, ku fituesi i idesë inovatore financohet me një buxhet të caktuar për të zhvilluar idenë e tij, po ashtu |

271 Evidenca II.16 Skedari i temave te diplomave te mbrojtura ne programin Master i Shkencave SHTU ne vitet 2022, 2023, 2024

272 Evidenca I.16 Tabelat permbledhese ANEKS RVB ASCAL, Tabela 5

273 Evidenca III.12 faqja zyrtare e fakultetit FSHN me rubrikat perkatcese. \\www.fshn.edu.al

274 Evidenca III.15 certifikata te pjesemarjes se stafit pedagogjik ne trajnime te ndryshme

275 https://www.fshn.edu.al/notifications/shkolla-verore-panna-2024-for111esi111i-i-te-anlh111es-se-siste111eve-ushqi1110re

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | pjesemarja ne Start up-e. FSHN financon pjesmarjen e pedagogëve në projekte shkencore ku përfshihen edhe studentët.[276],[277]. | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët përmes angazhimit të tyre në punët në laborator, në tematika të caktuara shkencore, në përfshirjen në tipe të ndryshme të industrise dhe ne konkurse, ku synohet zhvillimi i kompetencave profesionale e shkencore te tyre* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" përmbyllet me punim e tezës së diplomes,[278] e sanksionuar edhe në Rregulloren e UT,[279], Rregulloren e Programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"[280]. Tema e përzgjedhur mund të jetë teorike ose eskperimentale[281] FSHN identifikon qartë detyrimet përmbyllese dhe I publikon në web FSHN, nëpërmjet sekretarisë mësimore, departamentit dhe udhëheqësit shkencor apo komunikimit me e-mail[282] |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | Studentët që janë në prag të diplomimit marrin sqarimet e nevojshme nga: drejtuesi i departamentit apo i grup lëndeve, gjatë takimit informues, në lidhje me procesin e diplomimit dhe/ose sekretaria mesimore. Udheheqësi i temes asiston studentin dhe e informom atë me udhëzime dhe materiale të nevojshme për |

276 Evidenca I.42 Raportet vjetore te FSHN, tabela e financimeve

277 Evidenca V.5 Vendimi SA Nr.40 date 09.10.2023 "Per zhvillimin e konferences shkencore studentore nderkombetare-UT https://fshn.edu.al/notifications/thirrje-per-pjesemarje ne-konferencen-shkencore-studentore-nderkombetare

278 Evidenca I.9 Plani Mesimor i Programit studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

279 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022, Nenet: 68-69, fq. 36

280 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore". Neni 33

281 Evidenca II.3 Rregullore per diplomimin ne Programet e studimit Cikli II Master i Shkencave

282 Evidenca III.17 Komunikim me email midis udheheqesit dhe studentit







| | |
|---|---|
| | punimin e diplomës dhe përmbylljes së programit të studimit[283],[284],[285] |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" nuk zhvillohet provim final sepse bëhet me mbrojtje diplome |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Pedagogu udheheqës e orienton dhe ndihmon studentin jo vetem në përcaktimin e temës së diplomës dhe ndjek realizimin e saj hap pas hapi. Udhëheqesi e asiston studentin në zhvillimin e punës eksperimentale. Ai ka detyrim të kryejë konsultime\komunikime të rregulla me studentin, për ti dhënë atij sygjerimet apo rekomandimet e duhura. Ai ka detyrim të zbatojë Rregulloren diplomimit UT neni 12 fq 7, Rregulloren diplomimit Master i Shkencave në "SHTU" neni 8. Ndihma e tij vazhdon edhe në formatimin, shkrimin sipas udhëzuesit, përcaktimin dhe shkrimin e literatures, paraqitjes korrekte te rezultateve, interpretimit të tyre, ndërtimit të tabelave apo grafikevë duke garantuarcilësine e diplomës, deri në permbylljen e saj brenda afatit kohor te percaktuar[286],[287] Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udheheqësi miraton punimin e kryer nga studenti. Ai jep mendimin e tij për nivelin cilësor, elementet e punës kriiuese dhe lejon ose jo mbroitien e punimit[288],[289] |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Departamenti KI është I predispozuar të ndihmojë studentët për te realizuar studimet e tyre duke ju krijuar lehtësira të ndryshme[290]. Institucioni mundëson përdorimin e laboratorëve dhe reagentëve me të gjitha kapacitetet për realizmin e diplomave ekperimentale. Në këtë department realizohen shumë diploma eksperimentale [291] mbi analizat e ushqimeve. Kryesisht përdoren laboratorët e analizave fiziko-kimike ose të mikrobiologjisë, ku ju vihen në |

283 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

284 Evidenca III.17 Komunikim me email midis udheheqesit dhe studentit

285 Evidenca III.14 Model udhezuesi punim diplome

286 Evidenca II.3 Rregullore per diplomimin ne Programet e studimit Cikli II Master i Shkencave ne DKI

287 Evidenca III.14 Model udhezuesi punim diplome

288 Evidenca III.13 Shkresa e komisionit te mbrojtjes se diplomave

289 Evidenca II.3 Rregullore per diplomimin ne Programet e studimit Cikli II Master i Shkencave ne DKI

290 Evidenca II.2 Perberje e hollesishme e infrastruktures funksionale mesimore-shkencore per programin e studimit Master SHTU

291 Evidenca II.2 Perberje e hollesishme e infrastruktures funksionale mesimore-shkencore per programin e studimit Master SHTU

| | |
|---|---|
| | dispozicion aparaturat e pranishme[292]. DKI nëpërmjet bashkëpunimeve me depratamentet e tjera të FSHN dhe me institucionc të tjera, i ndihmon studentët në realizimin e matjeve, apo analizave të ndryshme mbi bazën e fushës së studimit. Për studentët që interesohen për trajnime ose internshipe DKI ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani brenda fushës që mbulon DKI si p.sh Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti", Fabrika Lufra, Fabrika Stela. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Procedura e vlerësimit të mbrojtjes të Diplomëës bazohet Rregulloren e Diplomit. Mbrojtja e diplomës kryhet në prani të një komisioni të ngritur nga drejtuesi i departamentit. Pas prezantimit të temës së diplomës, studenti vlerësohet siaps sistemit shqiptar të vlerësimit me notë nga 1-10. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në procesverbal, që firmoset nga të gjithe anëtarët e komisionit dhe depozitohet në sekretarinë mësimore.[293] . Ai bëhet publik në fund të mbarimit të mbrojtjes së diplomës dhe iu komunikohet studentëve[294].Kundrejt vlerësimit përfundimtar, studenti nuk ka të drejte ankimimi. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të programite të studimit, pasi studenti rezulton pa asnjë detyrim financiar me institucionin dhe dhe Bibliotekën, dekani aprovon kërkesen për diplomim. Studenti paiset me diplomë [295] Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" që shoqërohet me listën e notave dhe suplementin e saj, të miratuara nga MAS. dhe të firmosur nga Dekani dhe Rektori i Universitetit të Tiranës.[296],[297],[298] Diploma me të cilën pajiset studenti është dokument zyrtar. Sekretaria mësimore e njësisë kryesore FSHN, plotëson Diplomën dhe suplementin e Diplomës për cdo student.[299] Diplomat shoqerohen me suplementin që përshkruan natyrën, nivelin, përmbaitien, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i saj. Diploma plotësohet me shkrim te qartë dhe me bojë teknike. Në diplomë shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli |

292 Evidenca III.10 Inventaret e laboratort te Teknologjise Ushqimore dhe lista e aparaturave

293 Evidenca III.10 Inventaret e laboratorit te Teknologjise Ushqimore dhe lista e aparaturave

294 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore. Neni 33

295 Evidenca II.3 Rregullore per diplomimin ne Programet e studimit Cikli II Master i Shkencave ne DKI

296 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranes. Neni 110, 111 fq. 64-65 https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 5916t19f405.pdf

297 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes, Neni 71.
https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/1-rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

298 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

299 Evidenca II.5 Modeli i Diplomes per Programin e studimit Master i Shkencave "SHTU"
Evidenca II.6 Suplementi i Diplomes per Programin e studimit Master i Shkencave "SHTU"

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e UT Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet certifikata "Medalje e Artë" dhe per studentet që gjatë studimeve kanë marrë, mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesen tjetër 9 (nenta), jepet certifikata "Student i Shkëlqyer". [300], [301], [302], [303] Në rast se studentit I nevojitet një kopje e programit të studimit, ai paiset me të nga sekretaria mesimore. Dhe pastaj tërheq programin e firmosur dhe vulosur nga Rektori. Dorëzimi i programit, bëhet brenda 10 ditësh.[304]</td></tr>
<tr><td>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</td><td colspan="4">Studenti diplomant depoziton një kopje të punimit të diplomës në Departament, të shoqëruar me CD ku përfshihet materiali në ëord dhe prezantimi në ppt. Kopja e diplomës se dorëzuar firmoset· nga studenti, udhëheqesi dhe përgjegjesi i Departamentit. Një kopje e saj ruhet në Departament dhe temat e diplomave hidhen ne një skedar[305] ku jane te pasqyruara te gjitha temat e diplomave në vite. Institucioni ka për detyrë të mbajë në formë të shkruar dhe elektronike: rregjistrin themeltar[306]; regjistrin e arritjeve akademike. Regjistrat depozitohen ne arkivat e shtetit, (sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat), ndërsa, kopja e njësuar me origjinalin, ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së IAL. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopja e dokumentacionit të regjistrimit të tij, arkivohet dhe ruhet për nje periudhë pa afat.</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">DKI ndjek procedura të qarta për detyrimet përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.Të gjitha këto detyrime ai I ka mirë të sanksionuara në të gjithë dokumentacionin e paraqitur në dosje.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes sëstandardit</td><td>Nuk përmbushe t</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

300 Evidencal.2 Statuti i Universitetit te Tiranes. Neni 113 fq. 65-66 https://api.fshn.edu.al/uploads/Statuti i Ri i UT 59 l6d9f405 pdf

301 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes, Neni 74. fq. 38 https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/08/rregullore-e-universitetit-te-tiranes.pdf

302 Evidenca I.20 Rregullore e programit te studimit Master i Shkencave ne "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore"

303 Evidenca III.29 Certifikate mirenjohjeje per rezultate te larta

304 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit te Tiranes 2022

305 Evidenca II.16 Skedari i temave te diplomave te mbrojtura ne programin Master i Shkencave SHTU ne vitet 2022, 2023, 2024

306 Evidenca II.31 Regjistri themeltar i studenteve (Demostrim)

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** | | | |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | **N/A** | | | |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | **N/A** | | | |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | **N/A** | | | |
| **Konkluzione** | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | Departamenti i Kimisë Industriale ka një trupë akademike prej 19 anëtarësh me kohë të plotë (2021–2022), numër që në vitin 2023–2024 u reduktua në 17, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe Statusin e universitetit të Tiranës (Ligji Arsimit të lartë; Evidenca I.2)[307,308]. Struktura e stafit përfshinte: 3 "Profesorë Doktorë", 4 "Profesorë të Asociuar", 10 me gradën "Doktor i Shkencave" dhe 2 asistentë lektorë me diplomë "Master i Shkencave" në proces doktorature. Gjithashtu, 6 punonjës ndihmës akademikë mbështesnin aktivitetet praktike dhe mirëmbanin laboratorët. Në vitin akademik 2023–2024, personeli akademik përbëhet nga 17 anëtarë: 4 "Profesorë Doktorë", 3 "Profesorë të Asociuar", 9 "Doktorë Shkencash" dhe 1 "Doktoraturë në Proçes" "MSc" (Evidenca I.16; I.24)[309,310]. Një pjesë e lëndëve mbulohen nga stafi akademik nga departamentet e tjera të FSHN (Evidenca II.19)[311]. Stafi ndihmës përbëhet nga 5 persona me arsim të lartë, ku njëri zotëron dy diploma universitare (Evidenca I.26)[312], dhe një tjetër ka përfunduar Shkollën Pasuniversitare (Evidenca I.26)[319.] Këta anëtarë marrin pjesë gjithashtu në projekte, trajnime dhe konferenca për zhvillimin profesional (Evidenca I.20)[313]. Departamenti përmbush kërkesat ligjore sipas nenit 25 të Ligjit për |

[307] Ligji nr 80, 2015 "Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin hkencore ne IAL ne Republiken e Shqiperise, Neni 59, pika 6, fq 52
[308] Evidenca I.2 Statuti ei UT, Kreu V, Neni 66,67,68,69 fq 41-44
[309] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse Aneks RVB ASCAL, Tabela 1,2,3 Numeri i personelit akademik dhe gradat shkencore PAE dhe PAK
[310] Evidenca I.24 CV e personelit akademik efektiv (PAE) të Departamentit të Kimisë Industriale
[311] Evidenca II.19 CV Personelit Akademik nga Departamente të tjera të FSHN të përfshirë në mësimdhënien në progmamin e studimit Master i Shkencave SHTU
[312] Evidenca I.26 CV e personelit ndihmës-akademik
[313] Evidenca I.20 Rregullore e programit studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimor" Kreu I Neni 7, fq.6, Kreu IV, Neni 16 fq.10 pika 1

| | |
|---|---|
| | Arsimin e Lartë, (Ligji Arsimit të lartë)[314]. Përvoja e gjatë e stafit në mësimdhënie dhe kërkim, si dhe angazhimi në projekte dhe zhvillimin e lëndëve, është një nga pikat e forta të këtij departamenti (Evidenca II.26; I.20)[315,316].<br>Ne lidhje me stafin qe angazhohet ne programin e studimit, ka nje staf akademik sipas viteve si me poshte[317]:<br>2021 – 2022: PAE/PAK : 12/3<br>2022 – 2023 : PAE/PAK : 12/3<br>2023 – 2024 : PAE/PAK : 13/3<br><br>Më konkretisht, për vitin 2021-2022 angazhohen si staf PAE: 2 "Profesorë Doktorë", 2 "Profesorë të Asociuar", 8 "Doktorë Shkencash". Si staf PAK: 1 "Profesorë Doktorë", 2 "Doktorë Shkencash"<br>Për vitin 2022-2023 angazhohen si staf PAE: 2 "Profesorë Doktorë", 3 "Profesorë të Asociuar", 7 "Doktorë Shkencash".<br>Si staf PAK: 1 "Profesorë Doktorë", 2 "Doktorë Shkencash"<br>Për vitin 2023-2024 angazhohen si staf PAE: 3 "Profesorë Doktorë", 3 "Profesorë të Asociuar", 6 "Doktorë Shkencash", 1 "Doktoraturë në Proçes"<br>Si staf PAK: 1 "Profesorë Doktorë", 2 "Doktorë Shkencash" |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Në bazë të Rregullores së Programit të Studimeve Master i Shkencave në "SHTU" (Evidenca I.20), çdo anëtar i stafit akademik me kohë të plotë ka detyrimin të përmbushë ngarkesën mësimore që përfshin leksione, seminare, punë laboratorike dhe praktikën profesionale, sipas përcaktimeve të bëra nga Departamenti në përputhje me planin mësimor. Shpërndarja e orëve të mësimit në auditor bëhet në bazë të lëndëve përkatëse dhe përcaktohet nga përgjegjësi i lëndës, në varësi të ngarkesës totale që ka secila lëndë. Ngarkesa mësimore për secilin pedagog përcaktohet në përputhje me titullin apo gradën e tij shkencore |

[314] Ligji nr 80, 2015 "Per Arsimin e Larte dhe Kerkimin Shkencore ne IAL ne Republiken e Shqiperise, Neni 25
[315] Evidenca II.26 Aktiviteti shkencor i stafit te Departamentit Kimi Industriale në vitet 2021-2024
[316] Evidenca I.20 Rregullore e programit studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" Kreu IV Neni 18 pika 2 fq.12, Neni 19 fq.12
[317] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse Aneks RVB ASCAL, Tabela 6.1;6.2;6.3 Numeri i personelit akademik dhe gradat shkencore PAE dhe PAK

| | |
|---|---|
| | (Evidenca IV.4; IV.4.1; II.7)[318,319,320]. Në fillim të çdo viti akademik, duke u mbështetur në planet mësimore të miratuara për atë vit dhe duke marrë në konsideratë burimet njerëzore të brendshme dhe të jashtme të ofruara nga departamenti, hartohet plani mësimor i sugjeruar për vitin akademik. Ky plan miratohet nga Senati, i kryesuar nga Rektori. Ngarkesa mësimore në programin Master i Shkencave në "SHTU" zbatohet sipas këtij planifikimi (Evidenca I.16)[321]. I gjithë stafi është i kualifikuar dhe zotëron grada shkencore përkatëse (Evidenca I.24; I.25)[322,323]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Departamenti i Kimisë Industriale (DKI) në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN) siguron kapacitetet e nevojshme për mbulimin e plotë të programit të studimit. Departamentet e FSHN-së disponojnë staf akademik me kohë të plotë, i cili është rekrutuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për punësimin në arsimin e lartë dhe me Kodin e Punës. Institucioni garanton qëndrueshmëri të stafit akademik përmes kontratave të përhershme pune (Evidenca IV.13)[324] dhe krijon një mjedis pune të qëndrueshëm financiarisht dhe të sigurt, duke promovuar barazi, respektim të të drejtave, liri akademike, si dhe autonomi financiare dhe organizative. Gjithashtu, institucioni siguron rregullsinë në kontratat e punës dhe në pagesat mujore, duke përfshirë pagesat për orët shtesë, shpërndarjen e diplomave dhe ofrimin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore (Evidenca IV.14; IV.12)[325,326]. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit "SHTU" është i kualifikuar (Evidenca I.25)[327], mban tituj dhe grada shkencore dhe ka treguar vazhdimësi e qëndrueshmëri ndër vite për të paktën gjashtë vitet e fundit duke dhënë kryesisht të njëjtat lëndë (Evidenca IV.13; I.16)[328,329]. |

[318] Evidenca IV.4 Udhezimi MARS Nr 29 dt 10.09.2018, prot 9268 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë

[319] Evidenca IV.1 Udhëzim MASR Nr.IV 37, dt.04.12.2018 perditsuar "Për veprimtarine dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"

[320] Evidenca II.7 Ngarkesa mësimore e stafit akademik PAE (të departamentit DKI)

[321] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse Aneks RVB ASCAL, Tabela 7. Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre

[322] Evidenca I.24 CV e stafit akademik efektiv (PAE) të Departamentit të Kimisë Industriale

[323] Evidenca I.24 CV e stafit akademik efektiv (PAE) të Departamentit të Kimisë Industriale

[324] Evidenca IV.13 Kontrata punësimi të personelit akademik ndër vite në programin e studimit Master Shkencor "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"

[325] Evidenca IV.14 Vërtetim page për punonjësit e FSHN

[326] Evidenca IV.12 Listë pagesa te sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

[327] Evidenca I.25 Kualifikimi i stafit akademik sipas grup-lëndëve ku japin mesim

[328] Evidenca IV.13 Kontrata punësimi të personelit akademik ndër vite në programin e studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"

[329] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB ASCAL Tabela 6. Cilesia e stafit mesimedhenes per programin e studimit 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Procesi i rekrutimit të personelit të ri në Universitetin e Tiranës menaxhohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Protokoll-Arshivës në nivel qendror, në bashkëpunim me njësitë përkatëse në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës) (Evidenca I.2; I.23)[330,331]. Për vlerësimin e kandidatëve që aplikojnë, ngrihet një Komision Ad-hoc, i cili brenda një afati maksimal prej 10 ditësh kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve, kryen verifikimin paraprak të dokumentacionit dhe përcakton nëse kandidatët përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për vendin vakant (Evidenca I.39; I.2; IV.5)[332,333,334]. Procesi i vlerësimit zhvillohet në dy faza të njëpasnjëshme: shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervista (Evidenca I.2)[335]. Vetëm kandidatët që kalojnë me sukses fazën e parë mund të marrin pjesë në intervistë (Evidenca IV.5; I.38; IV.6)[336,337,338]. Brenda tre ditëve pune nga zhvillimi i intervistës, Komisioni Ad-hoc shpall kandidatin fitues. Konkurimi zhvillohet në ambientet e Dekanatit të FSHN dhe emri i fituesit publikohet edhe në faqen zyrtare të fakultetit (Evidenca IV.7)[339]. Pas shpalljes, Rektori nënshkruan kontratën e punës brenda një periudhe prej 10 ditësh dhe kështu formalizohen marrëdhëniet e punës (Evidenca I.38)[340]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Personeli ndihmës akademik në Departamentin e Kimisë Industriale përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët zotërojnë kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e praktikave laboratorike dhe për të siguruar mirëmbajtjen e ambienteve laboratorike dhe të tjera mësimore, në përputhje me karakteristikat e programit të studimit (Evidenca I.26)[341]. Në Departamentin e Kimisë Industriale (DKI), pothuajse çdo laborator mbulohet nga personel ndihmës akademik i përshtatur me natyrën specifike të veprimtarisë laboratorike dhe në numër të mjaftueshëm për të realizuar me sukses orët praktike dhe |

[330] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Kreu V, Nenet 67, 68, 69 fq.42-44
[331] Evidenca I.23 Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[332] Evidenca I.39 Manual punësimi i stafit në UT
[333] Evidenca IV.5 Njoftim pune mbi vendin vakant për staf akdemik efektiv (PAE)
[334] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranës, Kreu V, Neni 67, pika 5 & 6, fq.42-43
[335] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit te Tiranës, Neni 67, pika 7, fq. 43
[336] Evidenca IV.5 Njoftim pune mbi vendin vakant për staf akdemik efektiv (PAE)
[337] Evidenca I.38 Procedurë punësimi për personel akademik efektiv (PAE)
[338] Evidenca IV.6 Procedurë punësimi për staf akademik me kontratë
[339] Evidenca IV.7 Njoftim për fituesin e vendit vakant (PAE)
[340] Evidenca I.38 Procedurë punësimi për personel akademik efektiv (PAE)
[341] Evidenca I.26 CV e personelit ndihmës-akademik

| | |
|---|---|
| | për të siguruar mirëmbajtjen e ambienteve laboratorike. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës akademik janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit të Tiranës (Evidenca I.2)[342] dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Master në "SHTU" (Evidenca I.20)[343]. Ata janë përgjegjës për ruajtjen dhe funksionimin e laboratorëve, për përcaktimin e nevojave teknike dhe logjistike të pajisjeve, si dhe bashkëpunojnë ngushtësisht me stafin akademik për zhvillimin e orëve laboratorike dhe veprimtarive kërkimore-shkencore të udhëhequra nga ky staf (Evidenca I.26)[344]. Stafi administrativ dhe akademik qëndron gjithmonë në dispozicion të studentëve, me qëllim sigurimin e funksionimit normal të procesit mësimor. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Protokoll-Arkivës në nivel institucional (Evidenca IV.1; IV.2)[345,346] ndërsa në Fakultetin e Shkencave të Natyrës përgjegjës janë Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arkivës (Evidenca I.23)[347]. Për çdo anëtar të stafit akademik dhe ndihmës akademik mbahet një dosje personale (Evidenca IV.25)[348], e cila përfshin dokumente si CV, diploma universitare, dëshmi gjuhësh të huaja dhe kompjuteri, raport mjekësor, kartë identiteti, libreza pune, akt emërimi dhe kontratë pune (Evidenca IV.26)[349]. Në fillim të çdo viti akademik, përcaktohet ngarkesa mësimore për stafin e përfshirë në programin Master në "SHTU", përfshirë edhe pedagogët e ftuar (Evidenca II.17)[350]. Kjo ngarkesë formalizohet në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, bazuar në Udhëzimin e MASR Nr. 29, datë 10.09.2018 (Evidenca IV.4; IV.4.1; IV.4.2)[351,352,353]. Stafi përditëson rregullisht CV-në dhe dokumentacionin shëndetësor (Evidenca I.24; IV.15)[354,355]. |

[342] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 79, fq. 50
[343] Evidenca I.20 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Kreu II, Neni 8 fq.7
[344] Evidenca I.26 CV e personelit ndihmës-akademik
[345] Evidenca IV.1 Organigramë e Universitetit të Tiranës
[346] Evidenca IV.2 Struktura Organizative e Universitetit të Tiranës
[347] Evidenca I.23 Organigrama e Fakultetit te Shkencave të Natyrës
[348] Evidenca IV.25 Model dosje personel akademik efektiv në DKI
[349] Evidenca IV.26 Lista e dokumentave për dosjen e punonjësit FSHN
[350] Evidenca II.7 Ngarkesa mësimore e PAE të Departamentit KI sipas viteve
[351] Evidenca IV.4 Udhëzimi MASR Nr.29, dt.10.09.2018, Nr. 9268 Prot, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"
[352] Evidenca IV.4.1 Udhëzim MASR Nr.37, dt.04.12.2018 i përditësuar "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"
[353] Evidenca IV.4.2 Udhëzim MASR Nr.36, dt.23.11.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"
[354] Evidenca I.24 CV e stafit akademik efektiv (PAE) e Departamentit të Kimisë Industriale
[355] Evidenca IV.15 Njoftim mbi kërkimin e librezës shëndetësore dhe raportin e aftësisë për punë Evidenca VI.20 Manual i Vlerësimit të performancës të personelit akademik të UT

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Institucioni siguron staf të kualifikuar dhe të mjaftueshëm për të udhëhequr studentët gjatë praktikave profesionale dhe përgatitjes së temës së diplomës. Stafi akademik i Departamentit të Kimisë Industriale është i angazhuar në kërkim shkencor dhe përpiqet të rrisë vazhdimisht nivelin e tij profesional, duke kontribuar kështu në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Përmes programit Erasmus+ KA1 (Evidenca I.3)[356], janë realizuar mobilitete për trajnim dhe mësimdhënie në institucione partnere. Gjatë viteve 2021–2024 janë zhvilluar vizita dhe bashkëpunime me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare (Evidenca I.42)[357]. Fakulteti i Shkencave të Natyrës bashkëpunon me universitete, institucione publike dhe kompani private në fushën ushqimore, duke organizuar vizita me studentët dhe pedagogët. Programi Master në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" mbështetet në bashkëpunime akademike dhe kërkimore për realizimin e objektivave të tij. Praktikat profesionale zhvillohen nën mbikëqyrjen e stafit akademik, i cili ndjek dhe vlerëson progresin e studentëve. Për trajnime apo praktika profesionale, Departamenti ka marrëveshje me kompani të fushës ushqimore në përputhje me profilin e programit, si: Lufra, Stefani & CO, Klegen, AKU, Amita, Insifa, Atlas etj. (Evidenca I.49)[358]. Institucioni gjithashtu ofron staf të përgatitur për mbikëqyrjen e punimeve të diplomës (Evidenca I.24)[359]. Procesi i diplomimit zhvillohet sipas rregullores së UT dhe të programit Master "SHTU" (Evidenca I.8; I.20)[360,361], dhe përmbyllet me një punim teorik ose eksperimental (Evidenca II.5; II.16)[362,363] i zhvilluar nën drejtimin e një udhëheqësi shkencor. Tema zgjidhet nga studenti me mbështetjen e udhëheqësit, i cili ofron konsultime të rregullta deri në përfundimin e punimit. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet | Për studentët e interesuar për trajnime apo praktika profesionale, Departamenti i Kimisë Industriale ka marrëveshje me kompani të sektorit ushqimor që përputhen me profilin e programit, si: Lufra, Stefani & CO, Klegen, AKU, Amita, Insifa, Atlas etj. (Evidenca |

356 Evidenca I.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023-2028
357 Evidenca I.42 Raportet vjetore të FSHN a)2021-2022 fq.112-122, b)2023-2024 fq 25, c)2021-2022 fq.112-122, d)2023-2024 fq 25, e)2021-2022 fq.52 f)2023-2024 fq 25
358 Evidenca I.49 Lista e marrëveshjeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
359 Evidenca I.24 CV e stafit akademik efektiv (PAE) të Departamentit të Kimisë Industriale
360 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022, Neni 67,68 fq.35-36
361 Evidenca I.20 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Kreu V, Neni 30 fq.17
362 Evidenca II.5 Modeli i Diplomës për Programin e studimit Master i Shkencave "SHTU"
363 Evidenca II.16 Skedari i temave të diplomave të mbrojtura në programin Master i Shkencave SHTU në vitet 2022, 2023, 2024

<table>
<tr><td>të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</td><td colspan="4">I.49)[364]. Këto praktika u japin studentëve mundësi të fitojnë përvojë profesionale, të thellojnë njohuritë dhe të përmirësojnë mundësitë e punësimit. Modeli i marrëveshjes (Evidenca IV.38) përcakton qartë detyrimet e palëve dhe parashikon që institucioni pritës mund të konsiderojë punësimin e studentëve pas përfundimit të praktikës. Marrëveshja ndihmon në koordinimin e procesit dhe realizohet për një periudhë të caktuar kohore. Praktika miratohet nga institucioni pritës, ku përcaktohet edhe periudha e zhvillimit. Procedurat janë të rregulluara në nenin 66 të Rregullores së UT (Evidenca I.8)[365] dhe të programit Master "SHTU" (Evidenca I.20)[366]. Në fillim të vitit akademik, Departamenti dhe pedagogu përgjegjës informojnë studentët mbi zhvillimin e praktikës. Personeli akademik mbikëqyr realizimin e praktikës, ruan komunikimin me studentët dhe institucionin pritës dhe siguron ndjekjen e rregullt të saj. Studentët duhet të ndjekin plotësisht praktikat dhe të respektojnë rregullat e vendosura. Në përfundim, dorëzojnë raportin për praktikën, i cili vlerësohet nga pedagogu përkatës pasi merret mendimi i institucionit pritës (Evidenca IV.39)[367].</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">GVJ vlerëson se struktura akademike që mbështet programin e studimit është e qëndrueshme dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet akademike. Stafi përbëhet nga pedagogë me përvojë të gjatë, tituj dhe grada shkencore përkatëse, të cilët garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe vazhdimësinë e procesit mësimor. Gjithashtu, prania e një personeli ndihmës akademik të kualifikuar siguron funksionimin efektiv të aktiviteteve praktike dhe laboratorike. Institucioni demonstron angazhim të vazhdueshëm për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore, duke ndjekur procedura të rregullta për rekrutim, vlerësim dhe përditësim të të dhënave të stafit. GVJ vlerëson pozitivisht faktin që institucioni garanton cilësinë e mbulimit akademik të programit, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin profesional të stafit dhe mbështetjen e studentëve.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

[364] Evidenca I.49 Lista e marrëveshjeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[365] Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022, Neni 66 fq.34
[366] Evidenca I.20 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Kreu V, Neni 31 fq.17
[367] Evidenca IV.39 Model raporti mbi praktikën e zhvilluar të studentit në një institucion publik/privat

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ofron hapësira të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, përfshirë salla leksionesh, seminari dhe laboratorë (Evidenca I.22; I.18; I.16)[368,369,370]. Ambientet për programin Master në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" janë të mirëmbajtura dhe të pajisura në përputhje me nevojat e tij. Mësimi zhvillohet në godinat A, B, C dhe D të fakultetit (Evidenca II.14; IV.16)[371,372], të organizuara sipas natyrës së lëndëve dhe numrit të studentëve.<br>Godina A: 10 salla, kapacitet 684 studentë<br>Godina B: 4 salla, kapacitet 328 studentë<br>Godina C: 7 salla, kapacitet 411 studentë<br>Godina D: 6 salla, kapacitet 694 studentë<br>Departamenti i Kimisë Industriale shfrytëzon laboratorë të dedikuar për zhvillimin e praktikave, si: Laboratori i Analizave Kimike Laboratori i Mikrobiologjisë Industriale dhe Ushqimore Laboratori i Inxhinierisë Kimike I dhe II Laboratori i Bioteknologjisë në godinën C Salla kompjuterike për punë praktike dhe për studentët diplomantë Numri i studentëve është i përshtatur me kapacitetet e klasave (Evidenca I.20)[373]. Ambientet ofrojnë ndriçim, ajrosje natyrale dhe janë të pajisura me sistem ngrohjeje/kondicionimi dhe mjete didaktike të nevojshme për zhvillimin normal të mësimit. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike | Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor – përfshirë sallat e leksioneve dhe seminareve – janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për të mbështetur kërkesat e lëndëve dhe për të përmbushur objektivat teorikë e praktikë të programit të studimit. |

[368] Evidenca I.22 Infrastruktura e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[369] Evidenca I.18 Përbërja e hollësishme e infrastrukturës funksionale mësimore-shkencore të Departamentit të Kimisë Industriale
[370] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB ASCAL, Tabela 16. Mjediset e Fakultetit/Njësive Baze
[371] Evidenca II.14 Orari mësimit të Programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"
[372] Evidenca IV.16 Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës 2022-2023
[373] Evidenca I.20 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore",

| | |
|---|---|
| dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Disa nga sallat në godinat A, B dhe D janë të pajisura me kondicionerë, ndërsa në godinat A dhe C funksionon sistemi i ngrohjes qendrore gjatë sezonit të dimrit. Laboratorët (Evidenca II.1)[374] janë të pajisur me aparatura dhe mjete pune sipas specifikave të secilës lëndë. Në disa prej sallave të mëdha të leksioneve në godinat A, B dhe D janë instaluar sisteme audio-vizuale të përhershme. Për më tepër, stafi akademik përdor videoprojektorë portativë dhe pajisje personale si laptopë për pasurimin e procesit mësimor (Evidenca III.21)[375]. Zyrat e stafit janë të pajisura me kompjuterë, printera dhe akses në internet, ndërsa në nivel departamenti ndodhet një fotokopje qendrore në dispozicion të të gjitha zyrave. Gjithashtu, disa prej pajisjeve laboratorike janë të integruara me kompjuterë për përdorim në veprimtari praktike dhe eksperimentale (Evidenca III.10)[376]. |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete të përshtatshme që përmbushin kërkesat e lëndëve të parashikuara në program. Laboratorët në godinën A, si edhe laboratori i Bioteknologjisë, ku zhvillojnë praktikat studentët e programit Master në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", janë të pajisur me aparatura moderne (Evidenca I.18)[377]. Metodat e përdorura në këto laboratorë janë të standardizuara dhe shërbejnë për analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike, që realizohen në kuadër të projekteve, doktoraturave, diplomave, apo në funksion të kërkesave të palëve të treta (Evidenca IV.36)[378]. Investimet në laboratorë janë bërë vazhdimisht, bazuar në buxhetet e FSHN (Evidenca IV.8; IV.9; IV.10)[379,380,381]. Çdo vit, departamenti mbledh kërkesat e stafit për pajisje, reagjentë dhe nevoja të tjera laboratorike në funksion të planifikimit të buxhetit (Evidenca IV.40)[382]. Në vitet e fundit, laboratorët janë pajisur me aparatura të reja që janë në përdorim të studentëve gjatë punës praktike (Evidenca IV.17)[383]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, | Në kuadër të Departamentit ndodhet edhe një sallë laboratorike e dedikuar për simulim dhe modelim, e njohur si "Laboratori i Simulim-Modelimit" (salla 113A, me sipërfaqe 92.2 m²) |

[374] Evidenca II.1 Laboratorët e Departamentit të Kimisë Industriale për zhvillimin e punëve laboratorike
[375] Evidenca III.21 Lista e personelit akademik e pajisur me laptop dhe pajisje audio-vizive
[376] Evidenca III.10 Inventarët e laboratorit të Teknologjisë Ushqimore dhe lista e aparaturave
[377] Evidenca I.18 Përbërja e hollësishme e infrastrukturës funksionale mësimore-shkencore të Departamentit të Kimisë Industriale
[378] Evidenca IV. 36 Analizë për të tretë
[379] Evidenca IV.8 Buxheti FSHN 2021
[380] Evidenca IV.9 Buxheti FSHN 2022
[381] Evidenca V.10 Buxheti FSHN 2023
[382] Evidenca V.40 Njoftim për planifikimin e projekt buxhetit të Departamentit të Kimisë Industriale
[383] Evidenca IV.17 Foto të pajisjeve të reja për programin Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | (Evidenca I.18)[384]. Kjo sallë është e pajisur me 24 poste pune me kompjuterë, të cilët janë përditësuar së fundmi me pajisje të reja dhe me impiante pilot që përfaqësojnë procese të ndryshme të inxhinierisë kimike. Vlera e këtij laboratori qëndron në softuerët e instaluar, të cilët përdoren për simulime në mbështetje të disa kurseve specifike. Ndër to përfshihen: Microsoft Office, Aspen Plus / Hysys, Design II, MATLAB, SuperPro Designer, LINGO | | | |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | Institucioni zotëron kapacitete dhe ambiente të përshtatshme për zhvillimin e seancave praktike laboratorike. Hapësirat e dedikuara për veprimtari praktike, veçanërisht laboratorët në Departamentin e Kimisë Industriale (Evidenca II.1)[385], janë të mjaftueshme për realizimin e plotë të tyre. Programi i studimeve Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" përdor gjashtë laboratorë, përfshirë edhe ato për përgatitje (Evidenca I.18)[386], për zhvillimin e seancave laboratorike në lëndë si: Konceptet e Avancuara në Kimi dhe Teknologji Ushqimore, Mikroorganizmat Industriale dhe Bioteknologjia e Fermentimeve, Inxhinieria e Proceseve Biokimike, Teknologji Molekulare e Aplikuar në Industrinë Ushqimore, Modelimi dhe Simulimi i Proceseve, etj. Përveç kësaj, për studentët e interesuar, Departamenti i Kimisë Industriale ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani të ndryshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe internshipeve (Evidenca I.46)[387]. | | | |
| **Konkluzione** | *Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se institucionit i janë siguruar mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin cilësor të procesit mësimor dhe formimit praktik të studentëve. Mjediset janë funksionale, të mirëpajisura dhe në përputhje me nevojat specifike të programit të studimit, duke mbuluar në mënyrë të balancuar komponentët teorikë dhe praktikë. Investimet e vazhdueshme në laboratorë, prania e një laboratori të teknologjisë së informacionit dhe bashkëpunimet me subjektet e te ndryshme private për praktikën profesionale dëshmojnë angazhimin serioz të institucionit për ofrimin e kushteve bashkëkohore të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

[384] Evidenca I.18 Përbërja e hollësishme e infrastrukturës funksionale mësimore-shkencore të Departamentit të Kimisë Industriale
[385] Evidenca II.1 Laboratorët e Departamentit të Kimisë Industriale për zhvillimin e punëve laboratorike
[386] Evidenca I.18 Përbërja e hollësishme e infrastrukturës funksionale mësimore-shkencore të Departamentit të Kimisë Industriale
[387] Evidenca I.46 Marrëveshje bashkëpunimi mbi realizimin e praktikave dhe internshipeve të studentëve

| Standardi IV.3<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Në fillim të çdo viti akademik, Departamenti i Kimisë Industriale miraton literaturën bazë për çdo lëndë, e cila reflektohet në syllabus-et përkatëse (Evidenca I.10)[388]. Pedagogët udhëzojnë studentët për literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar (Evidenca III.11)[389]. Literatura bazë ofrohet në gjuhën shqipe, në formë të shtypur ose si leksione të përgatitura nga pedagogët e FSHN-së (Evidenca II.12)[390]. Në fillim të vitit, secili pedagog dorëzon materialin përkatës në librari. Studentëve u shpërndahen edhe materiale ndihmëse në format elektronik (prezantime, leksione të shkruara) përmes email-it apo platformave si Google Classroom dhe Teams (Evidenca IV.22)[391]. Literatura ndihmëse, shpesh në anglisht ose italisht, rekomandohet përmes burimeve online me akses të lirë (Evidenca I.16)[392]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Departamenti i Kimisë Industriale u siguron studentëve literaturën bazë përmes teksteve mësimore të hartuara nga pedagogët e FSHN-së, si dhe materialeve didaktike të përgatitura nga vetë stafi akademik i departamentit. Këto tekste dhe cikle leksionesh miratohen çdo fillim viti akademik me propozimin e titullarëve të lëndëve dhe raportohen në analizën vjetore të Fakultetit për aktivitetin mësimor dhe kërkimor (Evidenca I.42)[393]. Lëndët e programit Master "SHTU" mbulohen pjesërisht me tekste mësimore dhe pjesërisht me leksione të shkruara (Evidenca II.12)[394], të cilat reflektohen në syllabus-in përkatës të çdo lënde (Evidenca I.10)[395]. Të gjitha syllabus-et janë në përputhje me strukturën e përcaktuar në VKM nr. 41 (Evidenca I.16)[396] dhe |

[388] Evidenca I.10 Programet e Lëndëve të Programit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"
[389] Evidenca III.11 Syllabus i lëndës së Programit të studimit Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" "Koncepte të avancuara në Kimi dhe Teknologji Ushqimore"
[390] Evidenca II.12 Lista e titujve të literaturës bazë për lëndët e programit Master i Shkencave SHTU
[391] Evidenca IV.22 Llogari pedagogu në Microsoft Teams, faqja kryesore
[392] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB ASCAL, Tabela 17. Të dhëna të plota për platformat on-line / Struktura e teknologjisë së informacionit / Biblioteka / Biblioteka online, etj
[393] Evidenca I.42 Raportet vjetore të FSHN a) 2021-2022 b) 2023-2024
[394] Evidenca II.12 Lista e titujve të literaturës bazë për lëndët e programit Master i Shkencave SHTU
[395] Evidenca I.10 Programet e Lëndëve të Programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"
[396] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB ASCAL, Tabela 14. Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/2018

| | |
|---|---|
| | përditësohen çdo vit në versionet shqip dhe anglisht, duke përfshirë temat, literaturën bazë dhe atë ndihmëse (Evidenca I.17)[397]. Për secilën lëndë, literatura është e ndarë në pjesë të detyrueshme dhe ndihmëse, e paraqitur në mënyrë të detajuar sipas kapitujve. Pedagogët përditësojnë rregullisht përmbajtjen e leksioneve me tituj të rinj dhe literaturë të botuar rishtazi. |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Universiteti i Tiranës vë në dispozicion bibliotekën qendrore të UT-së dhe bibliotekën e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN). Biblioteka Qendrore funksionon sipas statutit dhe rregullores së universitetit dhe synon të mbështesë procesin mësimor dhe kërkimin shkencor (Evidenca I.2; I.8)[398,399]. Biblioteka e FSHN ndodhet në godinën B (kati përdhes dhe kati i parë), me një sipërfaqe prej 678.75 m² (Evidenca I.22)[400], dhe përmban një fond të pasur librash dhe materialesh në gjuhën shqipe dhe të huaj. Ky fond pasurohet periodikisht në përputhje me kërkesat e departamenteve (Evidenca IV.45)[401]. Shërbimet ofrohen në katër ambiente, duke përfshirë tre salla leximi me rreth 140 vende pune (Evidenca IV.18)[402]. Ambienti është i aksesueshëm në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët dhe stafin akademik, pa pagesë. Biblioteka funksionon në bazë të rregullores së brendshme të FSHN-së (Evidenca IV.18)[403] dhe ofron gjithashtu materiale në formë elektronike nga burime online për studentët e të gjitha cikleve, stafin akademik dhe kërkuesit shkencorë. Departamenti i Kimisë Industriale përfshin kërkesa të detajuara për literaturë në buxhetin vjetor, me qëllim pasurimin e fondit dhe përditësimin e kurrikulës së programit. Biblioteka e FSHN ka dixhitalizuar katalogun bibliografik përmes sistemit COBISS, dhe operon me katër punonjës: tre në funksion të operimit të bibliotekës dhe një të angazhuar në Buletinin e Fakultetit. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe | Sipas raportit të GVB dhe evidencave të paraqitura, Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) disponon një fond të pasur me mbi 36,695 njësi librash dhe disertacionesh, si dhe mbi 15,000 njësi të botimeve periodike. Prej këtyre, 1,230 janë në gjuhën shqipe dhe 35,465 në gjuhë të huaj. Fondi përfshin |

[397] Evidenca I.17 Komunikim me email për përditësimin e syllabuseve
[398] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Kreu 2, Neni 28, fq.17
[399] Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës, Neni 12, fq.6
[400] Evidenca I.22 Infrastruktura e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[401] Evidenca IV.45 Informacion online mbi bibliotekën FSHN
[402] Evidenca IV.18 Vendim dekani, Nr.215, dt.29.12.2021, "Rregullore e Brendshme e Bibliotekës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës"
[403] Evidenca IV.18 Vendim dekani, Nr.215, dt.29.12.2021, "Rregullore e Brendshme e Bibliotekës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës – Universiteti i Tiranës"

| | |
|---|---|
| dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | gjithashtu 12,252 monografi shkencore (487 në shqip dhe 11,775 në gjuhë të huaj) dhe 24,811 revista shkencore periodike (66 shqip dhe 24,745 në gjuhë të huaj). Biblioteka përfshin edhe 67 disertacione të Shkollës së Doktoraturës për periudhën 2021–2024 (Evidenca IV.18)[404]. Në bibliotekë janë të punësuar katër punonjës, të angazhuar për menaxhimin e fondit dhe për Buletinin e FSHN. Fondi përmban literaturë të lidhur me lëndët e programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore". Çdo pedagog ka të depozituar pranë departamentit dosjen me leksione dhe literaturën përkatëse për lëndët që zhvillon me studentët (Evidenca II.12)[405]. Biblioteka ofron gjithashtu një listë të literaturës ndihmëse, të cilën studentët mund ta përdorin gjatë studimeve. Fondi përditësohet herë pas here me tituj të rinj, sipas nevojave të identifikuara nga departamenti. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), ka siguruar abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR, e cila ofron akses në mbi 12 milion artikuj, 85,000 libra dhe 2 milion dokumente nga 75 disiplina të ndryshme (Evidenca IV.19)[406]. Studentët dhe stafi mund ta përdorin këtë shërbim përmes e-mailit zyrtar. Biblioteka e FSHN-së është pjesë e rrjetit COBISS dhe ofron materiale elektronike nga platformat online si MARS, EDGAR, ASTM, IOP dhe MPS, falë projekteve si ERA2012, me mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare dhe Akademisë së Shkencave (Evidenca I.16)[407]. Në faqen zyrtare të FSHN-së, studentët mund të aksesojnë biblioteka online sipas udhëzimeve përkatëse (Evidenca IV.46)[408]. Aktualisht është dixhitalizuar rreth 4.2% e fondit të bibliotekës (Evidenca I.42)[409]. Gjithashtu, stafi dhe studentët kanë akses falas në U-Library (https://ulibrary.rash.al), bibliotekën digjitale të ofruar nga MASR për universitetet publike, e cila mundëson kërkimin e materialeve dhe titujve në mënyrë të strukturuar përmes një manuali udhëzues. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të | Biblioteka vë në dispozicion të studentëve katër kompjuterë me akses në internet dhe burime online, të vendosur në dy nga fondet e hapura të saj (Evidenca I.22)[410]. Studentët e programit Master në |

404 Evidenca IV.18 Vendim dekani, Nr.215, dt.29.12.2021, "Rregullore e Brendshme e Bibliotekës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës"
405 Evidenca II.12 Lista e titujve të literaturës bazë për lëndët e programit Master i Shkencave SHTU
406 Evidenca IV.19 Marrëveshja për abonim në bibliotekën dixhitale JSTOR
407 Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB ASCAL, Tabela 17, fq.17
408 Evidenca IV.46 Manuali i aksesit në bibliotekën on-line
409 Evidenca I.42 Raportet vjetore të FSHN-së, viti 2021-2023, fq.240
410 Evidenca I.22 Infrastruktura e Fakultetit të Shkencave të Natyrës

| | |
|---|---|
| tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" mund të përdorin gjithashtu pajisjet kompjuterike në sallën e kompjuterëve dhe laboratorët pranë Departamentit të Kimisë Industriale (Evidenca I.18)[411]. |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Orari i bibliotekës është i përshtatur me zhvillimin e mësimit dhe i zgjatur për të përmbushur nevojat e studentëve dhe kapacitetet ekzistuese. Shërbimi ofrohet çdo ditë të javës nga e hëna në të premte, përveç ditëve zyrtare të pushimit: E hënë – e enjte: 08:00 – 16:30 E premte: 08:00 – 14:00 (Evidenca IV.45)[412]. |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies, Universiteti i Tiranës ka vënë në dispozicion bibliotekën qendrore të UT-së dhe atë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN). UT dhe FSHN i kushtojnë rëndësi të veçantë rinovimit të ambienteve, pajisjeve dhe pasurimit të fondit të literaturës përmes planifikimit buxhetor të dedikuar (Evidenca IV.8; IV.9; IV.10)[413,414,415]. Në kuadër të objektivave strategjike për rritjen e performancës së stafit dhe cilësisë akademike, FSHN planifikon çdo vit fonde të posaçme për bibliotekën. Kërkesat për literaturë të re mblidhen nga përgjegjësit e programeve në bashkëpunim me stafin akademik dhe përcillen tek bibliotekat përkatëse, të cilat pasurohen periodikisht sipas këtyre kërkesave dhe mundësive buxhetore. Për periudhën 2021–2023, janë alokuar fonde për blerjen e librave, abonime në biblioteka digjitale dhe revista periodike. Biblioteka qendrore e FSHN ndodhet në godinën B (kati përdhes dhe kati i parë), me një sipërfaqe prej 678.75 $m^2$ (Evidenca I.22)[416], dhe ofron shërbime në katër ambiente të veçanta (Evidenca IV.18)[417], përfshirë tre salla leximi me gjithsej 140 vende pune (fondi i hapur i librit, fondi i periodikëve dhe fondi kryesor me banak). Ajo ofron një mjedis të qetë dhe të aksesueshëm në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët dhe stafin akademik, pa pagesë. Studentët e programit Master në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" përfitojnë |

[411] Evidenca I.18 Përbërja e hollësishme e infrastrukturës funksionale mësimore-shkencore të Departamentit të Kimisë Industriale
[412] Evidenca IV.45 Informacion online mbi bibliotekën FSHN
[413] Evidenca IV.8 Buxheti FSHN 2021
[414] Evidenca IV.9 Buxheti FSHN 2022
[415] Evidenca IV.10 Buxheti FSHN 2023
[416] Evidenca I.22 Infrastruktura e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[417] Evidenca IV.18 Vendim dekani, Nr.215, dt.29.12.2021, "Rregullore e Brendshme e Bibliotekës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës – Universiteti i Tiranës"

| | |
|---|---|
| | njësoj nga ky shërbim për të ndjekur literaturën në funksion të studimeve dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu, përmes faqes zyrtare të FSHN-së, studentët dhe personeli akademik kanë akses në biblioteka dhe burime online të fushave të ngjashme, duke ndjekur udhëzimet e përshkruara në manualin përkatës (Evidenca IV.46)[418]. |
| **Konkluzione** | *Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka arritur në konkuzion se institucioni ka krijuar një strukturë funksionale dhe të qëndrueshme për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimnxënien, nëpërmjet literaturës së përditësuar dhe infrastrukturës bibliotekare. Disponueshmëria e teksteve në format fizik dhe digjital, qasja te biblioteka fakulteti si dhe shërbimet e ofruara pa pagesë për studentët dhe stafin akademik tregojnë përkushtim të institucionit për të siguruar një mjedis cilësor dhe të barabartë në mbështetje të procesit mësimor.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Fakulteti i Shkencave Natyrore (FSHN) ka ndërtuar një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit të studentëve që funksionon në mënyrë të strukturuar, efikase dhe të sigurt. Ky sistem mbulon të gjitha etapat e procesit të studimit në programin Master i Shkencave "SHTU", që nga regjistrimi deri në diplomim, falë një strukture të organizuar organesh (Evidenca I.23)[419], të mbështetur në rregulloren institucionale (Evidencat IV.20; IV.21)[420,421]. Sekretaria mësimore është një hallkë kyçe në këtë proces, duke mbajtur të dhëna themelore si: regjistri i studentëve (Evidenca III.31)[422], të dhënat akademike (Evidenca III.32)[423], dhe regjistri i diplomave (Evidenca III.33)[424]. Ajo arkivon gjithashtu |

[418] Evidenca IV.46 Manuali i aksesit në bibliotekën on-line
[419] Evidenca I.23 Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[420] Evidenca IV.20 Vendim dekanati, Nr.215, dt.29.12.2021, Nr.2160 Prot, "Miratimi i Rregullores së Degës Mësimore"
[421] Evidenca IV.21 Rregullore e Sekretarisë Mësimore
[422] Evidenca III.31 Regjistri themeltar i studentëve (Demonstrim)
[423] Evidenca III.32 Regjistri i arritjeve akademike (Demonstrim)
[424] Evidenca III.33 Regjistri i lëshimit të diplomave (Demonstrim)

| | |
|---|---|
| | dosjet e regjistrimit, procesverbalet e provimeve (Evidenca III.30)[425], dokumentet e transferimeve (Evidenca I.31)[426], ekuivalencat e lëndëve (Evidenca IV.35)[427] dhe statistikat e studentëve, përfshirë çregjistrimet dhe diplomimet. Për të siguruar vijimësinë e procesit mësimor dhe komunikimin me studentët, FSHN përdor platformat Google Classroom, Google Meet, Google Forms dhe Microsoft Teams, të cilat janë përdorur gjerësisht veçanërisht gjatë pandemisë (Evidenca IV.22)[428]. Këto platforma shërbejnë për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve online, për mbledhjen e vlerësimeve dhe publikimin e notave (Evidenca V.22)[429]. Studentët kanë gjithashtu akses në sistemin elektronik e-Student të Universitetit të Tiranës, ku mund të informohen për planin mësimor, listën e lëndëve, grupet mësimore, notat, regjistrimet dhe historikun e provimeve (Evidenca IV.23)[430]. Çdo student dhe anëtar i stafit pajiset me adresë zyrtare emaili, si në nivel fakulteti, ashtu edhe universitar (Evidenca IV.24)[431]. Zyra e IT-së e FSHN luan një rol të rëndësishëm në përditësimin e informacionit në faqen zyrtare të fakultetit (Evidenca III.12)[432], duke përfshirë oraret e lëndëve (Evidenca II.14)[433], tarifat e studimit, njoftimet për provime, aktivitetet shkencore dhe aplikimet për programe shkëmbimi Erasmus+. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Institucioni disponon një sistem të brendshëm menaxhimi të qartë dhe funksional, që siguron administrimin efikas, të sigurt dhe transparent të informacionit dhe dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky sistem mbështet menaxhimin e të dhënave dhe aktiviteteve të stafit akademik dhe administrativ të përfshirë në realizimin e programit Master i Shkencave "SHTU". Nëpërmjet platformës informatike (Evidenca IV.24)[434] dhe portalit për studentët dhe stafin (Evidenca IV.3)[435], mundësohet përditësimi i të dhënave, regjistrimi në provime dhe administrimi i notave. Për funksionimin e duhur të këtyre sistemeve, çdo vit organizohen trajnime për stafin akademik (Evidenca VI.20)[436] dhe |

[425] Evidenca III.30 Procesverbal i notave të mbrojtjes së diplomave
[426] Evidenca I.31 Procedurë transferimi studimesh
[427] Evidenca IV.35 Ekuivalentim për studentët e regjistruar nga kategoria e transferimeve dhe degëve të dyta, për vitin akademik
[428] Evidenca IV.22 Llogari pedagogu në Microsoft Teams, faqja kryesore
[429] Evidenca V.22 Manuali Microsoft Teams
[430] Evidenca IV.23 Manuali për sistemin e-Student të UT-së
[431] Evidenca IV.24 Rregullore për "Funksionimin e Sistemit Informatik në Universitetin e Tiranës"
[432] Evidenca III.12 Faqja zyrtare e FSHN
[433] Evidenca II.14 Orari i mësimit të programit Master i Shkencave SHTU
[434] Evidenca IV.24 Rregullore për "Funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës"
[435] Evidenca IV.3 Logimi në sistemin e-Student të UT-së
[436] Evidenca VI.20 Manuali i Vlerësimit të performancës së personelit Akademik të Universitetit të Tiranës

| | |
|---|---|
| | administrativ (Evidenca VI.18)[437]. Gjithashtu, zbatohet sistemi i vlerësimit të performancës për të siguruar cilësinë e punës dhe përmbushjen e objektivave institucionale (Evidenca IV.47)[438]. Departamenti përkatës dokumenton çdo vit informacionin mbi ngarkesën mësimore, aktivitetet pedagogjike dhe shkencore të stafit të angazhuar në program (Evidenca I.42)[439]. Ndërkohë, Zyra e Burimeve Njerëzore përditëson dosjet personale të stafit me dokumentet përkatëse si diplomat, CV-të, kontratat e punës etj. (Evidencat IV.25; IV.26)[440,441], të cilat menaxhohen edhe në mënyrë elektronike nga njësitë përkatëse. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Bazuar në Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale (Evidenca IV.27)[442], Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ofron një sistem të sigurt dhe të aksesueshëm për menaxhimin konfidencial të të dhënave personale të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit. FSHN përdor platformat Google Classroom dhe Microsoft Teams, përmes të cilave studentët informohen rreth orareve, leksioneve, provimeve dhe aktiviteteve të tjera akademike. Sekretaria dhe departamentet luajnë rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave si listat e notave apo faturat bankare. Sistemi e-Student (Evidencat IV.23; IV.3; V.23)[443,444,445] ofron informacion të personalizuar për studentët dhe stafin, si planet mësimore, oraret, regjistrimi në provime dhe rezultatet. Stafi mund të përditësojë të dhënat, të hedhë notat dhe të shqyrtojë kërkesat për përmirësim ose ankim. Në faqen zyrtare të FSHN, e përditësuar nga personel i caktuar për çdo departament (Evidenca IV.37)[446], studentët mund të aksesojnë informacion mbi tarifat, njoftimet, bursat dhe të printojnë faturat (Evidenca IV.28)[447]. Po ashtu, Regjistri i Pedagogut (Evidenca I.19)[448] ndihmon në ndjekjen e pjesëmarrjes së studentëve në mësim, ndërsa komunikimi virtual |

437 Evidenca VI.18 Vendim i Rektoratit, Nr.3, datë 24.01.2022, "Për miratimin në parim të rregullores 'Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës-akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës'"
438 Evidenca IV.47 Politika të vlerësimit akademik të stafit të mësimdhënies në DKI
439 Evidenca I.42 Raporti Vjetor FSHN 2021-2022, fq.112-122
440 Evidenca IV.25 Model dosje personel akademik efektiv në DKI
441 Evidenca IV.26 Lista e dokumentave për dosjen e punonjësit në FSHN
442 Evidenca IV.27 Urdhër Nr.12, datë 08.06.2015, "Mbi miratimin e Rregullores 'Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës"
443 Evidenca IV.23 Manuali për sistemin e-Student të UT-së
444 Evidenca IV.3 Logimi në sistemin e-Student të UT-së
445 Evidenca V.23 Manual pedagogu për sistemin e-Student
446 Evidenca IV.37 Personi përgjegjës për faqen web të departamentit, Shkresë Nr.1951 Prot, dt.22.11.2021
447 Evidenca IV.28 Fatura për tarifat e studimit për studentët e ciklit të dytë të studimit, viti I, II dhe për studentët me mesatare 9-10, cikli II, viti I
448 Evidenca I.19 Model i regjistrit te pedagogut

| | |
|---|---|
| | zhvillohet edhe përmes email-eve zyrtare dhe aplikacioneve si WhatsApp. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Sistemi i menaxhimit në FSHN siguron një komunikim të vazhdueshëm dhe interaktiv përmes platformës elektronike e-Student, e cila lehtëson shkëmbimin e materialeve mësimore dhe informacioneve të rëndësishme si oraret, provimet dhe rezultatet e lëndëve. Përveç kësaj, një burim efektiv aksesi dhe informimi është edhe faqja zyrtare e internetit e UT/FSHN/DKI, përmes së cilës studentët dhe pedagogët informohen në kohë reale mbi vendime, njoftime dhe organizime të ndryshme. Gjatë periudhës së pandemisë, komunikimi dhe zhvillimi i mësimit u mbështet përmes klasave virtuale në platformat Google Classroom, Google Meet dhe Microsoft (Evidenca IV.22)[449]. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Ne fillim te cdo vit, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) përditëson dhe publikon aktivitetin e stafit akademik në faqen zyrtare të fakultetit. Sistemi i brendshëm i menaxhimit përfshin llogaritë personale të stafit akademik, ndihmës-akademik dhe të sekretarisë mësimore, duke siguruar një rrjedhë të organizuar dhe të kontrolluar të informacionit. Përmes platformës Microsoft Teams (Evidenca IV.22)[450] dhe llogarive të dedikuara për secilin përdorues, mundësohet monitorimi dhe informimi në kohë reale mbi aktivitetet akademike e administrative, përfshirë raportimet individuale dhe të dhënat për strukturat drejtuese. Gjithashtu ne FSHN funksionon gjithashtu zyra e IT, e cila ndihmon në zgjidhjen e menjëhershme të problematikave që lidhen me procesin e regjistrimit të studentëve në sezonet e provimeve. Gjithashtu, çdo vit stafi akademik përditëson aktivitetin e tij shkencor përmes formularëve Google Forms (Evidencat IV.41; IV.42)[451,452], duke mundësuar një regjistrim të rregullt dhe të dokumentuar të fushës se tyre kërkimore. |

[449] Evidenca IV.22 Llogari pedagogu në Microsoft Teams, faqja kryesore
[450] Evidenca IV.22 Llogari pedagogu në Microsoft Teams, faqja kryesore
[451] Evidenca IV.41 Njoftim mbi kërkimin vjetor të aktivitetit shkencor
[452] Evidenca IV.42 Njoftim mbi financim nga Fakulteti FSHN

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Ne web e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (Evidenca III.12)[453] përditësohet periodikisht për të siguruar informacion lidhur me programet e studimit, organizimin, departamentet, stafin akademik dhe njoftimet në seksionin "Njoftime". Në faqen e internetit të UT/FSHN/DKI gjendet informacion për departamentin e Kimisë Industriale dhe programin MSH SHTU, duke përfshirë: stafin akademik dhe aktivitetet e tyre, programet akademike që ofrohen nga departamenti, qëllimet e programeve të studimit, planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve për secilin program. Gjithashtu, në faqen gjenden të dhëna për sekretarinë, oraret, kërkimin shkencor, buletinin shkencor, bazat ligjore, njoftime për aplikime për bursa, rregulloret e UT dhe buxhetin. Gjithë informacioni i publikuar në faqen e internetit është në gjuhën shqipe dhe në anglisht (Evidencat IV.43; IV.44)[454,455]. | | | |
| **Konkluzione** | *Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka ngritur një sistem të brendshëm menaxhimi të mirëorganizuar dhe të qëndrueshëm, i cili mbështet funksionimin efektiv të të gjitha proceseve akademike dhe administrative të programit të studimit. Evidencat e paraqitura tregojnë për një përfshirje aktive të strukturave përgjegjëse në administrimin e informacionit për studentët dhe stafin, si dhe për një përdorim të gjerë të platformave digjitale që favorizojnë transparencën, interaktivitetin dhe aksesin në kohë reale në informacion. Vlerësohet gjithashtu angazhimi i institucionit për përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave, trajnimin e stafit dhe sigurimin e mbështetjes teknike. GVJ konstaton se sistemi funksionon në mënyrë të qëndrueshme dhe përmbush qëllimet institucionale për garantimin e cilësisë dhe efikasitetit në menaxhimin e programit të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

[453] Evidenca III.12 Faqja zyrtare e Fakultetit FSHN me rubrikat përkatëse – www.fshn.edu.al
[454] Evidenca IV.43 Web FSHN shqip
[455] Evidenca IV.44 Web FSHN anglisht (https://fshn.edu.al/)

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Referuar dokumentacionit te paraqitur, institucioni harton rregullisht dhe paraqet për miratim Raportin Financiar si pjesë të raportit vjetor para Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Ky dokument përfshin një vlerësim të hollësishëm të kostos mesatare financiare për student në nivel universitar. Në kuadër të politikës së transparencës, Universiteti i Tiranës (Evidenca IV.29)[456] publikon periodikisht të dhëna dhe raporte mbi buxhetin dhe situatën financiare, sipas rregullave të miratuara çdo vit. Bordi i Administrimit, duke u mbështetur në vendime dhe rregullore të miratuara, cakton tarifat e studimit për çdo cikël (Evidenca IV.30)[457] përmes një procedure të qartë. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), në bashkëpunim me Departamentet Përkatëse (DKI) dhe sipas nevojave të tyre, përgatit çdo vit akademik plan-buxhetin për realizimin e programeve të studimit (MSH SHTU). Ky plan-buxheti publikohet në platformën zyrtare të internetit të FSHN (Evidencat IV.8; IV.9; IV.10)[458,459,460], duke siguruar transparencë dhe lehtësi qasjeje në informacionin financiar. |

[456] Evidenca IV.29 Urdhër Nr.8, datë 30.03.2021, "Mbi miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në UT"

[457] Evidenca IV.30 Vendim i Bordit të Administrimit Nr.27, datë 02.08.2023, "Për miratimin e tarifave të regjistrimit dhe shkollimit për programet e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave për vitin akademik 2023-2024"

[458] Evidenca IV.8 Buxheti FSHN 2021

[459] Evidenca IV.9 Buxheti FSHN 2022

[460] Evidenca IV.10 Buxheti FSHN 2023

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.**Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Universiteti i Tiranës harton një plan buxhetor afatmesëm që përditësohet çdo vit dhe është pjesë e planit strategjik të zhvillimit. Administrata financiare është përgjegjëse për përgatitjen e projekt-buxhetit për njësitë ndihmëse, ndërsa së bashku me projekt-buxhetet e njësive kryesore, përpilon buxhetin vjetor të universitetit. Çdo vit, departamentet paraqesin kërkesat e tyre pranë dekanateve. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) publikon në faqen zyrtare buxhetin vjetor të miratuar (Evidenca IV.31)[461], që përfshin: Kuotat e konsoliduara Shpenzimet operative Investimet Numrin e planifikuar të stafit (Evidencat IV.8; IV.9; IV.10)[462,463,464] Në tabelat përkatëse paraqiten financimet për FSHN, si kontratat për objektet e fakultetit, shpenzimet ditore, pajisjet e zyrave, shërbimet speciale, abonimet në biblioteka elektronike (p.sh., EBSCO, JSTOR), rimbursimet për publikime dhe udhëtime, qiratë, detyrimet ligjore dhe mirëmbajtja. Për zbatimin e programeve të studimit, institucioni vë në dispozicion të gjitha burimet njerëzore. Stafi akademik mbështetet për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare, si dhe për bashkëpunime me universitete të huaja. Gjithashtu, çdo vit paraqiten kërkesa për pajisje të reja si kompjuterë, projektorë, printera dhe pajisje laboratorike, për të mbështetur kërkimin shkencor të stafit dhe studentëve të Departamentit të Kimisë Industriale, në kuadër të programit Master në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" (Evidenca IV.31)[465]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës auditohet nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Auditimi i brendshëm realizohet nga Njësia përkatëse në Universitet (Dega e Auditit), sipas strukturës së UT (Evidenca IV.2)[466], dhe ka për detyrë të kryejë kontroll të rregullt dhe të thelluar mbi veprimtarinë institucionale. Kjo njësi luan një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e planeve të auditimit, duke u fokusuar në fushat me risk më të lartë. Veprimtaria e saj synon përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve ndaj studentëve. Në kuadër të transparencës (Evidenca IV.29)[467], |

[461] Evidenca IV.31 Projekt buxheti 2023, për Departamentin e Kimisë Industriale
[462] Evidenca IV.8 Buxheti FSHN 2021
[463] Evidenca IV.9 Buxheti FSHN 2022
[464] Evidenca IV.10 Buxheti FSHN 2023
[465] Evidenca IV.31 Projekt buxheti 2023, për Departamentin e Kimisë Industriale
[466] Evidenca IV.2 Struktura organizative e Universitetit të Tiranës
[467] Evidenca IV.29 Urdhër Nr.8, datë 30.03.2021, "Mbi miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në UT"

| | |
|---|---|
| | raporti financiar prezantohet dhe diskutohet në organet drejtuese të universitetit dhe është i aksesueshëm për të gjitha palët e interesuara. |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Në mbyllje te vitit akademik, Universiteti ruan raportet dhe analizat financiare të përgatitura, në përputhje me legjislacionin në fuqi (Evidenca IV.29)[468]. Këto dokumente ofrojnë një panoramë të detajuar të situatës financiare të institucionit, duke përfshirë periudhën aktuale, pritshmëritë për të ardhmen dhe të dhëna nga vitet e mëparshme akademike. Raportet përmbajnë informacione mbi gjendjen financiare të universitetit, parashikimet për angazhimin e stafit akademik dhe tarifat e studimit për vitin pasardhës (Evidenca IV.32)[469]. Gjithashtu, çdo vit hartohet një projekt-buxhet afatmesëm (Evidenca IV.33)[470], i cili përgatitet në përputhje me kërkesat e fakulteteve dhe në funksion të objektivave, misionit dhe vizionit të Universitetit të Tiranës. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Çdo vit, institucioni miraton buxhetin përfundimtar (Evidenca IV.34)[471], i cili hartohet mbi bazën e kërkesave buxhetore të fakulteteve (Evidencat IV.8; IV.9; IV.10)[472,473,474] dhe synon përmbushjen e objektivave strategjike dhe realizimin e misionit të tij. Buxheti mbështetet në burimet financiare të institucionit, përfshirë të ardhurat nga tarifat e shkollimit dhe regjistrimit, grantet e alokuara nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, si dhe të ardhurat nga shërbimet e ofruara. Përmes këtyre burimeve, institucioni garanton qëndrueshmëri financiare gjatë zbatimit të programeve të studimit. Gjithashtu, institucioni disponon kapacitete të mjaftueshme për të përmirësuar situatën financiare dhe për të krijuar burime të reja të ardhurash, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm në të ardhmen. |
| **Konkluzione** | *GVJ vlerëson se IAL, demonstrojnë një nivel të lartë të qëndrueshmërisë financiare dhe aftësie organizative për të* |

[468] Evidenca IV.29 Urdhër Nr.8, datë 30.03.2021, "Mbi miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në UT"
[469] Evidenca IV.32 Udhëzim Nr.5, datë 19.08.2018, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.24, datë 21.10.2019, "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatin për raportim të institucioneve të arsimit të lartë"
[470] Evidenca IV.33 Vendim i Senatit Akademik Nr.35, datë 25.11.2021, "Për miratimin paraprak të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 për Universitetin e Tiranës"
[471] Evidenca IV.34 Vendim i Bordit të Administrimit, Nr.14, dt.11.04.2023, "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 për Universitetin e Tiranës"
[472] Evidenca IV.8 Buxheti FSHN 2021
[473] Evidenca IV.9 Buxheti FSHN 2022
[474] Evidenca IV.10 Buxheti FSHN 2023

| | |
|---|---|
| | *mbështetur funksionimin efektiv të programeve të studimit. Menaxhimi financiar është i strukturuar, transparent dhe i mbështetur në plane strategjike, duke përfshirë elementë të rëndësishëm si financimi i burimeve njerëzore, përmirësimi i infrastrukturës, përditësimi i burimeve mësimore dhe investimet në kërkim. Auditimet e rregullta, qasja në financime alternative dhe përfshirja aktive e njësive bazë në proceset buxhetore dëshmojnë për një sistem funksional dhe transparent.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron programin e studimeve Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi (Ligji për Arsimin e Lartë, Kreu VII, Neni 75, fq. 51; Neni 76, fq. 52; Nenet 87-92, fq. 57-59)[475]. Rregulloret institucionale përshkruajnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, që nga regjistrimi fillestar, ndjekja e programit deri në përfundimin e studimeve. Ato përcaktojnë kriteret e pranimit, procedurat për transferimin e studimeve dhe ndjekjen e një programi të dytë (Evidencat I.2; I.20; I.8; IV.21)[476,477,478,479], duke synuar përzgjedhjen e kandidatëve më të përgatitur bazuar në rezultatet e tyre akademike. Gjithashtu, rregullorja përfshin të gjitha aspektet |

[475] Ligji për Arsimin e Lartë, Kreu VII, Neni 75, fq. 51; Neni 76, fq. 52; Nenet 87-92, fq. 57-59
[476] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 92, fq. 57–58
[477] Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Neni 11, fq. 8
[478] Evidenca I.8 Rregullorja e Universitetit të Tiranës
[479] Evidenca IV.21 Rregullorja e Sekretarisë Mësimore, Nenët 3 & 4, fq. 2

| | |
|---|---|
| | që lidhen me organizimin dhe strukturën e programit të studimit (Evidencat I.20; I.8; IV.21)[480,481,482]. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, studentët mbështeten dhe udhëzohen nga Kujdestari Akademik, siç përcaktohet në Statutin e Universitetit të Tiranës (Evidenca I.35)[483]. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Ky program studimi është krijuar dhe zbatohet në përputhje me parimet e lirisë akademike, duke siguruar barazi dhe mundësi të njëjta për të gjithë studentët, në përmbushje të legjislacionit në fuqi. Ai garanton mundësi të barabarta për kandidatët që aplikojnë, duke ofruar akses në shërbime dhe bazuar në përzgjedhjen sipas arritjeve akademike (Evidenca I.1)[484]. Studentët kanë mundësinë të marrin udhëzime akademike nga Kujdestarët, të përdorin adresat e emailit të caktuara nga universiteti për komunikim zyrtar, dhe të kenë akses në platforma si e-Student dhe Microsoft Teams (Evidencat I.1; I.20; I.8; III.2)[485,486,487,488]. Studentet marrin pjesë në Këshillat Studentorë, të cilët promovojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe përfaqësojnë interesat e tyre në strukturat vendimmarrëse të universitetit (Evidencat I.1; V.5)[489,490]. Përveç mundësive për të marrë pjesë në aktivitete shkencore dhe sociale të organizuara nga universiteti, studentët mund të aplikojnë për bursa studimi, ulje tarifash dhe mundësi mobiliteti ndërkombëtar, përfshirë bursat Erasmus. (Evidenca I.20; I.8)[491,492]. Ata gjithashtu kanë të drejtën të ankimojnë vlerësimet e provimeve (Evidenca I.20)[493] dhe të kërkojnë këshillim psikologjik në fakultet. Aktivitetet sportive, si brenda dhe jashtë universitetit, janë gjithashtu pjesë e mundësive të ofruara për studentët (Evidencat V.1; V.2)[494,495]. |

[480] Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Neni 13, fq. 9

[481] Evidenca I.8 Rregullorja e Universitetit të Tiranës, Neni 42, fq. 23

[482] Evidenca IV.21 Rregullorja e Sekretarisë Mësimore, Nenet 3 & 4, fq. 2

[483] Evidenca I.35 Kujdestarët akademikë të studentëve të programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"

[484] Evidenca I.1 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 125 & 126, fq. 69–70

[485] Evidenca I.1 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 6, fq. 4

[486] Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Neni 32, fq. 17

[487] Evidenca I.8 Rregullorja e Universitetit të Tiranës, Neni 99, fq. 49

[488] Evidenca III.2 Udhëzues bazik për përdorimin e platformës Microsoft Teams

[489] Evidenca I.1 Statuti i UT, Nenet 130–136, fq. 71–72

[490] Evidenca V.5 Vendimi i SA Nr. 40, datë 09.10.2023 "Për zhvillimin e konferencës shkencore studentore ndërkombëtare - UT"

[491] Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Neni 28, fq. 16

[492] Evidenca I.8 Rregullorja e Universitetit të Tiranës

[493] Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore

[494] Evidenca V.1 Lista e studentëve bursistë, Cikli i II, viti akademik 2023–2024 – Bursa sipas kategorive

[495] Evidenca V.2 Takim prezantues me psikologun e fakultetit, viti akademik 2021–2022

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit Departamenti i Kimisë Industriale harton kriteret dhe kuotat për pranimin e studentëve në të gjitha programet e studimit që ofron, duke u bazuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Këto dokumente përgatiten jo më vonë se data 10 dhjetor e vitit pararendës dhe i dërgohen fakultetit, i cili ka detyrimin t'i bëjë publike deri më 20 dhjetor. (Evidencat I.1; I.34)[496,497] Kuotat e përcaktuara parashikojnë gjithashtu përfshirjen e kandidatëve nga trojet dhe nga shtresat e margjinalizuara. Kriteret dhe kuotat miratohen nga Senati Akademik i UT-së përpara se të hyjnë në fuqi. (Evidencat V.6)[498] |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Nga shqyrtimi dokumentacionit te siguruar nga GVB, kriteret (Evidenca I.34)[499], procedurat e pranimit (Evidenca V.3)[500], transferimit, vlerësimit dhe diplomimit (Evidenca I.37)[501] janë të përcaktuara në rregulloren e programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" (Evidenca I.20, Evidenca II.3)[502,503], si dhe në rregulloren e përgjithshme të UT (Evidenca I.8)[504]. Këto dokumente janë hartuar në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, dhe janë të publikuara në web e fakulteti dhe Universitetit. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | UT/FSHN publikon në faqen zyrtare informacionin mbi aplikimin në programin Master "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", përfshirë dokumentacionin e nevojshëm, kuotat dhe kriteret e pranimit. Sipas raportit te GVB dhe dokumentacionit perkates fakulteti organizon ditë informuese ku pedagogët e programit prezantojnë Masterin "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" për studentët e vitit të tretë në Kimi she Teknologji Ushqimore por edhe bachelor te tjere qe ofrohen ne fakultet, duke i njohur me përmbajtjen, organizimin dhe mundësitë e punësimit që ofron ky program. (Evidenca V.12)[505] Këto të dhëna janë të disponueshme |

[496] Evidenca I.1 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 94, pika 1, fq. 58

[497] Evidenca I.34 Kriteret e pranimit të studentëve, viti akademik 2023–2024

[498] Evidenca V.6 Vendimi i Senatit Akademik të UT Nr. 6, datë 30.03.2021, mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë, për vitin akademik 2021–2022

[499] Evidenca I.34 Kriteret e pranimit të studentëve, viti akademik 2023–2024

[500] Evidenca V.3 Procedura e regjistrimit në Master, viti akademik 2022–2023

[501] Evidenca I.37 Komisionet e shqyrtimit të dosjeve – Dega e II dhe transferimet

[502] Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Nenët 10–14, fq. 7–9

[503] Evidenca II.3 Rregullore për diplomimin në programet e studimit Cikli II – Master i Shkencave në DKI

[504] Evidenca I.8 Rregullorja e Universitetit të Tiranës, Neni 39, fq. 22

[505] Evidenca V.12 Pedagogët pjesëmarrës në njohjen dhe informimin e maturantëve me ofertën akademike të UT

| | |
|---|---|
| | edhe në faqen e fakultetit, ndërkohë që studentë nga programe të ndryshme takojnë maturantë sipas një kalendari të caktuar. Gjatë këtyre aktiviteteve shpërndahen materiale dhe broshura informuese mbi programin Master "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore". (Evidenca V.13)[506] |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Institucioni përgatit dhe publikon çdo vit përpara fillimit të vitit akademik kriteret (Evidenca I.34)[507] dhe kuotat (Evidenca V.7)[508] për përzgjedhjen e kandidatëve në këtë program studimi. Gjithashtu ne keto kuota perfshihen kandidatet nga Trojet shqiptare por gjithashtu edhe Kandidate me statusin e jetimet apo nga komunitet e tjera. |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Departamenti i Kimisë Industriale zbaton udhëzimet e Ministrisë së Arsimit (Evidenca V.10)[509] për pranimin në programin Master Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore. Gjithashtu, Departamenti parashikon kuota të veçanta pranimi (Evidenca I.34; Evidenca V.7)[510,511] për kategori si: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, shtetas të huaj, kandidatë nga trojet shqiptare (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi), si dhe për ata që kërkojnë program të dytë studimi apo transferim nga institucione të tjera. |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | RVB raporton per politika mbështetëse për studentët që vijnë nga shtresat në nevojë, si dhe për ata me rezultate të larta (Evidenca V.8)[512], me qëllim nxitjen e cilësisë në pranimin dhe përparimin e tyre gjatë studimeve. UT/FSHN vendose kritere që u mundëson studentëve përfitimin e bursave gjatë viteve akademike (Evidenca V.11)[513]. Gjithashtu raportohet nje tjeter formë mbështetjeje sic është Karta e Studentit (Evidenca V.45)[514], e cila ofron një sërë shërbimesh dhe përfitimesh në ndihmë të jetës studentore. Për studentët me vështirësi financiare, UT ofron gjithashtu mundësinë e përfitimit të Kredisë Studentore (Evidenca V.9)[515], e cila mbulon shpenzimet dhe kostot e studimeve universitare. |
| **Konkluzione** | *Konstatohet se institucioni ka ndërtuar një sistem të mirëorganizuar dhe funksional për menaxhimin e gjithë ciklit të* |

506 Evidenca V.13 Broshura "Ditët e Informimit të Maturantëve 2022"
507 Evidenca I.34 Kriteret e pranimit të studentëve, viti akademik 2023–2024
508 Evidenca V.7 Kuotat e pranimit për Ciklin e Dytë, për vitin akademik 2023–2024 – FSHN
509 Evidenca V.10 Udhëzimi i MAS, Nr. 12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë"
510 Evidenca I.34 Kriteret e pranimit të studentëve, viti akademik 2023–2024
511 Evidenca V.7 Kuotat e pranimit për Ciklin e Dytë, për vitin akademik 2023–2024 – FSHN
512 Evidenca V.8 Lista e studentëve bursistë, Cikli II – Statusi: Nota mesatare 9–10, viti akademik 2023–2024
513 Evidenca V.11 Kategoritë dhe dokumentacioni për studentët që përfitojnë bursa
514 Evidenca V.45 Panairi karta e studentit qe vjen në FSHN
515 Evidenca V.9 Dokumentacioni për aplikimin e studentëve për kredinë studentore sipas RASH

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *jetës studentore, nga pranimi deri në diplomim. Politikat dhe procedurat janë të qarta, të dokumentuara, të zbatuara në praktikë dhe të orientuara drejt garantimit të barazisë dhe aksesit për të gjithë studentët. Qasja institucionale përfshin transparencën, përfshirjen sociale dhe mbështetjen akademike, duke dëshmuar një angazhim të qëndrueshëm për krijimin e një ambienti të favorshëm për studime cilësore dhe të drejtë. Prania e mekanizmave të informimit, këshillimit dhe ndihmës financiare për studentët, tregon një nivel të lartë institucional dhe përputhje të plotë me kërkesat e standardit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | IAL dhe FSHN ofron informacion të qartë dhe të aksesueshëm për studentët mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, kalimin nga një vit në tjetrin dhe detyrimet akademike, sipas Rregullores së programit të studimit (Evidenca I.20)[516], hartuar nga DKI. Ky informacion publikohet në faqen zyrtare të FSHN. Përmes Rregullores së programit Master në SHTU, Rregullores së diplomimit (Evidenca V.4; I.20)[517,518] dhe burimeve online, studentët njihen me:<br><br>• Planin mësimor dhe kreditë përkatëse<br>• Kriteret e vlerësimit dhe sistemin e notave<br>• Afatet dhe rregullat për provimet<br>• Kushtet për diplomim dhe kalim viti<br><br>Në fillim të çdo viti akademik organizohen takime me Kujdestarin Akademik (Evidenca V.14)[519], ku studentët informohen mbi strukturën e programit, të drejtat, detyrimet dhe rregullat e |

[516] Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Kreu V, fq. 13–17

[517] Evidenca V.4 Rregullore për "Diplomimin në Ciklin I, II dhe III në Universitetin e Tiranës"

[518] Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Neni 24,29,20 fq. 14–15,16,17

[519] Evidenca V.14 Kujdestarët akademikë DKI, Cikli i Parë dhe i Dytë

| | |
|---|---|
| | ndjekjes dhe vlerësimit. Rregulloret akademike përditësohen herë pas here nga Rektorati/Senati (Evidenca V.15, V.16)[520,521] dhe publikohen në faqet zyrtare, duke u komunikuar studentëve përmes strukturave përkatëse. |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Sipas raportit të GVB, Fakulteti i Shkencave Natyrore (FSHN) ofron mundësi transferimi për studentët që kanë përfunduar të paktën një vit akademik në një program të së njëjtës cikël studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë. Kjo mundësi vlen gjithashtu edhe për ata që kërkojnë të kalojnë nga programe të mëparshme të ciklit të parë, si brenda ashtu edhe jashtë UT-së. Procesi i njohjes së studimeve të mëparshme, të kryera pjesërisht ose tërësisht, kryhet nga komisionet e ekuivalentimit të ngritura nga departamentet përkatëse (Evidenca I.37)[522]. Vendimmarrja bazohet në procedurat e detajuara të përcaktuara në Statutin e Universitetit të Tiranës (Evidenca I.2)[523], Rregulloren e përgjithshme të UT-së (Evidenca I.8)[524], si dhe Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" (Evidenca I.20)[525]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Në programin e studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" pranë FSHN, studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme për kriteret dhe mënyrat e vlerësimit përmes syllabuseve të lëndëve. Në ditën e parë të çdo moduli, syllabus diskutohet me studentët për të sqaruar ne menyre të plotë modulin qe do te zhvillohet gjate semestrit (Evidenca I.10)[526]. Sipas Rregullores së programit të studimit (Evidenca I.20)[527], vlerësimi i studentëve bazohet në një sistem pikësh që përfshin pjesëmarrjen në leksione, provimet e ndërmjetme, detyrat e kursit, aktivitetet laboratorike dhe provimin përfundimtar (Evidenca II.17)[528]. Pas korrigjimit të provimit, studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatet e detajuara, në rast mospajtimi, ata mund të paraqesin ankesë brenda 24 orëve nga momenti i njoftimit të notës (Evidenca I.20)[529]. |

520 Evidenca V.15 Vendimi i SA Nr. 17, datë 27.02.2023 "Për një ndryshim në Rregulloren e Universitetit të Tiranës"
521 Evidenca V.16 Vendimi i Rektorit Nr. 8, datë 01.10.2021 "Për disa shtesa në Udhëzuesin e UT 'Për zhvillimin e mësimit në distancë'
522 Evidenca I.37 Komisionet e shqyrtimit të dosjeve – Dega e II dhe Transferimet
523 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Kreu VII, Nenet 108–109, fq. 64
524 Evidenca I.8 Rregullorja e Universitetit të Tiranës, Nenet 79–80, fq. 39–40
525 Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Nenet 13–14, fq. 9
526 Evidenca I.10 Programet e lëndëve të programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" (Syllabuset)
527 Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Neni 23, fq. 14
528 Evidenca II.17 Struktura akademike e vitit aktual
529 Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"

<table>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</td><td colspan="4">Departamenti Kimise Industriale bazuar ne dokumentacionin e paraqitur nga GVB informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin Master i Shkencave “Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore”, në përputhje me Statutin e UT-së (Evidenca I.2)[530], Rregulloren e programit të studimit dhe diplomimit te Masterit SHTU (Evidenca I.20, Evidenca II.3)[531,532] dhe Rregulloren e Diplomimit te universitetit te Tiranes (Evidenca V.4)[533]. Në përfundim, studenti pajiset me diplomën përkatëse (Evidenca II.5)[534], si dëshmi e përmbylljes së suksesshme të studimeve.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</td><td colspan="4">Fakulteti i Shkencave Natyrore (FSHN) informon studentet për afatet e aplikimit, kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm për programet master përmes faqes zyrtare dhe broshurave informuese (Evidenca V.13)[535]. Kujdestarët akademikë (Evidenca V.14)[536] organizojnë takime me studentët e vitit të tretë për t’i njohur me programet master dhe perspektivat e punësimit. Në fillim të vitit akademik, departamenti zhvillon sesione orientuese. Për më tepër, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës ofron shërbim këshillimi dhe ndihmon studentët të lidhen me tregun e punës (Evidenca V.17; V.18)[537,538].</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Bazuar ne raportin e GVB, por edhe kriteret e mësipërme të plotesuara, institucioni ka ndërtuar dhe zbaton një sistem të qartë dhe funksional informimi për studentët, duke siguruar transparencë dhe akses të plotë në çdo fazë të procesit akademik. Informacioni mbi përparimin akademik, vlerësimin, njohjen e krediteve dhe diplomimin është i strukturuar mirë, i dokumentuar dhe i lehtësisht i aksesueshëm përmes kanaleve zyrtare dhe takimeve orientuese. Studentët janë të pajisur me të gjitha të dhënat e nevojshme për të ndjekur me qartësi e siguri rrugëtimin e tyre akademik.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

[530] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës
[531] Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore”, Neni 30, fq. 17
[532] Evidenca II.3 Rregullore për diplomimin në programet e studimit Cikli II – Master i Shkencave në DKI
[533] Evidenca V.4 Rregullore për “Diplomimin në Ciklin I, II dhe III në Universitetin e Tiranës”
[534] Evidenca II.5 Modeli i diplomës për programin e studimit Master i Shkencave “SHTU”
[535] Evidenca V.13 Broshura “Ditët e Informimit të Maturantëve 2022”
[536] Evidenca V.14 Kujdestarët akademikë DKI, Cikli i Parë dhe i Dytë
[537] Evidenca V.17 DSBCK – Leksion i hapur: “Këshillimi i Karrierës”
[538] Evidenca V.18 DSBCK – Leksion i hapur: “Si të shkruajmë një letër motivimi”

| Standardi V.3<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Studentët e programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" marrin informacion të rregullt gjatë gjithë periudhës së studimeve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit (Evidenca I.6 dhe I.9)[539,540]. Sekretaria mësimore pranë DKI/FSHN i mbështet studentët gjatë gjithë ciklit akademik, nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve (Evidenca IV.21)[541]. Koordinatori i programit ofron udhëzime fillestare dhe i inkurajon studentët të kërkojnë ndihmë individuale sipas nevojës (Evidenca I.6)[542]. Kujdestari akademik krijon kontakt me studentët që në fillim dhe i orienton lidhur me rregulloret, syllabus-et, kalendarin mësimor, mënyrat e vlerësimit, bursat dhe perspektivat e punësimit (Evidenca V.14)[543], duke raportuar në mënyrë të vazhdueshme tek Përgjegjësi i Departamentit për zhvillimin dhe problematikat që hasin studentët. Çdo pedagog prezanton syllabus-in përkatës në fillim të semestrit (Evidenca I.16)[544]. Gjatë periudhës së pandemisë, procesi mësimor dhe komunikimi me studentët janë realizuar nëpërmjet platformave Google Classroom dhe Microsoft Teams (Evidenca III.3)[545]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Departamenti i Kimisë Industriale ofron për studentët e programit Master Shkencor në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" një sërë materialesh informuese si: guida e fakultetit (Evidenca IV.16)[546], rregulloret e departamentit (Evidenca I.6)[547] dhe të programit (Evidenca I.20)[548], si dhe planet mësimore (Evidenca I.16)[549], të cilat përmbajnë të dhëna mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe aktivitetet formuese. Përveç këtyre, informacion i |

539 Evidenca I.6 Rregullorja e Departamentit të Kimisë Industriale, Nenet 15–18, fq. 13–14
540 Evidenca I.9 Plani mësimor i programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"
541 Evidenca IV.21 Rregullorja e Sekretarisë Mësimore
542 Evidenca I.6 Rregullorja e Departamentit të Kimisë Industriale, Nenet 15–18, fq. 13–14
543 Evidenca V.14 Kujdestarët akademikë DKI, Cikli i Parë dhe i Dytë
544 Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse – Aneks RVB ASCAL, Tabela 14
545 Evidenca III.3 Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë
546 Evidenca IV.16 Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
547 Evidenca I.6 Rregullorja e Departamentit të Kimisë Industriale
548 Evidenca I.20 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"
549 Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse – Aneks RVB ASCAL, Tabela 10: Plani mësimor

| | |
|---|---|
| | detajuar është gjithashtu i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të FSHN dhe në sistemin elektronik (Evidenca IV.24)[550]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Në kuadër të procesit të akreditimit (Evidenca I.11)[551], Universiteti i Tiranës realizoi në vitin 2022 një studim mbi tregun e punës (Evidenca I.13)[552], i cili evidentoi se kërkesa për programin Master "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" mbetet konstante. Departamenti i Kimisë Industriale ka përfshirë ish-studentët si staf akademik dhe ndihmës akademik (Evidenca I.24; I.26)[553,554], si dhe kryen anketime të rregullta për të ndjekur situatën e punësimit të tyre (Evidenca I.15)[555]. Struktura mbështetëse si Dega e Karrierës u ofron studentëve informacion mbi mundësitë e punësimit, organizon leksione të hapura, internshipe dhe aktivitete të tjera si panaire karriere (Evidenca V.17; V.19; V.20; V.21)[556,557,558,559]. Gjithashtu, UT promovon shkëmbimet ndërkombëtare nëpërmjet programit ERASMUS. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Në fillim të çdo viti akademik, raportohet qe studentët pajisen me informacion të plotë mbi institucionin, programet e studimit të ofruara, organizimin e procesit mësimor, vlefshmërinë e diplomës dhe infrastrukturën në dispozicion. Ky informacion aksesohet përmes faqes zyrtare të fakultetit dhe të departamentit, ku studentët mund të gjejnë oraret, njoftimet, provimet dhe dokumentet e nevojshme administrative. Përveç kësaj, secili student pajiset me një adresë personale e-maili, që përdoret për komunikim zyrtar lidhur me ndryshime në orare, regjistrime në provime dhe njoftime mbi vlerësimet. Sekretaria mësimore ofron gjithashtu asistencë të drejtpërdrejtë për çdo informacion apo shërbim që studentët mund të kenë nevojë gjatë rrugëtimit akademik (Faqa zyrtare e WEB FSHN)[560]. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes | Gjatë periudhës së pandemisë (Evidenca III.4)[561], mësimi në Universitetin e Tiranës u zhvillua në distancë për dy vite (Evidenca |

[550] Evidenca IV.24 Rregullore për "Funksionimin e Sistemit Informatik" – Universiteti i Tiranës
[551] Evidenca I.11 Akreditimi periodik institucional i Universitetit të Tiranës
[552] Evidenca I.13 Raporti i studimit të tregut të punës 2022 në Universitetin e Tiranës
[553] Evidenca I.24 CV e stafit akademik efektiv (PAE) të Departamentit të Kimisë Industriale
[554] Evidenca I.26 CV e personelit ndihmës-akademik
[555] Evidenca I.15 Raporti i studimit të tregut të punës për programin Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"
[556] Evidenca V.17 DSBCK – Leksion i hapur: "Këshillimi i Karrierës"
[557] Evidenca V.19 DSBCK – Mundësi punësimi / Internship pranë kompanisë WeWeb
[558] Evidenca V.20 Komunikimi i DSBCK me Departamentin e DKI dhe kompani private mbi punësimin e studentëve të diplomuar në DKI
[559] Evidenca V.21 Marrëveshje mbi "Realizimin e praktikave/intershipeve" me INSIFA
[560] https://www.fshn.edu.al/
[561] Evidenca III.4 Rregullore e posaçme e UT mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online të sezonit të dimrit të vitit akademik 2021–2022

| | |
|---|---|
| sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | III.3)[562], fillimisht përmes platformave Google Classroom dhe Google Meet, dhe më pas duke përdorur Microsoft Teams. Për të ndihmuar studentët në përdorimin e këtyre platformave, u përgatitën manuale udhëzuese (Evidenca V.22)[563] për të mbështetur realizimin e programeve të studimit. Studentët dhe stafi akademik patën gjithashtu akses në sistemin elektronik e-Student (Evidenca V.23)[564]. Përmes këtij sistemi, studentët mund të informohen mbi lëndët dhe modulet, grupet mësimore, listat e notave, hapjen e sezoneve të provimeve, regjistrimin në provime. Nga ana tjetër, stafi akademik përdor sistemin për të përditësuar të dhënat personale, për të menaxhuar grupet mësimore, për të hedhur notat, si dhe për të administruar kërkesat për përmirësim ose ankimim të vlerësimeve nga studentët. |
| **Konkluzione** | *Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni ka krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të informimit për studentët, që mbulon në mënyrë të qartë dhe të vazhdueshme të gjitha aspektet thelbësore të programit të studimit. Informacioni i ofruar është i plotë, i aksesueshëm dhe i përditësuar, duke përfshirë objektivat formues, përmbajtjen e programeve, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe perspektivat e punësimit. Nëpërmjet përdorimit të platformave digjitale dhe kanaleve të drejtpërdrejta të komunikimit, institucioni garanton transparencë, orientim akademik dhe mbështetje efektive për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të | Dokumentacioni mësimor dhe të dhënat e studentëve në Universitetin e Tiranës rregullohen nga Ligji për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015 dhe Rregullorja e UT-së, në nenet 55, 56, 71 dhe 76. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, sekretaria mësimore mban |

[562] Evidenca III.3 Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë
[563] Evidenca V.22 Manual për përdorimin e platformës Microsoft Teams
[564] Evidenca V.23 Manuali i pedagogut për sistemin e-Student të UT-së

| | |
|---|---|
| diplomuarve, në programin e studimit. | dhe arkivon Regjistrin Themeltar të Studentëve (Evidenca III.31)[565], Regjistrin e të Dhënave Akademike (Evidenca III.32)[566] dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave (Evidenca III.33)[567], të cilat ruhen në Arkivat e Shtetit. Gjithashtu, sekretaria administron dosjet e regjistrimit të studentëve, procesverbalet e rezultateve, dosjet e transferimeve dhe statistikat mbi ecurinë e studentëve, që nga pranimi deri në diplomim. Të gjitha dokumentet origjinale (Evidenca IV.21)[568] dhe shërbejnë për lëshimin e vërtetimeve për studentët dhe institucionet përkatëse. UT përpunon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve (Evidenca I.16)[569], të regjistruarve (Evidenca I.16)[570] dhe për të dhënat mbi transferimet, të cilat përdoren në raporte dhe analiza në nivel fakulteti dhe universiteti (Evidenca I.42)[571]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Informacioni për këtë kriter është dhënë te kriteri nr 1. Standarti V.4 |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës kujdeset për administrimin dhe ruajtjen e të dhënave mbi progresin akademik të studentëve (Evidenca IV.21)[572], në përputhje me dokumentacionin zyrtar si procesverbalet e provimeve (Evidenca III.30)[573]. Siguria e këtyre të dhënave mbrohet përmes platformave të dedikuara dhe ato janë të aksesueshme vetëm nga persona të autorizuar. Menaxhimi i informacionit realizohet përmes databazës së sekretarisë, ndërkohë që pedagogët mbajnë regjistra të veçantë për zhvillimin e mësimit dhe pjesëmarrjen e studentëve |

565 Evidenca III.31 Regjistri themeltar i studentëve
566 Evidenca III.32 Regjistri i arritjeve akademike
567 Evidenca III.33 Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave
568 Evidenca IV.21 Rregullorja e Sekretarisë Mësimore
569 Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse – Aneks RVB ASCAL, Tabela 23
570 Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse – Aneks RVB ASCAL, Tabela 21
571 Evidenca I.42 Raportet vjetore të FSHN
572 Evidenca IV.21 Rregullorja e Sekretarisë Mësimore, Neni 6, fq. 3
573 Evidenca III.30 Procesverbal i notave të mbrojtjes së diplomave

| | |
|---|---|
| | (Evidenca I.19)[574]. Vlerësimet për studentët regjistrohen në sistemin e-Student (Evidenca IV.23)[575] dhe dorëzohen të firmosura në sekretari pas çdo sezoni provimesh. Të dhënat akademike ruhen në Regjistrin Themeltar, Regjistrin e Rezultateve Akademike dhe Regjistrin e Diplomave, si dhe në databaza të dedikuara, duke respektuar plotësisht standardet e konfidencialitetit (Evidenca III.31; III.32; IV.24)[576,577,578]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Institucioni siguron monitorimin dhe menaxhimin e rregullt të njësive përgjegjëse si sekretaritë mësimore dhe sistemi i menaxhimit të informacionit përmes takimeve periodike në nivel grupi mësimor, departamenti dhe fakulteti, ku shqyrtohen problematikat dhe merren masa për zgjidhjen e tyre. Strukturat drejtuese në fakultet (dekan, zv.dekan, drejtues të degës mësimore) dhe në departament (përgjegjësit përkatës) kryejnë kontrolle të herëpashershme për të verifikuar dhe dokumentuar saktësinë e të dhënave dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin akademik. (Evidenca III.7)[579] |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Universiteti i Tiranës, në zbatim të Udhëzimit të MAS (Evidenca IV.32)[580], përgatit çdo vit Raportin Vjetor (Evidenca V.25)[581], ku vlerësohet veprimtaria mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve të studimit. Raporti përmban të dhëna mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje (Evidenca I.42)[582], si dhe shkallën e punësimit të tyre, duke propozuar masa për përmirësim. Gjurmimi i punësimit është kryer përmes studimeve të tregut në nivel universiteti dhe departamenti (Evidenca I.13; I.15)[583,584], të shoqëruara me rekomandime për rritjen e cilësisë. Tregues të tjerë përfshijnë mesataren e studentëve në hyrje, kalueshmërinë dhe cilësinë e vlerësimeve. Departamenti, në analizat vjetore, pasqyron |

574 Evidenca I.19 Model i regjistrit të pedagogut
575 Evidenca IV.23 Manuali për sistemin eStudent të UT-së
576 Evidenca III.31 Regjistri themeltar i studentëve
577 Evidenca III.32 Regjistri i arritjeve akademike
578 Evidenca IV.24 Rregullore për "Funksionimin e Sistemit Informatik në Universitetin e Tiranës"
579 Evidenca III.7 Shembuj të mbledhjeve të Departamentit, 2021-2024
580 Evidenca IV.32 Udhëzim Nr. 24, datë 21.10.2019 "Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018 'Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të IAL'
581 Evidenca V.25 Vendim i SA Nr. 2, datë 30.01.2023 "Për miratimin e Raportit Vjetor të Veprimtarisë së Universitetit të Tiranës për vitin akademik 2021-2022"
582 Evidenca I.42 Raportet vjetore të FSHN
583 Evidenca I.13 Raporti i studimit të tregut të punës 2022 në Universitetin e Tiranës
584 Evidenca I.15 Raporti i studimit të tregut të punës për programin Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"

| | |
|---|---|
| | numrin e të regjistruarve dhe të diplomuarve (Evidenca V.26; I.48)[585],[586].<br>Numri i studentëve të rregjistruar sipas viteve akademike[587]:<br>2021 – 2022: 32 Studentë<br>2022 – 2023 : 39 Studentë<br>2023 – 2024 : 38 Studentë<br><br>Numri i studentëve të diplomuar sipas viteve akademike[588]:<br><br>2021 – 2022: 40 Studentë<br>2022 – 2023 : 24 Studentë<br>2023 – 2024 : 25 Studentë |
| **Konkluzione** | *Kriteret e mësipërme po edhe dokumentacioni tregojnë qartë se institucioni ka ndërtuar dhe administron një sistem të qëndrueshëm dhe të mire-organizuar për mbledhjen, ruajtjen dhe analizimin e të dhënave të studentëve. Menaxhimi i informacionit akademik, që nga pranimi deri në diplomim dhe më tej në gjurmimin e punësimit, dëshmon për një angazhim institucional serioz ndaj monitorimit të performancës studentore dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Përdorimi i platformave digjitale, mbrojtja e të dhënave dhe hartimi i raporteve të rregullta analitike janë indikatorë të funksionimit efikas dhe profesional të proceseve të brendshme.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve | Në Universitetin e Tiranës, studentët gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë aktive në proceset e vendimmarrjes, duke respektuar ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Përfshirja dhe |

585 Evidenca V.26 Mesatarja e studentëve në hyrje të programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"
586 Evidenca I.48 Analiza vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale
587 Evidenca 1.16 Tabelat permbledhése Aneks RVB ASCAL, Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
588 Evidenca 1.16 Tabelat permbledhése Aneks RVB ASCAL, Tabela 23 të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve

| | |
|---|---|
| dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | angazhimi i tyre janë të përcaktuara qartë në Statutin e Universitetit (Evidenca I.2; I.43)[589,590], ku parashikohet pjesëmarrja e studentëve në organet kryesore drejtuese dhe audituse. Studentët kanë përfaqësues të tyre në Senatin Akademik me katër anëtarë, në Këshillat Studentorë, në Këshillin e Etikës me dy anëtarë, në Komisionin e Marrëdhënieve me Studentët me tre anëtarë, në Komisionin e Kurrikulës me dy anëtarë dhe në Komisionin e Sigurimit të Cilësisë me tre anëtarë. Po ashtu, ata janë pjesë e grupeve të vlerësimit të procesit akademik, duke kontribuar në monitorimin e cilësisë së arsimit (Evidenca V.27; V.28; V.29; III.8; I.43)[591,592,593,594,595]. Këshillat studentore në nivel institucioni dhe fakulteti janë krijuar përmes një procesi zgjedhor të administruar nga Komisioni Institucional Zgjedhor i Studentëve (KIZS) (Evidenca V.30; V.31)[596,597], ku studentët vetëkandidohen dhe zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Zgjedhjet e fundit u zhvilluan më 16 dhjetor 2021 (Evidenca V.27; V.32)[598,599], me pjesëmarrjen e të gjithë studentëve të cikleve të parë dhe të dytë të studimeve. Përveç pjesëmarrjes në organet drejtuese, studentët japin kontributin e tyre edhe në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të proceseve akademike, përmes pyetësorëve të ndryshëm që shpërndahen dhe plotësohen online (Evidenca V.39; V.40)[600,601]. Përgjigjet e mbledhura përpunohen në formën e raporteve dhe |

589 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Nenët 129 & 130, fq. 71

590 Evidenca I.43 Vendimi i SA Nr. 08, dt. 30.01.2023 "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e Standardeve të Cilësisë në Universitetin e Tiranës"

591 Evidenca V.27 Rregullore për zgjedhjet e para të Këshillave të Studentëve në UT

592 Evidenca V.28 Vendimi i SA Nr. 12, datë 11.04.2019 "Për miratimin e Këshillit të Etikës"

593 Evidenca V.29 Vendimi i SA Nr. 7, dt. 30.01.2023 "Për miratimin e anëtarëve të Komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët e UT, përfaqësues nga studentët"

594 Evidenca III.8 Vendim i SA Nr. 09, dt. 30.01.2023 "Për miratimin e Komisionit të përhershëm të Kurrikulës në UT"

595 Evidenca I.43 Vendim i SA Nr. 08, dt. 30.01.2023 "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e standardeve të cilësisë në Universitetin e Tiranës"

596 Evidenca V.30 Vendim Nr. 17 i KIZS, datë 13.12.2021 "Mbi caktimin e ditës për hedhjen e shortit për komisionet e qendrave të votimit (KQV) në njësitë përbërëse në UT"

597 Evidenca V.31 Njoftimi për aplikim për anëtarë në KIZS dhe KAS

598 Evidenca V.27 Rregullore për zgjedhjet e para të Këshillave të Studentëve në Universitetin e Tiranës – Vendim SA Nr. 22, datë 26.06.2019 "Për miratimin e rregullores për zgjedhjet e para të Këshillave të Studentëve në UT"

599 Evidenca V.32 Urdhër i Rektorit Nr. 198, dt. 11.11.2021 "Për shpalljen e periudhës zgjedhore dhe datës së zgjedhjeve, për anëtarë të Këshillave Studentore të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës"

600 Evidenca V.39 Pyetësori i studentëve – Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve në UT

601 Evidenca V.40 Pyetësor drejtuar të gjithë studentëve me fokus përdorimin e Kartës së Studentit

| | |
|---|---|
| | statistikave (Evidenca VI.8; VI.9; VI.10)[602,603,604], duke i dhënë studentëve një zë të qartë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në Universitetin e Tiranës. |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Informacioni për këtë kriter është i ngjashëm me kriterin nr 1 të Standartit V.5 dhe shpjegimi mund te lexohet me sipër |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe në Departamentin e Kimisë Industriale funksionojnë mekanizma për mbledhjen e mendimeve të studentëve, përmes Kujdestarit ose Koordinatorit Akademik, i cili zhvillon takime periodike ose sipas kërkesës. Studentët janë të përfshirë në komisionet institucionale (Evidenca I.43)[605], ku kontribuojnë me sugjerime në hartimin dhe përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të studimit. Përmes pyetësorëve të ndryshëm, studentët shprehin opinionet e tyre mbi përmbajtjen e programeve, lëndëve dhe procesin e mësimdhënies. Të dhënat e mbledhura përpunohen në raporte dhe statistika |

[602] Evidenca VI.8 a) Vlerësimi i lëndës nga studentët – Semestri I, viti akademik 2021–2022 b) Vlerësimi i lëndës nga studentët – Semestri II, viti akademik 2021–2022 c) Vlerësimi i lëndës nga studentët – Semestri I, viti akademik 2022–2023 d) Vlerësimi i lëndës nga studentët – Semestri II, viti akademik 2022–2023

[603] Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" – Viti akademik 2021–2022 a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit" – Viti akademik 2021–2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" – Viti akademik 2022–2023 b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit" – Viti akademik 2022–2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" – Viti akademik 2023–2024 c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit" – Viti akademik 2023–2024

[604] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës – Viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës – Viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës – Viti akademik 2023–2024

[605] Evidenca I.43 Vendim i SA Nr. 08, datë 30.01.2023 "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e standardeve të cilësisë në Universitetin e Tiranës"

| | |
|---|---|
| | (Evidenca VI.8; VI.9; VI.10)[606,607,608], duke nxjerrë në pah problematika që më pas adresohen përmes planeve të posaçme të masave (Evidenca VI.17)[609]. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Gjatë gjithë semestrit, studentët mbahen të informuar në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogët mbi rezultatet e provimeve të ndërmjetme, pjesëmarrjen në seminare, realizimin e detyrave të kursit dhe notën përfundimtare, si dhe përmes platformës e-Student dhe sekretarive mësimore. Në rast mospajtimi me rezultatet, studentët ndjekin procedura të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit të Tiranës (Evidenca I.8)[610], të departamentit (Evidenca I.6)[611] dhe të programit të studimit (Evidenca I.20)[612]. Ankesa për shkelje gjatë zhvillimit të provimit duhet depozituar me shkrim brenda 24 orëve, ndërsa për rivlerësimin e provimit brenda 48 orëve te Përgjegjësi i Departamentit. Nëse çështja nuk zgjidhet në këtë nivel, ajo i raportohet dekanit, i cili brenda 48 orëve krijon një komision ad hoc me tre anëtarë për shqyrtimin e ankimit. Në rast ndryshimi të notës, hartohet një procesverbal i ri, i cili bashkëngjitet me procesverbalin ekzistues. |
| **Konkluzione** | *Vleresohet se institucioni ka krijuar një kulturë të qëndrueshme të përfshirjes aktive të studentëve në jetën akademike dhe institucionale. Përfaqësimi i tyre në organet vendimmarrëse, pjesëmarrja në vlerësimin e cilësisë, kontributi në rishikimin e kurrikulës dhe mundësitë e ankimimit mbi vlerësimet akademike dëshmojnë një angazhim real dhe funksional. GVJ çmon transparencën e proceseve dhe gatishmërinë institucionale për të reflektuar sugjerimet e studentëve në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit dhe shërbimeve të ofruara.* |

[606] Evidenca VI.8 a) Vlerësimi i lëndës nga studentët – Semestri I, viti akademik 2021–2022 b) Vlerësimi i lëndës nga studentët – Semestri II, viti akademik 2021–2022 c) Vlerësimi i lëndës nga studentët – Semestri I, viti akademik 2022–2023 d) Vlerësimi i lëndës nga studentët – Semestri II, viti akademik 2022–2023

[607] Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" – Viti akademik 2021–2022 a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit" – Viti akademik 2021–2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" – Viti akademik 2022–2023 b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit" – Viti akademik 2022–2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" – Viti akademik 2023–2024 c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit" – Viti akademik 2023–2024

[608] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës – Viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës – Viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës – Viti akademik 2023–2024

[609] Evidenca VI.17 Plani i masave i Departamentit të Kimisë Industriale (DKI)

[610] Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës, Nenet 61 & 62, fq. 32

[611] Evidenca I.6 Rregullore e Departamentit të Kimisë Industriale, Neni 26, fq. 18

[612] Evidenca I.20 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore", Neni 28, fq. 16

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.6<br>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Departamenti, në bashkëpunim me njësi dhe struktura të tjera, kujdeset që studentët të informohen qartë për programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit. Gjithashtu, përmes dokumentacionit përkatës (Evidenca IV.21)[613], studentët orientohen mbi kalendarin akademik, sezonet e provimeve, si dhe datat e fillimit dhe përfundimit të vitit akademik. Në këtë proces, rol kyç luan Sekretaria Mësimore, që mbulon të gjithë ciklin nga regjistrimi deri në diplomim (Evidenca IV.21)[614], si dhe Kujdestari Akademik, i cili këshillon dhe mbështet studentët gjatë gjithë viteve të studimit (Evidenca V.14)[615]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Departamenti, në bashkëpunim me njësi dhe struktura të tjera, kujdeset që studentët të informohen qartë për programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit. Shërbimi i kujdestarisë funksionon me përkushtim, duke ndihmuar në mënyrë intensive jo vetëm studentët e vitit të parë, por edhe ata të viteve pasuese (Evidenca I.35)[616]. Një tjetër kanal shumë efikas informimi është faqja zyrtare e fakultetit. Në seksionin "Njoftime", studentët marrin në kohë reale informacione mbi oraret, provimet, aplikimet për programe ndërkombëtare si ERASMUS dhe njoftime të tjera të rëndësishme. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe | Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, studentët gëzojnë mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin e tyre akademik dhe profesional. Përmes Degës së Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës, e cila vepron si zyra e këshillimit të karrierës, ata mirëpriten dhe orientohen rregullisht për hapat kyç të rrugëtimit të tyre. Studentët udhëzohen për të përfunduar me sukses studimet, për të zgjedhur |

613 Evidenca IV.21 Rregullore e Sekretarisë Mësimore
614 Evidenca IV.21 Rregullore e Sekretarisë Mësimore
615 Evidenca V.14 Kujdestarët akademikë të DKI – Cikli i parë dhe i dytë
616 Evidenca I.35 Kujdestarët akademikë të studentëve të programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"

| | |
|---|---|
| periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | praktikat profesionale më të përshtatshme, për të kuptuar vlerën e diplomës së tyre dhe për të ndërtuar rrugën drejt tregut të punës (Evidenca V.38)[617]. Këto shërbime ofrohen përmes aktiviteteve dhe leksioneve të hapura (Evidenca I.50.1)[618], ku studentët ndihmohen të orientohen drejt mundësive konkrete në institucione dhe kompani (Evidenca I.49)[619]. Një aspekt i rëndësishëm i këtyre takimeve është edhe njohja me pritshmëritë dhe standardet e tregut të punës (Evidenca V.41)[620], shpesh duke u bazuar në përvojat e ish-studentëve të suksesshëm të DKI-së. Për t'i përgatitur sa më mirë për sfidat profesionale, studentët marrin këshillim për hartimin e CV-ve, letrave motivuese dhe zhvillimin e intervistave (Evidenca V.18)[621]. Ata gjithashtu informohen mbi mundësitë e ndryshme për të ndjekur internship-e dhe ndërtojnë plane të personalizuara karriere me ndihmën e këshilluesve (Evidenca V.17; V.18; V.19; V.20; V.33)[622,623,624,625,626]. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Departamenti luan një rol aktiv në ndërmjetësimin për punësim dhe në orientimin drejt programeve ndërkombëtare, si Erasmus+ apo shkollave verore (Evidenca V.42)[627]. Përtej kësaj, GVB raporton se ë Universitetin e Tiranës funksionon Qendra e Zhvillimit Profesional, e cila organizon trajnime të dedikuara si për stafin akademik, ashtu edhe për studentët (Evidenca V.43)[628], duke i pajisur ata me aftësi të nevojshme për një integrim të suksesshëm në tregun e punës. Gjithashtu, studentët përfitojnë nga Platforma Gradua (Evidenca V.34)[629], që lidh universitetin me botën e punës përmes kontakteve të drejtpërdrejta me kompanitë. Ndërkohë, Qendra e Karrierës Alumni forcon marrëdhëniet midis studentëve, profesorëve dhe të diplomuarve të Universitetit të Tiranës (Evidenca V.35; V.36; V.44)[630,631,632], duke ndjekur progresin e |

[617] Evidenca V.38 Panairi Work & Study 2023
[618] Evidenca I.50.1 Leksion i hapur i zhvilluar nga Departamenti i Kimisë Industriale – I ftuar Prof. Asoc. Octavian Bamna
[619] Evidenca I.49 Lista e marrëveshjeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[620] Evidenca V.41 Takim me kompaninë Lufra dhe Alumni me DKI, më 01.02.2023
[621] Evidenca V.18 DSBCK – Leksion i hapur: Si të shkruajmë një letër motivimi
[622] Evidenca V.17 DSBCK – Leksion i hapur: "Këshillimi i Karrierës"
[623] Evidenca V.18 DSBCK – Leksion i hapur: Si të shkruajmë një letër motivimi
[624] Evidenca V.19 DSBCK – Mundësi punësimi dhe internship pranë kompanisë WeWeb
[625] Evidenca V.20 Komunikimi i DSBCK me Departamentin e DKI dhe kompani private mbi punësimin e studentëve të diplomuar nga DKI
[626] Evidenca V.33 DSBCK – Internship në Itali – Western BALKANship
[627] Evidenca V.42 Shkolla Verore Parma 2024 – Formësim i Sistemeve Ushqimore
[628] Evidenca V.43 Trajnim me fokus studentët: "Këshillim karriere" nga Qendra e Zhvillimit Profesional, UT – 13.12.2023
[629] Evidenca V.34 Udhëzues për përdorimin e platformës GRADUA
[630] Evidenca V.35 Komunikime për ngritjen e rrjetit ALUMNI
[631] Evidenca V.36 Shkresa për angazhimin e pedagogëve të DKI në rrjetin ALUMNI
[632] Evidenca V.44 Histori suksesi të studentëve të Departamentit të Kimisë Industriale, datë 18.05.2022

| | |
|---|---|
| | tyre profesional përmes sondazheve të rregullta (Evidenca V.37)[633] dhe duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve universitare. |
| **Konkluzione** | *Vleresohet se institucioni ka ndërtuar një sistem të qëndrueshëm dhe për mbështetjen akademike dhe profesionale të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve dhe pas diplomimit. Strukturat përgjegjëse funksionojnë në mënyrë të rregullt dhe të koordinuar, duke ofruar informim të vazhdueshëm, orientim në procesin mësimor, këshillim për karrierën dhe ndihmë konkrete për integrimin në tregun e punës. GVJ vlereson përkushtimin e institucionit për të garantuar akses të barabartë, transparencë dhe efikasitet në adresimin e nevojave dhe problematikave te studenteve* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Në Universitetin e Tiranës, sispas dokumentacionit te paraqitur, liria akademike është një parim themelor që garanton zhvillimin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe inovacionit (Evidenca I.2)[634] Programi Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" zhvillohet duke respektuar të gjitha rregulloret ligjore dhe aktet e brendshme të universitetit, të cilat janë ndërtuar në përputhje me standardet e akreditimit (Evidenca I.20)[635]. Në mbështetje të kërkimit dhe inovacionit, UT ka hartuar Udhëzuesin për Programin "UT–Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion" (Evidenca |

[633] Evidenca V.37 Formular për gjurmimin e të diplomuarve FSHN-UT
[634] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 7, fq. 4
[635] Evidenca I.20 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"

| | |
|---|---|
| | III.1; VI.1; VI.2)[636,637,638], i cili fuqizon njësitë akademike të universitetit për të avancuar fushat e kërkimit dhe për të lidhur drejtpërdrejt rezultatet e tyre me procesin mësimor. Për sa i përket përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie, UT ka miratuar Strategjinë Institucionale për Mësimdhënien 2022–2027 dhe Planin Strategjik për Zhvillimin Profesional të Personelit 2023–2028 (Evidenca III.19; VI.3; III.28)[639,640,641]. Këto dokumente synojnë rishikimin e vazhdueshëm të programeve, përcaktimin e rezultateve të të nxënit dhe aplikimin e metodave inovative që i japin përparësi praktikës në mësimdhënie (Evidenca III.19)[642]. Një hap tjetër i rëndësishëm ishte miratimi i udhëzuesit për mësimin në distancë (Evidenca III.3)[643], i cili u bë një mjet esencial gjatë periudhës së pandemisë (Evidenca I.8)[644], duke mundësuar vijimin e mësimit online nëpërmjet platformës Microsoft Teams (Evidenca III.2)[645] dhe duke ndjekur një rregullore të posaçme për zhvillimin e provimeve online (Evidenca III.4)[646]. Në mënyrë që studentët të përfitojnë edhe nga mësimi praktik, pranë Departamentit të Kimisë Industriale janë krijuar laboratorë të specializuar si Laboratori i Inxhinierisë Kimike 1 (Evidenca I.18)[647] dhe Laboratori i kimise dhe teknologjise ushqimore (Evidenca III.10)[648]. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Universiteti i Tiranës synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe përvetësimin efektiv të njohurive, përmes zhvillimit të burimeve njerëzore. Të gjitha programet e studimit, përfshirë edhe Masterin në "Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore", kanë si qëllim të formojnë studentë me aftësi ndërdisiplinore, të aftë për tregun e punës (Evidenca I.3; I.7)[649,650]. Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një komponent i sanksionuar në Statutin e UT dhe menaxhohet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), i cili bashkëpunon |

636 Evidenca III.1 Udhëzues për Programin "UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion"
637 Evidenca VI.1 Projekte të fituara në kuadër të programit "UT – Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion"
638 Evidenca VI.2 Udhëzues për procedurat e administrimit të projekteve dhe kërkimit shkencor në UT
639 Evidenca III.19 Strategjia Institucionale për Mësimdhënie, Universiteti i Tiranës 2022-2027
640 Evidenca VI.3 Plani Strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit në Universitetin e Tiranës 2023-2028, si dhe Programi i Trajnimit për vitin 2023
641 Evidenca III.28 Strategjia Institucionale për Mësimdhënie, Universiteti i Tiranës 2022-2027
642 Evidenca III.19 Strategjia Institucionale për Mësimdhënie, Universiteti i Tiranës 2022-2027
643 Evidenca III.3 Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë
644 Evidenca I.8 Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 81, fq. 40 (shqip dhe anglisht)
645 Evidenca III.2 Udhëzues bazik për përdorimin e platformës Microsoft Teams
646 Evidenca III.4 Rregullore e posaçme e Universitetit të Tiranës mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve "online" dhe sezonit të dimrit të vitit akademik 2021-2022
647 Evidenca I.18 Përbërja e hollësishme e infrastrukturës funksionale mësimore-shkencore të DKI
648 Evidenca III.10 Inventari i laboratorit të Teknologjisë Ushqimore dhe lista e aparaturave
649 Evidenca I.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023-2028
650 Evidenca I.7 Plani Strategjik për zhvillimin e programit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" në DKI

| | |
|---|---|
| | me njësitë përkatëse në të gjitha nivelet e strukturës universitare (Evidenca I.2; I.43)[651,652] Këto mekanizma funksionojnë sipas udhëzimeve të ASCAL dhe përfshijnë edhe stafin akademik të DKI në vlerësimin e praktikave mësimore (Evidenca I.16)[653]. Anëtarët e fakultetit janë pjesë e komisioneve institucionale si ai i kurrikulës dhe promovimit të personelit akademik (Evidenca III.8; I.43; V.29)[654,655,656]. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega përkatëse në FSHN (Evidenca VI.5; I.23)[657,658], në bashkëpunim me Zv. Dekanin për kurrikula, organizojnë pyetësorët e studenteve për vlerësimin e mësimdhënies në fund të çdo semestri (Evidenca VI.7; VI.8; VI.9; VI.10)[659,660,661,662]. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen në mënyrë statistikore dhe përdoren për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor (Evidenca VI.7; VI.8; VI.9; VI.10)[664,665,666,667]. Studentët njoftohen për plotësimin e pyetësorëve përmes faqes zyrtare të fakultetit (Evidenca VI.7)[664]. Raportet e analizave i përcillen fillimisht drejtuesit të departamentit nga dekanati, i cili më pas i ndan me stafin akademik dhe organizon takime për të përcaktuar masat për përmirësim (Evidenca VI.8; VI.9; VI.10; VI.11) [665,666,667,663].Gjithashtu, Senati Akademik ka miratuar Manualin e Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik (Evidenca VI.13)[664], që përcakton qartë mënyrën, kriteret dhe periudhat e vlerësimit (Evidenca VI.12)[665]. UT ofron gjithashtu trajnime për |

[651] Evidenca I.2 Statuti i UT, neni 138, pika 1, fq. 73; neni 141, pika 1, fq. 74; neni 141, pika 4, fq. 74 (shqip dhe anglisht)

[652] Evidenca I.43 Vendim SA Nr. 08, datë 30.01.2023 "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e Standardeve të Cilësisë në Universitetin e Tiranës"

[653] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB ASCAL – Tabela 24: Të dhëna për anëtarët e NJBSC

[654] Evidenca III.8 Vendim SA Nr. 09, datë 30.01.2023 "Për miratimin e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës në UT"

[655] Evidenca I.43 Vendim SA Nr. 08, datë 30.01.2023 "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e Standardeve të Cilësisë në Universitetin e Tiranës

[656] Evidenca V.29 Vendimi SA Nr. 07, datë 30.01.2023 "Për miratimin e anëtarëve të Komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët e UT, përfaqësues nga studentët"

[657] Evidenca VI.5 Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022 "Për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHN"

[658] Evidenca I.23 Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Natyrës

[659] Evidenca VI.7 a) Rregullore e Sigurimit të Cilësisë në UT b) Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës

[660] Evidenca VI.8 a) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2021-2022 b) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2021-2022 c) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2022-2023 d) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2022-2023

[661] Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2021-2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2022-2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2023-2024

[662] Evidenca VI.10 a) Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021-2022 b) Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022-2023 c) Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023-2024

[663] Evidenca VI.11 Përcillet "Raporti i Gjurmimit"

[664] Evidenca VI.13 Përcillen të dhënat për pyetësorin "Vlerësimi i lëndës nga studenti"

[665] Evidenca VI.12 Përcillet "Raporti Vjetor"

| | |
|---|---|
| | lektorët e rinj përmes programit "Bazat e Mësimdhënies në Arsimin e Lartë" (Evidenca VI.13)[669]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të përfshirë studentët në këtë proces, Universiteti i Tiranës organizon çdo vit pyetësorë vlerësues për studentët. Këto pyetësorë zhvillohen në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, dhe synojnë të mbledhin opinione për cilësinë e mësimdhënies në çdo lëndë (Evidenca I.20; I.2)[666,667]. Procesi mbështetet nga Statuti i Universitetit dhe rregullorja e programit të studimit, si dhe zbatohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega përkatëse në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (Evidenca I.23)[668]. Rezultatet përpunohen në raporte që shërbejnë si bazë për vlerësime të jashtme dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë akademike (Evidenca VI.8; VI.9; VI.10; VI.11; VI.12; VI.13)[669,670,671,672,673,674]. Studentët përfshihen gjithashtu në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (Evidenca I.16; I.43)[675,676], kanë të drejtën të shprehin opinionet për punën e stafit akademik (Evidenca VI.8; VI.9; VI.10; VI.11; VI.12; VI.13)[677,678,679,680,681,682], si dhe të ankimojnë |

[666] Evidenca I.20 Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore"
[667] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 141, pika 3, fq. 74
[668] Evidenca I.23 Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[669] Evidenca VI.8 a) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2021–2022 b) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2021–2022 c) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2022–2023 d) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2022–2023
[670] Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2021–2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2022–2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2023–2024
[671] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023–2024
[672] Evidenca VI.11 Përcillet "Raporti i Gjurmimit"
[673] Evidenca VI.12 Përcillet "Raporti Vjetor"
[674] Evidenca VI.13 Përcillen të dhënat për pyetësorin "Vlerësimi i lëndës nga studenti"
[675] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB ASCAL – Tabela 24: Të dhëna për anëtarët e NJBSC
[676] Evidenca I.43 Vendim i Senatit Akademik Nr. 08, datë 30.01.2023: "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e standardeve të cilësisë në Universitetin e Tiranës"
[677] Evidenca VI.8 a) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2021–2022 b) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2021–2022 c) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2022–2023 d) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2022–2023
[678] Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2021–2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2022–2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2023–2024
[679] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023–2024
[680] Evidenca VI.11 Përcillet "Raporti i Gjurmimit"
[681] Evidenca VI.12 Përcillet "Raporti Vjetor"
[682] Evidenca VI.13 Përcillen të dhënat për pyetësorin "Vlerësimi i lëndës nga studenti"

| | |
|---|---|
| | rezultatet e vlerësimeve nëse është e nevojshme. Për më tepër, çdo studenti i caktohet një kujdestar akademik, i cili e ndihmon në adresimin e problemeve pranë strukturave përkatëse të universitetit (Evidenca I.2; V.14)[683,684]. Në këtë mënyrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës siguron pjesëmarrje aktive të studentëve në garantimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë. |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, së bashku me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (Evidenca VI.5)[685], kanë përgjegjësinë për të ndjekur dhe garantuar standardet në procesin e mësimdhënies. Në kuadër të kësaj detyre, ato publikojnë në mënyrë të rregullt raportet e analizës së pyetësorëve që përdoren për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies në çdo program studimi. Ky proces kryhet duke respektuar plotësisht legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, konkretisht Ligjin Nr. 48/2012. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Në Departamentin e Kimisë Industriale (DKI), çdo vit kryhet analiza vjetore e punës, ku një ndër elementët thelbësorë është vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies (Evidenca VI.17; I.48)[686,687]. Këto analiza ndihmojnë në evidentimin dhe promovimin e praktikave të suksesshme brenda departamentit, si pjesëmarrja e stafit në mobilitetet Erasmus+, mbështetja për konferenca shkencore dhe botime, si dhe angazhimi në projekte bashkëpunimi (Evidenca VI.17; I.48; VI.21)[688,689,690]. Këto aktivitete kanë krijuar mundësi të vlefshme për zhvillim profesional dhe janë shoqëruar me vlerësime pozitive për kontributin e stafit (Evidenca II.27)[691]. Gjatë viteve 2021–2024, janë realizuar disa mobilitete në kuadër të Erasmus+ dhe programeve të tjera, me fokus kërkimin shkencor dhe mësimdhënien (Evidenca I.52)[692], duke ndikuar në shkëmbimin e eksperiencave dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës mbështesin vazhdimisht përpjekjet e stafit për zhvillim profesional, përmes rimbursimeve për pjesëmarrje në konferenca dhe publikime në revista shkencore, nga të cilat ka përfituar edhe |

683 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 125, pika 5, fq. 69 ; Nenet 138–141, fq. 73–75 ; Neni 127, fq. 70
684 Evidenca V.14 Kujdestarët akademikë të Departamentit të Kimisë Industriale – Cikli i parë dhe i dytë
685 Evidenca VI.5 Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022: "Për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHN"
686 Evidenca VI.17 Plani i masave i Departamentit të Kimisë Industriale (DKI)
687 Evidenca I.48 Analiza Vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale (DKI)
688 Evidenca VI.17 Plani i masave i Departamentit të Kimisë Industriale (DKI)
689 Evidenca I.48 Analiza Vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale (DKI)
690 Evidenca VI.21 Sponsorizime për punime shkencore 2021–2024, Departamenti i Kimisë Industriale
691 Evidenca II.27 Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2021–2022
692 Evidenca I.52 Mobilitet dalës i stafit: Jonida Canaj, Afërdita Shtembari

| | |
|---|---|
| | personeli akademik i DKI (Evidenca I.42)[693]. Gjatë së njëjtës periudhë janë mbështetur edhe një sërë punimesh shkencore (Evidenca VI.21; VI.22)[694,695]. |
| **Konkluzione** | *GVJ mendon se institucioni ka ngritur një politikë të qartë dhe funksionale për garantimin dhe promovimin e cilësisë në mësimdhënie, duke integruar strategji, udhëzues dhe mekanizma të mirëpërcaktuar për zhvillimin profesional të stafit dhe përfshirjen aktive të studentëve. Praktikat e zbatimit të metodave bashkëkohore, vlerësimi i rregullt i procesit mësimor dhe reflektimi i rezultateve në përmirësime konkrete dëshmojnë për një qasje të qëndrueshme dhe efektive ndaj cilësisë akademike. Mbështetja institucionale për kërkimin shkencor, zhvillimin e karrierës dhe mobilitetin ndërkombëtar, garanton qëndrueshmëri në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Universiteti i Tiranës është i përkushtuar për sigurimin e cilësisë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij (Evidenca I.3)[696]. Statuti i UT përcakton strukturat dhe parimet që udhëheqin këtë proces (Evidenca I.2)[697], ndërsa Senati Akademik ka miratuar Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe dokumentet mbështetëse si Rregullorja dhe Paketa e Instrumenteve të Cilësisë (Evidenca VI.23; VI.24; VI.7; VI.4)[698,699,700,701]. Në nivel institucional janë ngritur struktura të dedikuara si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e |

[693] Evidenca I.42 Raportet vjetore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[694] Evidenca VI.21 Sponsorizime për punime shkencore 2021–2024, Departamenti i Kimisë Industriale
[695] Evidenca VI.22 Miratim leje për mobilitet për kërkim shkencor/mësimdhënie
[696] Evidenca I.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018–2023, fq. 4
[697] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Kreu X, nenet 138–141
[698] Evidenca VI.23 Vendim Nr. 51 i Senatit Akademik, datë 23.12.2020: "Për miratimin e paketës së dokumenteve për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës"
[699] Evidenca VI.24 Manuali i Cilësisë (miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)
[700] Evidenca VI.7 a) Rregullore e Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Tiranës b) Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës
[701] Evidenca VI.4 Paketa e instrumenteve (e miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)

| | |
|---|---|
| | Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Kurrikulës (Evidenca I.43)[702], me funksionet dhe përbërjen e përcaktuara në Statut (Evidenca I.2)[703]. Neni 141 i Statutit parashikon gjithashtu ngritjen e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në çdo njësi kryesore. Këto njësi organizojnë pyetësorët studentorë për cilësinë e mësimdhënies në fund të çdo semestri dhe përgatisin raportet përkatëse që shërbejnë për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Me Vendimin Nr. 39 të Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018, per miratimin e buxhetit, janë miratuar strukturat për njësitë e UT (Evidenca VI.6)[704]. Në përputhje me këtë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Degën për Sigurimin e Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (Evidenca VI.5)[705]. Këto struktura, së bashku me Zv.Dekanin për kurrikulat, organizojnë pyetësorët dhe hartojnë raportet për çdo program studimi (Evidenca VI.14; I.2)[706,707]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) është struktura përgjegjëse e caktuar nga Senati Akademik për të garantuar cilësinë institucionale dhe atë të programeve të studimit në Universitetin e Tiranës. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, përkatësisht 8 nga personeli akademik dhe 3 përfaqësues studentë, ndërsa Fakulteti i Shkencave të Natyrës përfaqësohet nga një anëtar akademik (Evidenca I.43)[708]. Për të mbështetur punën e KPSSC dhe të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në njësitë kryesore, UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë si një strukturë ndihmëse-akademike që zbaton politikat institucionale të cilësisë (Evidenca I.16)[709]. Në nivel fakulteti, një ndër mekanizmat kryesorë për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega për Sigurimin e Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) në FSHN (Evidenca VI.5; VI.6)[710,711]. Kjo njësi vepron në |

[702] Evidenca I.43 Vendim i Senatit Akademik Nr. 08, datë 30.01.2023: "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e standardeve të cilësisë në Universitetin e Tiranës"
[703] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 140, fq. 73–74
[704] Evidenca VI.6 Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018: "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018", pika 2: "Miratimi i strukturave për njësitë e Universitetit të Tiranës"
[705] Evidenca VI.5 Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022: "Për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"
[706] Evidenca VI.14 Njoftim për plotësimin e formularit të vlerësimit të lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2024–2025
[707] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 141, pika 3, fq. 74
[708] Evidenca I.43 Vendim i Senatit Akademik Nr. 08, datë 30.01.2023: "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme të standardeve të cilësisë në Universitetin e Tiranës"
[709] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse "ANEKS RVB ASCAL" – Tabela 24: Të dhëna për anëtarët e NJBSC
[710] Evidenca VI.5 Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022: "Për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë"
[711] Evidenca VI.6 Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018: "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018", pika 2: "Miratimi i strukturave për njësitë e Universitetit të Tiranës"

| | |
|---|---|
| | përputhje me "Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës", e mbështetur nga Manuali i Cilësisë dhe Paketa e Instrumenteve të miratuara nga Senati Akademik (Evidenca VI.23, VI.24; VI.7; VI.4)[712,713,714,715]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | Ne perputhje me nenin 104 të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015, Universiteti i Tiranës (UT) është i angazhuar në sigurimin e jashtëm të cilësisë përmes dy mekanizmave ligjorë: Akreditimi Institucional dhe Akreditimi i Programeve të Studimit (Evidenca I.11; I.12)[716,717]. Në vitin 2018, UT i nënshtrohet një procesi të vlerësimit të jashtëm institucional, që rezultoi me një akreditim pozitiv për katër vite akademike. Në vitin 2023, pas procesit të riakreditimit, UT mori sërish një vlerësim përfundimtar pozitiv, kësaj here për një periudhë prej gjashtë vitesh, sipas vendimit të ASCAL të datës 27 janar 2023 (Evidenca I.12)[718]. Departamenti i Kimisë Industriale ka përfunduar me sukses akreditimin për programet Bachelor në "Kimi dhe Teknologji Ushqimore" dhe "Kimi Industriale e Mjedisore", secili me një vlerësim pozitiv për pesë vjet. Vendimet përkatëse të Bordit të Akreditimit dhe raportet përkatëse të vlerësimit janë të publikuara në faqet zyrtare të UT dhe ASCAL. GVB Raporton se me vendimin Nr. 26, datë 21.10.2020, Senati Akademik miratoi planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore, ku ndër të tjera përfshihej analiza e programeve dhe kurrikulave, me objektivin për përmirësim të paktën në masën 20%, si dhe përdorimi i dokumentacionit të unifikuar për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë (Evidenca VI.25)[719]. Në funksion të këtyre synimeve, UT ka hartuar edhe Planin e Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për periudhën 2021–2024 (Evidenca VI.26)[720]. Në nivel fakulteti, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Dega për Sigurimin e Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) në FSHN bashkëpunojnë ngushtë me njësitë bazë për të |

712 Evidenca VI.23 Vendim Nr. 51 i Senatit Akademik, datë 23.12.2020: "Për miratimin e paketës së dokumenteve për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës"
713 Evidenca VI.24 Manuali i Cilësisë (miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)
714 Evidenca VI.7 a) Rregullore për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës b) Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës
715 Evidenca VI.4 Paketa e instrumenteve të cilësisë (miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)
716 Evidenca I.11 Certifikata e akreditimit institucional të Universitetit të Tiranës
717 Evidenca I.12 Vendim Nr. 04 i Bordit të Akreditimit të ASCAL, datë 27.01.2023: "Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë 'Universiteti i Tiranës"
718 Evidenca I.12 Vendim Nr. 04 i Bordit të Akreditimit të ASCAL, datë 27.01.2023: "Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë 'Universiteti i Tiranës'"
719 Evidenca VI.25 Vendim Nr. 26 i Senatit Akademik, datë 21.10.2020: "Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore të Universitetit të Tiranës"
720 Evidenca VI.26 Vendim Nr. 08 i Rektoratit të Universitetit të Tiranës, datë 23.09.2022: "Për miratimin e planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021–2024 në Universitetin e Tiranës"

| | |
|---|---|
| | garantuar vlerësimin e brendshëm. Studentët ftohen periodikisht të plotësojnë pyetësorë për vlerësimin e lëndëve të programit, bazuar në modelet e hartuara nga Paketa e Instrumentave të Cilësisë (Evidenca VI.4; I.2; VI.14)[721,722,723]. Departamenti i Kimisë Industriale përgatit analizat vjetore të aktiviteteve, ku përfshihen rezultatet e këtyre pyetësorëve dhe konkluzionet përkatëse (Evidenca I.48)[724]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | Universiteti i Tiranës, ka zhvilluar një politikë të qartë që mbështetet në procedura periodike për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit që ofron. Statutit të UT-së përshkruan në mënyrë të detajuar procedurat specifike për garantimin dhe zhvillimin e cilësisë së këtyre programeve (Evidenca I.2; VI.27; VI.28)[725,726,727]. Po ashtu, Rregullorja e Sigurimit të Cilësisë përcakton qartë afatet, instrumentet dhe burimet që përdoren për këtë qëllim (Evidenca VI.7)[728]. Përveç pyetësorëve të rregullt që përdoren për vlerësimin e mësimdhënies, Departamenti i Kimisë Industriale harton çdo vit analizën vjetore të veprimtarisë së tij, si një mjet për të identifikuar pikat e forta dhe ato që kërkojnë përmirësim (Evidenca I.48)[729]. Bazuar në këto vlerësime, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) ndërmerr nisma konkrete për të nxitur cilësinë akademike. Një prej këtyre është mbështetja financiare për punimet shkencore të stafit akademik, e cila është ofruar për një numër të konsiderueshëm punimesh të Departamentit të Kimisë Industriale gjatë periudhës 2021–2024 (Evidenca VI.21)[730]. |
| **Konkluzione** | *Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se Universiteti i Tiranës ka zhvilluar dhe funksionalizuar në mënyrë të qëndrueshme sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura të dedikuara për këtë qëllim janë të pranishme dhe aktive, dhe proceset për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë janë të institucionalizuara. Përdorimi i instrumenteve standarde, përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe rezultatet pozitive të akreditimeve të fundit, tregojnë* |

[721] Evidenca VI.4 Paketa e instrumenteve të cilësisë (miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)
[722] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 141, pika 3, fq. 74
[723] Evidenca VI.14 Njoftim për plotësimin e formularit të vlerësimit të lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2024–2025
[724] Evidenca I.48 Analiza vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale
[725] Statuti i Universitetit të Tiranës, Kreu X, nenet 138–141
[726] Evidenca VI.27 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në Universitetin e Tiranës
[727] Evidenca VI.28 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitetin e Tiranës
[728] Evidenca VI.7 a) Rregullore për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës, nenet 31–32 b) Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës
[729] Evidenca I.48 Analiza vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale
[730] Evidenca VI.21 Sponsorizime për punime shkencore 2021–2024, Departamenti i Kimisë Industriale (KI)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *angazhim të vazhdueshëm për përmbushjen e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë. Në këtë kuadër, GVJ vlereson se standardi VI.2 përmbushet plotësisht.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Për të siguruar cilësinë dhe zhvillimin e programeve të studimit, Universiteti i Tiranës ka ngritur struktura të specializuara që merren me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e tyre. Në nivel qendror, dy nga organet kryesore që luajnë një rol kyç në këtë drejtim janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës (Evidenca I.43)[731]. Në nivel fakulteti, funksionojnë Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), të cilat janë përgjegjëse për programet e ciklit të dytë të studimeve (Evidenca VI.5; VI.6)[732,733]. Procesi i monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm bazohet në bashkëpunimin ndërmjet drejtuesve të departamenteve dhe zëvendësdekanëve për kurrikulat dhe ciklet e studimit. Këto struktura koordinojnë raportimet mbi veprimtarinë akademike dhe kërkimore, të cilat përmblidhen në raportet vjetore të Njësive Kryesore (Evidenca I.42)[734], në mbështetje të analizave të hollësishme të përgatitura nga Njësitë Bazë (Evidenca I.48)[735]. |

[731] Evidenca I.43 Vendim i Senatit Akademik Nr. 08, datë 30.01.2023: "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e standardeve të cilësisë në Universitetin e Tiranës"
[732] Evidenca VI.5 Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022: "Për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në FSHN"
[733] Evidenca VI.6 Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018: "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018", pika 2: "Miratimi i strukturave për njësitë e Universitetit të Tiranës"
[734] Evidenca I.42 Raportet vjetore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN)
[735] Evidenca I.48 Analiza vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale (KI)

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe konkretisht në Departamentin e Kimisë Industriale, përdoren disa mekanizma për të garantuar shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të cilësisë së programeve të studimit. Një nga mjetet kryesore është raporti vjetor institucional i Universitetit të Tiranës, si dhe raportet e përvitshme të fakultetit dhe departamentit (Evidenca VI.29; VI.30; I.42)[736,737,738], të cilat përmbledhin analizat mbi procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore, duke identifikuar rezultatet, sfidat dhe masat për përmirësim të mëtejshëm. Ndër të tjera, plani vjetor i veprimtarive akademike dhe shkencore, si edhe plani i veprimit për sigurimin e cilësisë së brendshme (Evidenca VI.26)[739], shërbejnë si udhërrëfyes për menaxhimin dhe zhvillimin e programeve. Një tjetër element thelbësor është realizimi i pyetësorëve te studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në çdo semestër, për çdo lëndë. Nga këto vlerësime hartohen raporte të cilat ndihmojnë në hartimin e planeve të ndërhyrjes për rritjen e cilësisë (Evidenca VI.8; VI.9; VI.10; VI.11; VI.12; VI.13; VI.14; VI.17)[740,741,742,743,744,745,746,747]. Raportet vjetore të DSBCK mbi cilësinë përmbledhin gjetjet kryesore të këtij procesi dhe publikohen në mënyrë transparente në faqen zyrtare të FSHN-së (Evidenca VI.10)[748]. |
| **Kriteri 3.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të | Fakulteti i Shkencave të Natyrës pregatit cdo vit akademik raporte vjetore institucionale që analizojnë në mënyrë të detajuar procesin |

[736] Evidenca VI.29 Miratim raport vjetor UT

[737] Evidenca VI.30 Vendim i Senatit Akademik Nr. 02, datë 30.01.2023: "Për miratimin e Raportit Vjetor të Veprimtarisë së Universitetit të Tiranës për vitin akademik 2021–2022"

[738] Evidenca I.42 Raportet vjetore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN)

[739] Evidenca VI.26 Vendim Nr. 8 i Rektoratit të Universitetit të Tiranës, datë 29.03.2022: "Për miratimin e Planit të Veprimit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2021–2024 në Universitetin e Tiranës"

[740] Evidenca VI.8 a) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2021–2022 b) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2021–2022 c) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2022–2023 d) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2022–2023

[741] Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2021–2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2022–2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2023–2024

[742] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023–2024

[743] Evidenca VI.11 Përcillet "Raporti i Gjurmimit"

[744] Evidenca VI.12 Përcillet "Raporti Vjetor"

[745] Evidenca VI.13 Përcillen të dhënat për pyetësorin "Vlerësimi i lëndës nga studenti"

[746] Evidenca VI.14 Njoftim për plotësimin e formularit të vlerësimit të lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2024–2025

[747] Evidenca VI.17 Plani i masave i Departamentit të Kimisë Industriale (DKI)

[748] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023–2024

| | |
|---|---|
| realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | mësimor dhe veprimtarinë kërkimore, duke përfshirë të gjithë komponentët përkatës (Evidenca I.42)[749]. Departamenti i Kimisë Industriale përgatit analizat e veta vjetore për të vlerësuar ecurinë e programeve të studimit, të cilat më pas përfshihen në raportin e përgjithshëm të fakultetit (Evidenca I.48; I.42)[750,751]. Kur është e nevojshme, realizohen ndryshime deri në masën 20% në planet mësimore për të përmirësuar përmbajtjen e tyre (Evidenca VI.31; II.20)[752,753]. Dekanati, nga ana e tij, kryen kontrolle periodike për të siguruar zhvillimin korrekt të procesit mësimor (Evidenca VI.32; VI.33)[754,755]. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) administron çdo vit pyetësorë për vlerësimin e mësimdhënies dhe përpunon analizat përkatëse, duke hartuar gjithashtu raportet vjetore për cilësinë, të cilat publikohen në faqet zyrtare (Evidenca VI.10)[756]. Përgjegjësit e departamenteve, në bashkëpunim me titullarët e grup-lëndëve, ndjekin nga afër përmbushjen e programeve mësimore dhe kërkimore, si dhe monitorojnë punën e stafit akademik e ndihmës akademik. Ata gjithashtu vëzhgojnë në mënyrë aktive përfshirjen e studentëve në orët laboratorike, në realizimin e detyrave të kursit dhe në testimet gjatë vitit akademik (Evidenca II.11; III.27)[757,758]. |
| **Kriteri 4.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të | Fakulteti i Shkencave të Natyrës, përmes Departamentit të Kimisë Industriale, përdor mjete të tërthorta për të vlerësuar realizimin, cilësinë dhe ecurinë e programeve të studimit. Gjatë periudhës së diplomimit, zakonisht në muajin korrik, studentët që përfundojnë studimet plotësojnë pyetësorët "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" dhe "Raporti i Studentit", për të ofruar një feedback kritik mbi cilësinë e programeve të ndjekura (Evidenca VI.9)[759]. Për më tepër, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës |

[749] Evidenca I.42 Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[750] Evidenca I.48 Analiza vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale (KI)
[751] Evidenca I.42 Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[752] Evidenca VI.31 Rishikimi i planit mësimor
[753] Evidenca II.20 a) Vendim Nr. 29 i Senatit Akademik, datë 21.10.2020: "Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës"
[754] Evidenca VI.32 Raport lidhur me disiplinën në kryerjen e aktivitetit mësimor (kontrolle nga Dekanati)
[755] Evidenca VI.33 Informacion mbi moszhvillimin e mësimit (kontrolle nga Dekanati)
[756] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023–2024
[757] Evidenca II.11 Shkresa: Vendimi i Dekanit për emërimin e titullarëve të grupeve mësimore-kërkimore
[758] Evidenca III.27 Detyrë kursi studenti – (Demonstrim)
[759] Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2021–2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2022–2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2023–2024

| | |
|---|---|
| atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | (DSBCK) organizon rregullisht takime me ish-studentët (ALUMNI) të Departamentit të Kimisë Industriale (Evidenca V.41)[760], duke i përfshirë ata në diskutime dhe duke mbajtur kontakt të vazhdueshëm për të mbledhur mendime që ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit (Evidenca V.41)[761]. Universiteti i Tiranës ka realizuar Studimin e Tregut në nivel institucional (Evidenca I.13)[762], ndërsa stafi akademik i programit "Master i Shkencave në Shkencat dhe Teknologjite Ushqimore" ka zhvilluar një pyetësor të dedikuar për studentët që kanë përfunduar ose janë në përfundim të studimeve. Këto të dhëna janë analizuar nga një grup pune i ngritur me vendim të Senatit Akademik (Nr. 4, datë 22.02.2018), i cili përpiloi një raport të detajuar mbi pozicionimin e të diplomuarve në tregun e punës (Evidenca I.13)[763]. Një raport i dytë mbi tregun e punës u përgatit në kuadër të ri-akreditimit institucional të vitit 2023. Po ashtu, DSBCK ka përpiluar raporte për ndjekjen e karrierës së studentëve të diplomuar në FSHN (Evidenca VI.34; VI.36)[764,765]. Këto raporte ofrojnë një pasqyrë të fushave të studimit që ofron Universiteti i Tiranës dhe rolin e tyre në përgatitjen e të diplomuarve për tregun e punës, duke reflektuar tendencat aktuale të kërkesës dhe ofertës në punësim. Në analizat përfshihen edhe faktorë si vështirësitë në punësim dhe ndikimi i cilësisë së programeve të studimit në lehtësimin e këtij procesi (Evidenca VI.34)[766]. Përveç kësaj, në fund të çdo semestri, çdo pedagog plotëson pyetësorin e vetëvlerësimit për lëndët që mbulon, duke reflektuar mbi rezultatet e studentëve dhe shpërndarjen e notave, dhe duke dhënë sugjerime për përmirësime në përputhje me standardet e ASCAL (Evidenca VI.4)[767]. Në mënyrë të ngjashme, me miratimin e Rregullores për vlerësimin e performancës së personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT (Evidenca VI.18)[768], edhe ky kontingjent është përfshirë në procesin e vlerësimit të cilësisë së programeve mësimore (Evidenca VI.18)[773]. |

[760] Evidenca V.41 Takim me kompaninë "Lufra" dhe alumni me Departamentin e Kimisë Industriale (DKI), datë 01.02.2023
[761] Evidenca V.41 Takim me kompaninë "Lufra" dhe alumni me Departamentin e Kimisë Industriale (DKI), datë 01.02.2023
[762] Evidenca I.13 Studimi i tregut të punës i Universitetit të Tiranës, 2022 Studimi i tregut të punës i Universitetit të Tiranës, 2022, fq. 144–162
[763] Evidenca I.13 Studimi i tregut të punës i Universitetit të Tiranës, 2022 Studimi i tregut të punës i Universitetit të Tiranës, 2022, fq. 144–162
[764] Evidenca VI.34 a) Raporti i gjurmimit 2021–2022 b) Raporti i gjurmimit 2022–2023 c) Raporti i gjurmimit 2023–2024
[765] Evidenca VI.36 Të dhënat "database" të pyetësorëve për gjurmimin
[766] Evidenca VI.34 a) Raporti i gjurmimit 2021–2022 b) Raporti i gjurmimit 2022–2023 c) Raporti i gjurmimit 2023–2024
[767] Evidenca VI.4 Paketa e instrumenteve të cilësisë (miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020), fq. 20–21
[768] Evidenca VI.18 Vendim i Rektoratit Nr. 3, datë 24.01.2022: "Për miratimin në parim të rregullores mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës"

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Si perfundim GVJ konkludon se Institucioni i Arsimit të Lartë ka krijuar dhe funksionalizuar një mekanizëm të qëndrueshëm, të dokumentuar dhe gjithëpërfshirës për monitorimin dhe vlerësimin periodik të programeve të studimit. Janë në funksion struktura të dedikuara që mbulojnë të gjitha hallkat e procesit të sigurimit të cilësisë, nga hartimi e deri te përmirësimi i vazhdueshëm i programeve. Vlerësimi realizohet përmes një game të gjerë metodash, që përfshijnë analiza të drejtpërdrejta të mësimdhënies dhe të të nxënit, si dhe mjete të tërthorta të konsultimit me aktorë të brendshëm dhe të jashtëm si studentët, alumni dhe punëdhënësit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e | Universiteti i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës, përfshin në mënyrë të vazhdueshme si stafin akademik, ashtu edhe studentët në proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë. Anëtarë të departamenteve të FSHN marrin pjesë në Komisionet e Përhershme për Sigurimin e Cilësisë dhe Kurrikulës (Evidenca I.43; III.8)[769,770]. Studentët kontribuojnë rregullisht përmes plotësimit periodik të pyetësorëve të vlerësimit (Evidenca VI.8; VI.9; VI.10; VI.11; VI.12; VI.13; VI.14)[771,772,773,774,775,776,777], duke luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e përvojës mësimore. Përfshirja e |

[769] Evidenca I.43 Vendim i Senatit Akademik Nr. 08, datë 30.01.2023: "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e standardeve të cilësisë në Universitetin e Tiranës"

[770] Evidenca III.8 Vendim i Senatit Akademik Nr. 09, datë 30.01.2023: "Për miratimin e Komisionit të Kurrikulës të Universitetit të Tiranës"

[771] Evidenca VI.8 a) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2021–2022 b) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2021–2022 c) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2022–2023 d) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2022–2023

[772] Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2021–2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2022–2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2023–2024

[773] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023–2024

[774] Evidenca VI.11 Përcillet "Raporti i Gjurmimit"

[775] Evidenca VI.12 Përcillet "Raporti Vjetor"

[776] Evidenca VI.13 Përcillen të dhënat për pyetësorin "Vlerësimi i lëndës nga studenti"

[777] Evidenca VI.14 Njoftim për plotësimin e formularit të vlerësimit të lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2024–2025

| | |
|---|---|
| vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | aktorëve të jashtëm sigurohet përmes takimeve të organizuara me ALUMNI (Evidenca V.44; V.41)[778,779]. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) nxit pjesëmarrjen aktive të ish-studentëve dhe përfaqësuesve të strukturave të tyre në diskutime dhe konsultime. Këto takime shërbejnë për të mbajtur lidhje të vazhdueshme me të diplomuarit, institucionet dhe kompanitë ku ata janë të punësuar, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Megjithate, Raportet e vlerësimit të brendshëm për cilësinë dhe ndikimi i tyre në përmirësimin konkret të kurrikulës dhe përvojave mësimore kërkojnë pjesmarrjen e një numëri më të madh të studentëve gjatë plotësimit të pyetësorëve. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Në nivel universiteti, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) është struktura e caktuar nga Senati Akademik për të garantuar standardet e cilësisë në institucion dhe në programet e studimit. Ai përbëhet nga 11 anëtarë: 8 janë pjesë e stafit akademik dhe 3 janë studentë. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) përfaqësohet në këtë komision nga një anëtar akademik (Evidenca I.43)[780]. Universiteti i Tiranës ka ngritur Sektorin e Sigurimit të Cilësisë (Evidenca I.16)[781], një strukturë ndihmëse-akademike që zbaton politikat për cilësinë dhe mbështet veprimtarinë e KPSSC dhe Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në njësitë kryesore. Për të garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë, FSHN ka krijuar NJSBC dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (Evidenca VI.5; VI.6)[782,783]. Këto struktura gëzojnë pavarësi operacionale dhe akses në të dhënat e njësisë kryesore (Evidenca I.16)[784]. Veprimtaria e tyre bazohet në "Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës", si dhe në "Manualin e Cilësisë" dhe "Paketën e Instrumenteve të Cilësisë", të miratuara nga Senati Akademik (Evidenca VI.23; VI.24; VI.7; |

[778] Evidenca V.44 Histori suksesi e studentëve të Departamentit të Kimisë Industriale, datë 18.05.2022
[779] Evidenca V.41 Takim me kompaninë "Lufra" dhe alumni me Departamentin e Kimisë Industriale (DKI), datë 01.02.2023
[780] Evidenca I.43 Vendim i Senatit Akademik Nr. 08, datë 30.01.2023: "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e standardeve të cilësisë në Universitetin e Tiranës"
[781] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse – ANEKS RVB ASCAL, Tabela 24
[782] Evidenca VI.5 Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022: "Për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN)"
[783] Evidenca VI.6 Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018: "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018, pika 2: Miratimi i strukturave për njësitë e Universitetit të Tiranës"
[784] Evidenca I.16 Tabelat përmbledhëse – ANEKS RVB ASCAL, Tabela 24

| | |
|---|---|
| | VI.4)[785,786,787,788]. Për monitorimin dhe rishikimin e programeve të ciklit të dytë, drejtuesit e departamenteve bashkëpunojnë me zëvendësdekanët për kurrikulat dhe për kualifikimin shkencor, të cilët koordinojnë raportimet mbi aktivitetin mësimor dhe kërkimor (Evidenca I.42)[789]. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN) është një proces i mirëorganizuar që përfshin bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet njësive bazë dhe kryesore. Njësia Kryesore (FSHN) harton çdo vit raporte vjetore ku pasqyrohet në mënyrë të plotë veprimtaria institucionale, përfshirë analizën e procesit mësimor dhe kërkimor, me të gjithë komponentët dhe treguesit përkatës (Evidenca I.42)[790]. Në mënyrë të ngjashme, edhe Departamenti i Kimisë Industriale, si njësi bazë, përgatit analizat e tij vjetore për të vlerësuar ecurinë e programeve të studimit përmes indikatorëve matës të përcaktuar (Evidenca I.48)[791]. Një komponent kyç në këtë sistem janë vetë studentët, të cilët, në fund të çdo semestri dhe përpara sezonit të provimeve, plotësojnë pyetësorë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ky proces përfshin çdo lëndë të programeve të studimit dhe shërben si bazë për hartimin e raporteve të vlerësimit dhe planeve të masave për përmirësim të vazhdueshëm (Evidenca I.2; VI.8; VI.9; VI.10; VI.11; VI.12; VI.13; VI.17)[792,793,794,795,796,797,798,799]. Kur konstatohet nevoja për ndërhyrje në planin mësimor, mund të kryhen ndryshime deri në 20% të përmbajtjes së tij, duke u bazuar |

785 Evidenca VI.23 Vendim Nr. 51 i Senatit Akademik, datë 23.12.2020: "Për miratimin e Paketës së dokumenteve për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës"
786 Evidenca VI.24 Manuali i Cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)
787 Evidenca VI.7 a) Rregullore për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës b) Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës
788 Evidenca VI.4 Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)
789 Evidenca I.42 Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës
790 Evidenca I.42 Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës
791 Evidenca I.48 Analiza vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale (KI)
792 Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, nenet 138–141, fq. 73–75
793 Evidenca VI.8 a) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2021–2022 b) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2021–2022 c) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2022–2023 d) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2022–2023
794 Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2021–2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2022–2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2023–2024
795 Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023–2024
796 Evidenca VI.11 Përcillet "Raporti i Gjurmimit"
797 Evidenca VI.12 Përcillet "Raporti Vjetor"
798 Evidenca VI.13 Përcillen të dhënat për pyetësorin "Vlerësimi i lëndës nga studenti"
799 VI.17 Plani i masave i Departamentit të Kimisë Industriale (DKI)

| | |
|---|---|
| | në analizat dhe rekomandimet përkatëse (Evidenca VI.31; II.20)[800,801]. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) harton dhe publikon raporte vjetore mbi cilësinë e programeve të studimit, duke mundësuar transparencë dhe përmirësim të qëndrueshëm (Evidenca VI.10)[802]. Përgjegjësit e departamenteve, në bashkëpunim me titullarët e grup-lëndëve dhe stafin akademik e ndihmës-akademik, angazhohen në monitorimin dhe mbikëqyrjen e respektimit të programeve të mësimdhënies, veprimtarive kërkimore dhe zhvillimeve të tjera akademike (Evidenca II.11)[803]. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës (Evidenca I.43; III.8)[804,805], së bashku me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) (Evidenca VI.5; VI.6)[806,807], janë strukturat përgjegjëse për zbatimin e proceseve ciklike të vlerësimit të cilësisë. Këto njësi garantojne një qasje të barabartë për të gjithë dhe shmangien e çdo forme diskriminimi ndaj stafit dhe studentëve (Evidenca VI.37)[808]. Në aktivitetet e tyre, KPSSC dhe DSBCK mbështeten në "Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës", të miratuar nga Senati Akademik, si dhe në "Manualin e Cilësisë", "Paketën e Instrumentave të Cilësisë" dhe "Kodin e Etikës" (Evidenca VI.23; VI.24; VI.7; VI.4; |

[800] Evidenca VI.31 Rishikimi i planit mësimor

[801] Evidenca II.20 a) Vendim Nr. 29 i Senatit Akademik, datë 21.10.2020: "Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, viti akademik 2021–2022" b) Vendim Nr. 12 i Senatit Akademik, datë 26.04.2018: "Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të studimit në njësitë kryesore të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2018–2019"

[802] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023–2024

[803] Evidenca II.11 Shkresa: Vendimi i Dekanit për emërimin e titullarëve të grupeve mësimore-kërkimore

[804] Evidenca I.43 Vendim i Senatit Akademik Nr. 08, datë 30.01.2023: "Për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve të përhershme për sigurimin e standardeve të cilësisë në Universitetin e Tiranës

[805] Evidenca III.8 Vendim i Senatit Akademik Nr. 9, datë 30.01.2023: "Për miratimin e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës të Universitetit të Tiranës"

[806] Evidenca VI.5 Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022: "Për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN)"

[807] Evidenca VI.6 Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018: "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018, pika 2: Miratimi i strukturave për njësitë e Universitetit të Tiranës

[808] Evidenca VI.37 Kodi i Etikës së Universitetit të Tiranës

| | |
|---|---|
| | VI.37)[809,810,811,812,813]. Këto dokumente udhëzojnë veprimtarinë e strukturave përkatëse në funksion të garantimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në arsimin e lartë. |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Bashkëpunëtorët e jashtëm luajnë një rol të rëndësishëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë drejtim, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) bashkëpunon me institucione të ndryshme, përfaqësues të biznesit dhe kompani, përmes marrëveshjeve që synojnë ofrimin e ekspertizës dhe kontributeve të vlefshme për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit (Evidenca I.49; I.46; I.42; V.21)[814,815,816,817]. Një tjetër formë e përfshirjes së aktorëve të jashtëm realizohet përmes organizimit të Panairit të Karrierës nga Universiteti i Tiranës dhe FSHN, që synon t'i ndihmojë studentët në orientimin drejt tregut të punës dhe të krijojë mundësi konkrete për punësim apo praktika profesionale (Evidenca V.38)[818]. Në këto evente marrin pjesë institucione publike dhe kompani private, të cilat prezantojnë pozicionet e tyre vakante dhe diskutojnë mundësi për bashkëpunime të mëtejshme (Evidenca I.49)[819], si dhe ofrojnë sugjerime për përmirësimin e përmbajtjes së kurrikulave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Për më tepër, FSHN ka marrë pjesë në Panairin "Work and Study – Punë dhe Aftësi", një aktivitet ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (Evidenca V.38)[820], duke thelluar kështu bashkëpunimin me faktorët jashtë akademisë për të forcuar lidhjen midis arsimit dhe punësimit. |
| **Konkluzione** | *Si konkluzion vlerësohet se institucioni ka ndërtuar dhe funksionalizuar një sistem gjithëpërfshirës për përfshirjen aktive të njësive akademike, personelit, studentëve dhe aktorëve të jashtëm në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Strukturat përgjegjëse veprojnë në përputhje me dokumentet rregullatore dhe* |

[809] Evidenca VI.23 Vendim Nr. 51 i Senatit Akademik, datë 23.12.2020: "Për miratimin e Paketës së dokumenteve për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës"
[810] Evidenca VI.24 Manuali i Cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)
[811] Evidenca VI.7 a) Rregullore për sigurimin e cilësisë në Universitetin e Tiranës b) Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës
[812] Evidenca VI.4 Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)
[813] Evidenca VI.37 Kodi i Etikës së Universitetit të Tiranës
[814] Evidenca I.49 Lista e marrëveshjeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[815] Evidenca I.46 Marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave dhe internshipeve të studentëve
[816] Evidenca I.42 Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[817] Evidenca V.21 Marrëveshje për realizimin e praktikave/intershipeve me INSIFA
[818] Evidenca V.38 Panairi "Work&Study 2023"
[819] Evidenca I.49 Lista e marrëveshjeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[820] Evidenca V.38 Panairi "Work&Study 2023"

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *garantojnë një qasje transparente, të barabartë dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm. Pjesëmarrja e studentëve, alumni-t dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm është e institucionalizuar dhe kontribuon realisht në zhvillimin e programeve të studimit dhe përshtatjen e tyre me tregun e punës. GVJ vlerëson se përmbushja e këtij standardi është e plotë dhe në përputhje me pritshmëritë ligjore dhe akademike.* ***Pjesmarrja e një numëri të vogël të studentëve në pyetësor është një e problematikë që kërkon të adresohet sa më shpejt*** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Politikat, strategjitë, struktura organizative dhe veprimtaria e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës zhvillohen në mënyrë transparente dhe janë të hapura për akses nga personeli akademik dhe studentët. Të gjitha informacionet përkatëse publikohen në mënyrë të rregullt në faqet zyrtare të internetit të UT dhe FSHN. Kjo transparencë reflektohet në dokumentet institucionale si Statuti, Rregullorja, raportet vjetore të UT (Evidenca VI.29; VI.30)[821,822], raportet e përvitshme të Njësisë Kryesore – FSHN (Evidenca I.42)[823], si dhe në analizat vjetore të përgatitura nga Njësia Bazë (Evidenca I.48)[824]. Gjithashtu, raportet periodike të bazuara në pyetësorët e plotësuar nga studentët, të hartuar nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), përbëjnë një element kyç për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë në proceset akademike (Evidenca I.2; VI.8; VI.9; VI.10; VI.11; VI.12; VI.13; VI.14; |

[821] Evidenca VI.29 Miratimi i raportit vjetor të Universitetit të Tiranës
[822] Evidenca VI.30 Vendim i Senatit Akademik Nr. 02, datë 30.01.2023: "Për miratimin e Raportit Vjetor të Veprimtarisë së Universitetit të Tiranës për vitin akademik 2021–2022"
[823] Evidenca I.42 Raporti vjetor i Fakultetit të Shkencave të Natyrës
[824] Evidenca I.48 Analiza vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale (KI)

| | |
|---|---|
| | VI.17)[825,826,827,828,829,830,831,832,833]. Këto raporte, të përgatitura çdo vit, synojnë të nxisin ndërtimin e një kulture të konsoliduar të cilësisë së brendshme, duke kontribuar në rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore. |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (Evidenca VI.5; VI.6)[834,835], si struktura të ngarkuara me detyrën për të monitoruar dhe garantuar cilësinë e procesit mësimor, realizojnë në mënyrë periodike publikimin e raporteve të analizës së pyetësorëve të studentëve, të cilët lidhen me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në secilën lëndë të programeve të studimit. Këto publikime kryhen duke respektuar dispozitat ligjore që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Raportet e hartuar nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) i dërgohen fillimisht Dekanatit (Evidenca II.29)[836], i cili më pas ia transmeton Drejtuesit të Departamentit për shqyrtim (Evidenca VI.15)[837]. Drejtuesi i Departamentit ua përcjell këto të dhëna anëtarëve të personelit akademik (Evidenca VI.16)[838], organizon takime dhe bashkëpunon me titullarët e grupeve mësimore-kërkimore për të diskutuar mbi gjetjet dhe rekomandimet (Evidenca II.11)[839]. Më tej, ai përpilon analizën vjetore të |

[825] Evidenca I.2 Statuti i Universitetit të Tiranës, nenet 138–141, fq. 73–75
[826] Evidenca VI.8 a) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2021–2022 b) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2021–2022 c) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2022–2023 d) Vlerësimi i lëndës nga studenti, semestri II, viti akademik 2022–2023
[827] Evidenca VI.9 a.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" a.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2021–2022 b.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" b.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2022–2023 c.1) Raport për pyetësorin "Vlerësimi i studentëve që diplomohen" c.2) Raport për pyetësorin "Raporti i Studentit", viti akademik 2023–2024
[828] Evidenca VI.10 a) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2021–2022 b) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2022–2023 c) Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, viti akademik 2023–2024
[829] Evidenca VI.11 Përcillet "Raporti i Gjurmimit"
[830] Evidenca VI.12 Përcillet "Raporti Vjetor"
[831] Evidenca VI.13 Përcillen të dhënat për pyetësorin "Vlerësimi i lëndës nga studenti"
[832] Evidenca VI.14 Njoftim për plotësimin e formularit të vlerësimit të lëndës nga studenti, semestri I, viti akademik 2024–2025
[833] Evidenca VI.17 Plani i masave i Departamentit të Kimisë Industriale (DKI)
[834] Evidenca VI.5 Vendim Nr. 129, datë 29.09.2022: "Për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN)"
[835] Evidenca VI.6 Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018: "Për miratimin e buxhetit për vitin 2018, pika 2: Miratimi i strukturave për njësitë e Universitetit të Tiranës
[836] Evidenca II.29 Raporti vjetor i DSBCK (Departamenti i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës) 2023–2024
[837] Evidenca VI.15 Përcjellja e pyetësorëve nga dekanati në departament
[838] Evidenca VI.16 Përcjellja e pyetësorëve nga përgjegjësi i departamentit te stafi akademik
[839] Evidenca II.11 Shkresa: Vendimi i Dekanit për emërimin e titullarëve të grupeve mësimore-kërkimore

| | |
|---|---|
| | performancës së departamentit (Evidenca VI.35; I.48)[840,841] dhe harton një plan veprimi që synon të adresojë çështjet e identifikuara dhe të përmirësojë cilësinë në proceset mësimore e kërkimore (Evidenca VI.17)[842]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) kryen, sa herë që është e domosdoshme, rishikime të planit mësimor, duke realizuar ndryshime deri në 20% të përmbajtjes së tij (Evidenca VI.31; II.20)[843,844]. Këto ndërhyrje përfshijnë përmirësimin e programeve të lëndëve për t'i bërë ato më të përshtatshme dhe efektive (Evidenca I.17; VI.31)[845,846]. Në këtë drejtim, Departamenti i Kimisë Industriale (DKI) angazhohet në përditësimin dhe përshtatjen e programeve të studimit në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e cilësisë dhe sigurisë ushqimore, duke bashkëpunuar ngushtë me kompani dhe institucione partnere me të cilat ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi (Evidenca I.49)[847]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Departamenti i Kimisë Industriale zhvillon në mënyrë të rregullt mbledhje departamentale ku shqyrtohen çështje që lidhen me përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit (Evidenca III.7)[848]. Në mbështetje të këtij qëllimi organizohen gjithashtu takime me ish-studentë (ALUMNI), ku marrin pjesë edhe anëtarë të departamentit për të shkëmbyer mendime dhe përvoja të dobishme (Evidenca V.44)[849]. Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim japin edhe takimet dhe bashkëpunimet me kompani dhe institucione të tjera, të cilat ndihmojnë në përshtatjen e programeve me kërkesat aktuale të tregut të punës (Evidenca I.49)[850]. |
| **Konkluzione** | *Si konkluzion GVJ vlerëson se Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka zhvilluar dhe zbaton një sistem funksional dhe të mirëstrukturuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe veprimtaritë për sigurimin e cilësisë janë transparente, të dokumentuara dhe të* |

840 Evidenca VI.35 Përcjellja e Analizës Vjetore
841 Evidenca I.48 Analiza Vjetore e Departamentit të Kimisë Industriale
842 Evidenca VI.17 Plani i masave i Departamentit të Kimisë Industriale (DKI)
843 Evidenca VI.31 Rishikimi i planit mësimor
844 Evidenca II.20 a) Vendim Nr. 29 i Senatit Akademik, datë 21.10.2020: "Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-së, për vitin akademik 2020–2021" b) Vendim Nr. 12 i Senatit Akademik, datë 26.04.2018: "Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% të planeve mësimore të ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimit, në njësitë kryesore të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2018–2019"
845 Evidenca I.17 Komunikim me email për përditësimin e syllabus-eve
846 Evidenca VI.31 Rishikimi i planit mësimor
847 Evidenca I.49 Lista e marrëveshjeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
848 Evidenca III.7 Shembuj të mbledhjeve të Departamentit të Kimisë Industriale
849 Evidenca V.44 Histori suksesi e studentëve të Departamentit të Kimisë Industriale – 18.05.2022
850 Evidenca I.49 Lista e marrëveshjeve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *njohura nga stafi dhe studentët, duke mundësuar një përfshirje aktive të aktorëve kryesorë në proces. Vlerësimet periodike, analizat e strukturuara dhe planet konkrete të veprimit për pasqyrimin dhe adresimin e problematikave tregojnë për një angazhim serioz institucional. Përdorimi i të dhënave të grumbulluara për rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, si dhe bashkëpunimi me aktorët e jashtëm dhe tregun e punës, janë dëshmi të një qasjeje të qëndrueshme per rritjen e cilësisë në arsimin e lartë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" ofruar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. FSHN eshtë një ndër fakultetet më të vjetra në UT me një përvojë të gjatë akademike dhe shkencore që mbështet zhvillimin e nevojave kombëtare për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm
2. FSHN fhka një staf shumë të kualifikuar të paisur me tituj akademikë dhe gradë shkencore ku nderthuren shumë mirë brezat moshore gjë që garanton vazhdimësinë e mësimdhënies cilësore dhe kërkimit shkencor cilësor
3. Infrastruktura e përshtatshme laboratorike dhe didaktike qe përputhen me nevojat e lëndëve praktike dhe kërkimore.
4. Përfshirja aktive e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes pyetësorëve dhe mekanizmave të rregullt të feedback-ut.
5. Literatura është e përditësuar, stafi akademik ploteson kriteret ligjore per mbulimin e programit te studimit dhe kontribuojnë në pofrimin e njohurive të thelluara dhe kompetencave profesionale bashkëkohore.

**Pika të dobta**

1. Ofron një program Masteri Shkencor në "Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore" ku mungon një nga veprimtaritë mësmore të rëndësishme që është praktika profesionale.
2. Raportet e vlerësimit të brendshëm për cilësinë dhe ndikimi i tyre në përmirësimin konkret të kurrikulës kërkojnë pjesmarrjen e një numëri më të madh të studentëve gjatë plotësimit të pyetësorëve.

**Rekomandime**

1. Të përmirësohet kurrikula e studimit të MS në SHTU, duke përfshirë në të si veprimtari formuese edhe praktikën profesionale.
2. Nxitja aktive e studentëve në kërkimin shkencor, përmes përfshirjes në projekte kërkimore, publikime dhe konkurse inovative.
3. Formalizimi i mekanizmave të mbledhjes së të dhënave për vlerësimin e cilësisë, dhe përfshirja e më gjerë e studentëve, alumni-t dhe aktorëve të jashtëm në përmirësimin e programit.

4. Vijimi i bashkëpunimit me industrinë dhe shoqatat profesionale për të përmirësuar përmbajtjen e kurrikulës dhe për të forcuar komponentin praktik të programit

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences "Science and Food Technology" provided by the Tirana University "Faculty of Nature of Science"**

**Strengths and affirmations**

1. It is one of the oldest faculties at the University of Tirana, with long-standing academic and scientific experience that supports the development of national needs for the training of future professionals.
2. It has a highly qualified academic staff with academic titles and scientific degrees, where generational diversity is well integrated—ensuring the continuity of quality teaching and high-level scientific research.
3. The laboratory and didactic infrastructure is adequate and meets the needs of practical and research-oriented subjects.
4. Active involvement of students in the evaluation of teaching quality through questionnaires and regular feedback mechanisms.
5. The literature is up to date, the academic staff meet the legal criteria for covering the study program, and they contribute to delivering in-depth knowledge and modern professional competencies.

**Weaknesses**

1. It offers a Master of Science program in "Food Science and Technology" in which one of the most important learning activities, professional practice, is missing.
2. Internal quality assessment reports and their impact on concrete curriculum improvement require greater student participation in completing the evaluation questionnaires.

**Recommendation**

1. The curriculum of the MSc program in Food Science and Technology should be improved by including professional practice as a formative activity.
2. Actively promote student engagement in scientific research through participation in research projects, publications, and innovation competitions.

3. Formalize data collection mechanisms for quality assessment, and broaden the involvement of students, alumni, and external stakeholders in the improvement of the program.
4. Continue collaboration with industry and professional associations to enhance the curriculum content and strengthen the practical component of the program.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |